

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRITJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRITJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

Doktorant: **Fitim MEXHUANI**

Dorëzuar

Universitetit Europian të Tiranës

Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në Shkenca
Ekonomike, me profil Financë, për marrjen e gradës shkencore “Doktor”

Udhëheqës shkencor: **Prof.Asoc.Dr. Artur RIBAJ**

Numri i fjalëve: 53731

Tiranë, Nëntor 2018

© **DEKLARATA E AUTORËSISË**

Ky material nuk është prezantuar më parë në këtë institucion dhe as në ndonjë institucion tjetër të ngjashëm me të. Mënyra e mbledhjes, përpunimit dhe analizimit të të dhënave të këtij punimi është krejtësisht origjinale dhe objektive.

ABSTRAKT

Rritja e kursimeve në banka tregtare është një nga faktorët më të rëndësishëm që ndihmojnë në rritjen ekonomike. Kjo ndodh për shkak të faktit që kursimet stimulojnë investimet, prodhimin, rritin nivelin e punësimit dhe rrjedhimisht gjenerojnë Rritjen Ekonomike. Studimi sugjeron që vendet, shkalla e kursimeve kombëtare e të cilëve është e lartë, nuk kanë shumë nevojë dhe nuk varen nga investimet e huaja direkte. Për shkak të kësaj, rreziku që rrjedh nga investimet e huaja direkte të paqëndrueshme zvogëlohet në mënyrë kuptimplote.

Ky studim përqëndrohet kryesisht në përgjigjen ndaj pyetjes: "Cili është ndikimi i rritjes së akumulimit të depozitave në Rritjen Ekonomike të Kosovës? Sipas një studimi të kryer nga Banka Botërore (World Bank, 1993), lidhur me efektin që kishin kursimet në zhvillimin ekonomik, rezultoi se vendet me norma më të larta kursimi kishin pasur një rritje ekonomike më të shpejtë sesa ato me ritme më të ulëta kursimi. Pra, akumulimi i burimeve të brendshme financiare nga bankat tregtare është një komponent kyç në financimin e zhvillimit të qëndrueshëm të një vendi. Kjo marrëdhënie ka qenë subjekt i studimeve për ekonomistë të njohur botëror. Këto ishin arsyet që më nxitën të kryej këtë studim të munguar për Kosovën për periudhën midis viteve 2010 – 2017 duke pasë si temë rolin e bankave tregtare në rritjen e akumulimit të kursimeve dhe efekti i tyre në rritjen ekonomike të Kosovës. Për këtë disertacion, janë përdorur libra akademik, revista shkencore, raporte vjetore dhe pasqyra financiare të bankave tregtare të Kosovës dhe BQK, faqet e internetit, botime të tjera si edhe të dhënat e evidentuara gjatë intervistave të thelluara me drejtuesit kryesor të bankave tregtare dhe BQK në Prishtinë.

Të dhënat nga viti 2010 deri në vitin 2017 janë përdorur për të kryer testet Augmented Dickey-Fuller, testet e Bashkë-Integritetit Johansen dhe testin Ganger Causality. Bazuar në rezultatet empirike, studimi konfirmoi hipotezën se rritja e depozitave nga bankat tregtare të Kosovës ka një ndikim pozitiv në rritjen ekonomike të Kosovës si dhe ekziston një marrëdhënie e qëndrueshme e gjatë midis kursimeve dhe rritjes ekonomike. Rritja e akumulimit të kapitalit financiar krijon mundësi më të mëdha për prodhimin dhe produktivitetin e një vendi, duke siguruar një rrjedhë të ardhshme shtesë të të ardhurave për shoqërinë.

Analizat treguan se akumulimi i depozitave nga bankave tregtare në Kosovë vazhdon të rritet që prej themelimit të sistemit bankar në Kosovë, por shkalla e rritjes vjetore ka një rënie të konsiderueshme krahasuar me periudhën para 4 vitesh. Depozitat dhe kredia në total dominohen nga bankat me kapital nga vendet e Bashkimit Evropian, duke u ndjekur nga grupi bankave me kapital Turk, pastaj ato me kapital Kosovar.

Studimi gjithashtu evidenton disa faktorë kryesor që japin kontribut të rëndësishëm në akumulimin e kursimeve në depozita nga bankat tregtare në Kosovë si edhe nevojën që bankat tregtare të rishikojnë objektivat dhe strategjitë e tyre të biznesit për të qenë më aktive dhe konkurruese sa i përket akumulimit të kursimeve. Gjithashtu, ky disertacion i rekomandon BQK-së dhe Shtetit të Kosovës t'i kushtojnë vëmendje të veçantë kuadrit ligjor, rregullator, politikave dhe strategjive për të ndikuar pozitivisht në rritjen e akumulimit të kursimeve në depozita nga bankat tregtare të Kosovës sepse kjo do të sjellë një rritje më të madhe dhe të qëndrueshme ekonomike të vendit.

ABSTRACT

The growth of savings in commercial banks is one of the most important factors that help economic growth. This is due to the fact that savings stimulate investment, production, growth in employment and consequently generate economic growth. The study suggests that countries whose national savings rate is high are not in much need and do not depend on foreign direct investment. Because of this, the risk arising from volatile foreign direct investment decreases significantly.

This study mainly focuses on the answer to the question: "What is the impact of savings on Kosovo's economic growth?" According to a study conducted by the World Bank (1993) on the effect of savings on economic development, higher savings rates had a faster economic growth than those with lower savings rates, so the accumulation of domestic financial resources by commercial banks is a key component in financing a sustainable development of a country. The relation between savings and economic growth has been a research subject for some well-known economists. These were the reasons that motivated me to carry out this missing study for Kosovo for the period between 2010 and 2017, reflecting the role of commercial banks in increasing the accumulation of savings and their effect on economic growth of Kosovo. For this study, I used academic literatures, scientific magazines, annual reports and financial statements of commercial banks of Kosovo and BQK, websites, other publications as well as records evidenced during in-depth interviews with key managers of commercial banks and BQK in Pristina.

Data from 2010 to 2017 have been used to perform Augmented Dickey-Fuller tests, Johansen Cointegration tests, and Ganger Causality test. Based on empirical results, the study confirmed the hypothesis that the growth of deposits from commercial banks of Kosovo has a positive impact on Kosovo's economic growth and there is a long-lasting relationship between savings and economic growth. Increasing accumulation of financial capital creates greater opportunities for a country's production and productivity, providing an additional revenue stream for the company.

The analysis showed that accumulation of deposits from commercial banks in Kosovo continues to increase since the establishment of the banking system in Kosovo, but the annual growth rate has been considerably lower compared to four years ago. Total deposits and loans are dominated by banks with capital from European Union countries, followed by the group of Turkish-owned banks, then those with Kosovo capital.

The study also identifies several key factors that make a significant contribution to the accumulation of savings in deposits from commercial banks in Kosovo and the need for commercial banks to review their business objectives and strategies to be more active and competitive in terms of savings accumulation. Also, this study recommends to the BQK and the State of Kosovo to pay special attention to the legal framework, regulations, policies and strategies to positively influence the increase of accumulation of savings in deposits from Kosovo commercial banks because this will bring a larger and more stable economic growth of the country.

DEDIKIM

Prindërve të mi, nënës Nurie dhe babait Muharrem (dëshmor i lirisë 1999) për gjithë sakrificën e bër dhe rrugën që më mësuam. Mirënjohës përjetë!

FALËNDERIME

Është shumë e vështirë të gjesësh fjalët e duhura për të shprehur falënderime ndaj atyre njerëzve të cilët bëhen bashkudhëtarë të sfidave të tua. Megjithatë, unë nuk mundem të mos përcjell dy fjalë modeste dhe shumë të përzemërta për të shprehur mirënjohjen e thellë ndaj këtyre njerëzve.

Fillimisht falënderojë udhëheqësin e këtij disertacioni për udhëzimet, këshillat, inkurajimin, mbështetjen, por edhe vërejtjet që më ka përcjellë gjatë realizimit të këtij studimi i cili dukej mision i pamundur.

Falënderojë për kontributin dhe mbështetjen e tyre të gjithë Profesorët e Universitetit Evropian të Tiranës për bashkëpunimin dhe mbështetjen që më kanë dhënë gjatë këtij udhëtimi të gjatë dhe të mundimshëm. Gjithashtu, falënderojë edhe studiues të tjerë nga disa vende të botës me të cilët kam shkëmbyer mendime dhe kam marrë sugjerimet e tyre.

Një falënderim i veçantë është edhe për disa miq dhe bashkëpunëtor të mi në bankat tregtare të Kosovës, BQK dhe Ministrinë e Financave të Kosovës, të cilët më mundësuan në sigurimin e të dhënave, pasqyrave financiare dhe kryerjen e intervistave, pa të cilat nuk do të kisha mundur të realizojë këtë studim.

Dhe krejt në fund, por jo nga rëndësia, një falënderim shumë i singertë i kushtohet familjes sime të madhe, prindërve, motrave, vëllezërve, bashkëshortes dhe fëmijëve të mi, të cilët kanë qenë udhëheqësit e mi shpirtërorë, që me dashurinë e tyre, durimin dhe kurajën më dhanë forcën për të përballuar gjithë këto sfida.

PËRMBAJTJA E LËNDËS

Deklarata e autorësisë	ii
Abstrakt	iii
Falënderime	v
Përmbajtja e lëndës	vii
Lista e grafikëve	ix
Lista e tabelave	x
Lista e figurave	xi
Lista e shkurtimeve të përdorura	xii

KAPITULLI I: SFONDI I STUDIMIT

1.1. Hyrje	1
1.2. Përcaktimi i problemit	6
1.3. Objektivi i përgjithshëm i studimit	8
1.4. Objektivat specifike të studimit	8
1.5. Pyetjet për hulumtim	9
1.6. Rëndësia e studimit	10
1.7. Fushëveprimi i studimit	10
1.8. Kufizimi i studimit	11
1.9. Organizimi i studimit	12

KAPITULLI II: RISHIKIMI DHE TRAJTIMI

ANALITIK PËRMES LITERATURËS

2.1. Prezantim të trajtimit përmes literaturës	14
2.2. Lidhja mes zhvillimit financiar dhe rritjes ekonomike	21
2.3. Indikatorët në performancën e sistemit bankar	27
2.4. Roli i ndërmjetësve financiar në akumulimin e burimeve financiare	35
2.5. Rëndësia dhe burimet e akumulimit të kursimeve të brendshme për zhvillimin ekonomik të vendit	41
2.6. Ecuria e bankave në Kosovë që prej luftës së Kosovës deri më sot	47
2.7. Mbikëqyrja dhe mjedisi rregullator për depozitat dhe likuiditetin në Kosovë	62
2.8. Roli i Bankave Tregtare në akumulimin e depozitave të brendshme në Kosovë	68
2.9. Përfundime	71

KAPITULLI I III: METODOLOGJIA E KËRKIMIT

3.1. Hyrje	75
3.2. Hartimi i Kërkimeve	77
3.3. Popullsia dhe madhësia e mostrës	77
3.4. Lloji i të dhënave dhe burimet	78

3.5. Vlefshmëria e të dhënave	79
3.6. Besueshmëria e të dhënave	79
3.7. Metoda e Analizës së të Dhënave	79
3.8. Metodatat empirike të përdorura	80
3.8.1. Testi Ganger Causality.	80
3.8.2. Testit Dickey – Fuller (DF) , Augmentit Dickey – Fuller (ADF)	83
 KAPITULLI IV: ANANLIZA (TRAJTIMI EMPIRIK, SASIOR DHE CILËSOR)	
4.1. Hyrje	89
4.2. Analiza Empirike	96
4.2.1. Aplikimi i testit Ganger Causality	97
4.2.2. Aplikimi i testit Augmentit Dickey – Fuller (ADF)	98
4.2.3. Aplikimi i ekuacioneve regressive lineare	102
4.3. Analiza e të dhënave sasiore	108
4.3.1. Analizë e tregut për akumulimin e kursimeve të brendshme dhe kreditimin e ekonomisë së Kosovës	
4.3.2. Analizë sipas bankave të grupuara nga origjina e kapitalit	118
4.3.3. Analiza për 3BMT	123
4.3.4. Disa tregues që bëhen faktor për rritjen ekonomike	135
4.4. Analiza e Intervistave	158
4.5. Përfundime	167
 KAPITULLI V: KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME	
5.1. Hyrje	169
5.2. Konkluzionet	171
5.3. Rekomandimet	175
5.4. Rekomandim për studime të mëtejshme	178
 BIBLIOGRAFIA	 179

LISTA E GRAFIKEVE

Grafik 1. Ecuria e depozitave dhe kredive në Kosovë	92
Grafik 2. GDP per capita në Euro	93
Grafik 3. Norma nominale e GDP dhe norma reale e rritjes së saj	94
Grafik 4. GDP 2010-2017	97
Grafik 5. Ecuria depozita dhe kredi 2000-2017	109
Grafik 6. Rritja në % krahasuar me vitin paraardhës për Depozitat nga 2007-2017	110
Grafik 7. Pesha e depozitave (%) e çdo banke ndaj totalit	112
Grafik 8. Parashikim i rritjes së akumulimit të kursimeve në Kosovë deri në 2022	113
Grafik 9. Parashikim i rritjes së kreditimit në Kosovë deri në 2022	115
Grafik 10. Raporti Kredi ndaj Depozitave në Kosovë nga viti 2000 deri në 2017	116
Grafik 11. Parashikim i ecurisë së Raportit Kredi ndaj Depozitave në Kosovë	117
Grafik 12. Pesha e depozitave mbi totalin në vite sipas origjines së kapitalit	119
Grafik 13. Parashikimi deri në 2022 për peshën e depozitave që do të kenë akumuluar bankat me kapital nga vendet e BE	121
Grafik 14. Parashikimi për peshën e depozitave të akumuluar deri në 2022 nga bankat me kapital Turk	122
Grafik 15. Parashikimi deri në 2022 për peshën e depozitave që do të kenë akumuluar bankat me kapital nga Kosova	123
Grafik 16. Ecuria e peshës së depozitave të çdo banke 3BMT ndaj totalit nga viti 2010	124
Grafik 17. Pesha e depozitave dhe kredive në vitin 2017 të 3BMT ndaj totalit	125
Grafik 18. Ecuria e volumit të depozitave dhe kredive për 3BMT	126
Grafik 19. Ecuria, devijancat dhe progresioni për depozitat dhe kreditë e 3BMT dhe totalit të tyre në Kosovë	127
Grafik 20. Ecuria e Raportit Kredi/Depozita për çdo bankë tregtare	129
Grafik 21. Ecuria e Raportit Kredi/Depozita për gjithë tregun bankar në Kosovë	130
Grafik 22. Raporti Kredi ndaj Depozitave të 3BMT sipas raportimeve të vitit 2017	131
Grafik 23. Parashikimi deri në 2022 për ecurinë e Raportit Kredi ndaj Depozitave për 3BMT	132
Grafik 24. Parashikimi për ecurinë e Raportit Kredi/Depozita për Bankën 7	133
Grafik 25. Parashikimi për ecurinë e Raportit Kredi/Depozita për Bankën 8	134
Grafik 26. Norma mesatare e interesit në depozita	136
Grafik 27. Ecuria e Remitancave	145
Grafik 28. Pesha e depozitave të degëve të bankave të huaja	146
Grafik 29. Ecuria e rrjetit bankar sipas numrit të degëve/zyrave	149
Grafik 30. Parashikimi i ecurisë së rrjetit të zyrave bankare deri në vitin 202	149
Grafik 31. Parashikimi i ecurisë së akumulimit të depozitave nga banka që ka kufizuar rrjetin bankar	150
Grafik 32. Parashikimi i ecurisë së akumulimit të depozitave nga banka që ka ruajtur rrjetin bankar	151
Grafik 33. Ecuria e POS dhe Online Banking Acc. deri në Qershor 2017 në Kosovë	152
Grafik 34. Parashikimi i ecurisë së aktivizimit të online banking accounts deri në vitin 2022	153

LISTA E TABELAVE

Tabela 1.	Testi Ganger Causality	98
Tabela 2.	Testi Augmented Dickey- Fuller për GDP	99
Tabela 3.	ADF test për diferencën e parë	101
Tabela 4.	Ndërtimi i modelit me faktor depozitat	103
Tabela 5.	Modeli me factor depozitat dhe kredite	104
Tabela 6.	Modeli me faktor depozitat dhe remitancat	105
Tabela 7.	Modeli duke përfshirë depozitat, remitancat, faktorin kohë dhe faktorin kredi	106
Tabela 8.	Modeli duke përfshirë vetëm remitancat	107
Tabela 9.	Rritja vjetore e depozitave për çdo bankë tregtare në %	111
Tabela 10.	Pesha e depozitave që ka akumuluar çdo bankë ndaj totalit të depozitave të sistemit bankar përgjatë viteve 2010 deri në vitin 2017	118
Tabela 11.	Pesha e depozitave mbi totalin sipas origjinës së kapitalit	120
Tabela 12.	Raporti kredi/depozita përçdo bankë tregtare	128
Tabela 13.	Bankat që veprojnë në industrinë bankare kosovare degët dhe zyrat e tyre.	148

LISTA E FIGURAVE

Fig 1. Krahاسimi i roleve midis institucioneve financiare	36
Fig 2. Shembull te Dickey –Fuller, t-distribution	86
Fig 3. Norma mesatare e interesit në depozita për ekonomitë familjare, sipas kategorive	138
Fig 4. Fitimi neto i sektorit bankar, në miliona euro	170
Fig 5. Furnizimi me para të gatshme (vlera) në miliona euro	144

LISTA E SHKURTIMEVE TË PËRDORURA

BQK	Banka Qëndrore e Kosovës
3BMT	Tre bankat më të mëdha tregtare
ECB	Banka Qendrore Europiane
OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
EJL	Evropa Juglindore
IHD	Investimet e Huaja Direkte
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
BB	Banka Botërore
BIS	Banka Ndërkombëtare për Rregullime
UNMIK	Misioni Ndërkombëtar i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
BERZH	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
BE	Bashkimi Evropian
KKK	Komisioni Kosovar i Konkurrencës
OEK	Oda Ekonomike e Kosovës
AKP	Agjencia Kosovare e Privatizimit
EJL	Evropa Jug-Lindore
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
KB	Kombet e Bashkuara
UNDP	Programi Zhvillimor i Kombeve të Bashkuara
PBB	Produkti Brendshëm Bruto
p.p.	Pikët e përqindjes
ROA	Kthimi në Asete
ROAA	Kthimi në Asetet Mesatare
ROAE	Kthimi në Kapitalin Mesatar
ROE	Kthimi në Kapital

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RITJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RITJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

KAPITULLI I: SFONDI I STUDIMIT

1.1 Hyrje

"Cili është ndikimi i rritjes së depozitave në rritjen ekonomike të Kosovës? Kjo është pyetja kryesore që del në këtë studim. Ruajtja e shkallës së lartë të kursimeve në një ekonomi do të sjellë ruajtjen e një niveli të lartë të kapitalit dhe nivelit të lartë të prodhimit. Akumulimi i kapitalit financiar është theksuar si faktori kryesor që rregullon shkallën e zhvillimit. Ky akumulim kapitali krijon mundësi më të mëdha për prodhimin dhe produktivitetin e një vendi, duke siguruar një rrjedhë të ardhshme shtesë të të ardhurave për shoqërinë. Akumulimi i kapitalit financiar në çdo ekonomi në zhvillim kërkon akumulimin e suficitit ekonomik (Meier, 1989). Sipas një studimi të kryer nga Banka Botërore (World Bank, 1993) lidhur me efektin që kishin kursimet në zhvillimin ekonomik, rezultoi se vendet me norma më të larta kursimi kishin pasur një rritje ekonomike më të shpejtë sesa ato me ritme më të ulëta kursimi. Pra, sipas Bankës Botërore në vendet në zhvillim, politikat që inkurajojnë kursimet do të kontribuojnë gjithashtu në një rritje më të lartë ekonomike .

Qëllimi i çdo vendi është, të arrijë një nivel të lartë të rritjes ekonomike, pasi kjo do të çonte në standarde më të mira jetese, mirëqënie më të mirë dhe një jetë më të rehatshme për njerëzit (Sinha & Sinha, 1998). Një ekonomi që dëshiron të rrisë krijimin real të kapitalit financiar vendas, duhet të ketë si objektiv të siguroj një klimë të hapur për inkurajimin e kursimeve të brendshme. Akumulimi i burimeve të brendshme është një komponent kyç i partneritetit global në financimin e zhvillimit. Akumulimi efektiv i burimeve vendase në dhe nga vendet në zhvillim, është mënyra më e qëndrueshme dhe thelbësore për të siguruar

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RITJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RITJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

burime të rëndësishme zhvillimi për qëllim të rritjes së qëndrueshme ekonomike. A mund të ketë rritje më të shpejtë dhe të qëndrueshme ekonomia e Kosovës nëse depozitat në bankat tregtare të Kosovës rriten me një ritëm të qëndrueshëm? Në fakt kjo është pyetja kryesore që del në këtë studim.

Ruajtja e shkallës së lartë të kursimeve në një ekonomi do të sjellë ruajtjen e një niveli të lartë të kapitalit dhe nivelit të lartë të prodhimit. Akumulimi i kapitalit financiar është theksuar si faktori kryesor që rregullon shkallën e zhvillimit. Ky akumulim kapitali krijon mundësi më të mëdha për prodhimin dhe produktivitetin e një vendi, duke siguruar një rrjedhë të ardhshme shtesë të të ardhurave për shoqërinë. Akumulimi i kapitalit financiar në çdo ekonomi në zhvillim kërkon akumulimin e suficitit ekonomik (Meier, 1989). Sipas një studimi të kryer nga Banka Botërore (World Bank, 1993). lidhur me efektin që kishin kursimet në zhvillimin ekonomik, rezultoi se vendet me norma më të larta kursimi kishin pasur një rritje ekonomike më të shpejtë sesa ato me ritme më të ulëta kursimi. Pra, sipas Bankës Botërore në vendet në zhvillim, politikat që inkurajojnë kursimet do të kontribuojnë gjithashtu në një rritje më të lartë ekonomike .

Veçanërisht në vendet në zhvillim përvojat kanë treguar se, vetëm kapitali i huaj nuk mund të krijojë asnjë bazë të përhershme për një standard më të lartë të jetesës në të ardhmen dhe se varësia më e madhe nga burimet e brendshme të financimit lehtëson më shumë zbatimin e suksesshëm të çdo zhvillimi të planifikuar ekonomik (Agu, 1984). Për më tepër, tendencat aktuale në rrjedhën e asistencës për vendet në zhvillim në të vërtetë janë në rënie dhe nuk përputhen me nevojat aktuale. Në një kohë kur të gjitha vendet kanë nevojë për një vëllim gjithnjë në rritje të burimeve financiare për të nxitur zhvillimin e tyre ekonomik,

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RITJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RITJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

është bërë e vështirë për të siguruar fonde të huaja; dhe përdorimi i fondeve të tilla përbën disavantazh serioz, kjo sepse krijon një varësi serioze ekonomike mbi vendet kreditore dhe rrit barrën e borxhit (Rasti i ekonomisë së Greqisë, Argjentinës, etj). Realitetet ekonomike në vendet në zhvillim kanë forcuar në mënyrë të konsiderueshme këto argumente në favor të një theksimi më të madh në akumulimin e burimeve të brendshme.

Reduktimi i varfërisë dhe rritja e të ardhurave kombëtare është qëllimi i çdo qeverie. Për të arritur një rritje ekonomike, qeveritë aplikojnë politika të ndryshme në vendet e tyre, si rritja e kursimeve, rritje të investimeve dhe të prodhimit. Duke ditur se investimi është një nga faktorët kryesorë që ndikon në rritjen ekonomike, e vetmja mënyrë për rritjen e tij është duke zgjeruar madhësinë e kursimeve/depozitave përmes bankave tregtare të një vendi. Forcimi i akumulimit të burimeve vendase ofron shumë përfitime të mundshme për ekonominë e Kosovës.

Së pari, ai do të zvogëlojë nevojën për flukse kapitali financiar të jashtëm, duke reduktuar kështu një nga risqet e dëmtimit të paqëndrueshmërisë në disponueshmërinë e burimeve dhe duke zvogëluar ndjeshmërinë ndaj goditjeve të jashtme.

Së dyti, ajo do t'i japë Kosovës hapësirë më të madhe të politikave, duke rritur pronësinë e saj në procesin e zhvillimit si dhe forcimin e kapacitetit të shtetit të Kosovës.

Së treti, përpjekjet e suksesshme për të rritur rëndësinë e burimeve vendase në procesin e zhvillimit varen nga aftësia e shtetit për të përmirësuar mjedisin ekonomik të vendit, duke krijuar ekspozime të rëndësishme pozitive.

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRIJTEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRIJTJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

Së fundi, këto përpjekje gjithashtu mund të shihen si një shenjë pozitive nga donatorët dhe investitorët e huaj nga jashtë Kosovës, duke rritur kështu hyrjen e burimeve financiare me kosto akoma më të ulët se më parë.

Sipas Shone (1996) ka edhe arsye të ndryshme që justifikojnë nevojën për t'u rritur duke u mbështetur më shumë në akumulimin e burimeve financiare vendase.

Disa prej tyre janë:

1. Qëndrueshmëria ekonomike e vendit e cila është shumë më e sigurt kur përdoren burime financiare vendase sesa burime të huaja si ndihma, hua ose Investimet e Huaja Direkte (IHD), sepse edhe pse burimet e jashtme shërbejnë gjithashtu si burime alternative / plotësuese për të lehtësuar mungesat e përkohshme, ato vijnë me disa kushte politike dhe janë më pak të parashikueshme, jo të besueshme dhe të paqëndrueshme;
2. Interesi i madh për qeverinë dhe publikun e gjerë për përmirësimin e mirëqenies së përgjithshme është një forcë tjetër shtytëse për vendet që të përqëndrohen në akumulimin e burimeve të veta, edhe kur ata disponojnë burime të kufizuara.
3. Vlerësohet se rritja e qëndrueshme e një vendi në zhvillim sigurohet më shumë kur mbështetet në burimet e brendshme të vendit, kjo për arsye se nxitja e dinamizmit të rritjes nga injektimi fillestar i burimeve të brendshme ka më shumë gjasa të gjenerojë më shumë shpresë për një të ardhme më të mirë.

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRIJTEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRIJTJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

Të gjithë këta faktorë dhe të tjerë të ngjashëm nxisin qeveritë të përqëndrohen në nevojën për të inicuar strategji të ndryshme që të përqëndrohen në akumulimin e burimeve me synimin për përsheptimin e rritjes ekonomike.

Kursimet luajnë një rol të rëndësishëm në kontributin ndaj aftësisë së investimeve dhe prodhimit, të cilat nga ana e tyre do të ndikojnë pozitivisht në mundësitë e rritjes ekonomike. Vlerësimi i përgjithshme është se rritja e kursimeve agregate do të japë investime më të mëdha të shoqëruara me rritjen më të lartë të PBB-së. Prandaj, si rezultat, norma më e lartë e kursimeve rrit sasinë e kapitalit dhe çon në një rritje më të lartë ekonomike të vendit. Gjithashtu, studime të tjera empirike tregojnë se rritja ekonomike shkakton një rritje të të ardhurave personale dhe të shpenzimeve të konsumit për individ/banor të një vendi. Bazuar në teorinë e pritjes marginale për të kursyer, rritja e të ardhurave çon në zgjerimin e normës së kursimeve. Me fjalë të tjera, shuma e kursimeve rritet kur ka një rritje ekonomike. Kur flasim për marrëdhënien që ekziston midis kursimeve dhe rritjes ekonomike, nuk mund të mohohet se nëse kursimet agregate rriten, kjo nxit investimet dhe nxit rritjen ekonomike.

Kosova është një vend në zhvillim dhe si i tillë, kapitali financiar është një faktor i rëndësishëm për rritjen ekonomike. Burimi më i madh i kapitalit buron nga kursimet të cilat depozitohen në bankat tregtare në Kosovë. Gjithashtu, eksperiencat tregojnë se normat e ulëta të kursimit shkaktojnë një deficit të llogarisë së një vendi, pra linjat që përfaqësojnë kursimin kombëtar dhe bilancin e llogarisë shkojnë së bashku, duke ndjekur vazhdimësinë e njëri-tjetrit në periudha të ndryshme kohore.

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RITJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RITJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

Bazuar në konceptet e lartpërmendura si një vend në zhvillim, Kosova duhet të mobilizojë kursimet e brendshme për të arritur zhvillimin e dëshiruar ekonomik. Kjo varësi nga burimet e brendshme të kapitalit kërkon një gamë të gjerë të institucioneve financiare të mirë-organizuara dhe të përshtatura, sidomos bankat tregtare, të cilat duhet të mobilizojnë burimet e brendshme për qëllime të formimit të kapitalit financiar dhe të lejojnë që kapitali të investohet në mënyrë të përshtatshme dhe lirisht në sipërmarrje që sjellin zhvillim ekonomik për Kosovën.

Duke konsideruar sa më sipër, ky punim kërkimor kreu hulumtim për rolin e bankave tregtare në akumulimin e burimeve financiare vendase dhe mbështetjen për rritjen ekonomike të Kosovës. Ky studim konkludon dhe rekomandon për rolin bankave si ndërmjetës financiar në akumulimin e burimeve të brendshme financiare për zhvillimin ekonomik nëpërmjet financimit të huave dhe tregtisë si import dhe eksport dhe gjithashtu identifikon disa kufizime të Bankave për efektivitetin e tyre në zhvillimin ekonomik të Kosovës.

1.2. Përcaktimi i problemit

Burimet për investime në shumicën e vendeve më pak të zhvilluara (siç vlerësohet dhe kategorizohet Kosova) janë kryesisht jashtë vendit sidomos Investimet e Huaja Direkte (IHD) dhe borxhet. Megjithatë, varësia e lartë e vendeve më pak të zhvilluara në burimet e jashtme kufizon hapësirën e tyre të politikave zhvillimore duke krijuar disa varësi. Dobësia e tyre ekonomike përkeqësohet më tej nga borxhet. Në mënyrë të ngjashme shumë vende më pak të zhvilluara kanë deficit të madh në llogaritë aktuale dhe tregtare, të financuara nga grantet e huaja dhe kreditë. Edhe një ndryshim i vogël në flukset e kapitalit të jashtëm

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRIJTJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRIJTJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

mund të shkaktojë t'kurrje ekonomike të brendshme. Akumulimi i burimeve të brendshme do të ndihmojë në zvogëlimin e cenueshmërisë që rrjedh nga varësia nga financimet e dobëta të huaja dhe gjithashtu kjo përpjekje e akumulimit të depozitave vendase siguron të vetmin bazë financimi afatgjatë për investimet në zhvillimin e vendeve më pak të zhvilluara.

Kursimet e brendshme kanë një rol vendimtar për financimin e zhvillimit të vendeve më pak të zhvilluara. Ato janë të nevojshme për të siguruar burime për investime, për të nxitur zhvillimin e tregut financiar dhe për të nxitur rritjen ekonomike. Megjithatë, vendet më pak të zhvilluara kanë vështirësi në akumulimin e burimeve të mjaftueshme vendase për të përmbushur nevojat e vendit të tyre për investime, për shkak të të ardhurave të ulëta të banorëve dhe plotësimit të nevojave bazë jetësore të tyre.

Problemi që trajton ky studim për Kosovën është se: akumulimi i burimeve financiare vendase përmes bankave tregtare ende nuk ka arritur nivelin e qëndrueshëm për investimet e brendshme. Gjithashtu, për Kosovën nuk ka asnjë studim apo literaturë që tregon rolin e bankave tregtare në akumulimin e burimeve të brendshme për zhvillimin ekonomik, ndërsa disa prej punimeve përqëndrohen në skemën e thithjes së IHD-ve.

Prandaj, ky studim është ndërtuar për të mbushur këtë boshllëk kërkimor duke treguar akumulimin e burimeve financiare vendase nëpërmjet bankave tregtare për zhvillimin ekonomik të vendit dhe sjell disagjetje dhe konkluzione të cilat duhet të konsiderohen që mos të pengojnë mundësitë efektive për akumulimin e burimeve vendase dhe paraqet disa rekomandime të cilat duhet të adresohen për të rritur rolin e bankave në zhvillimin e ekonomisë së Kosovës.

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RITJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RITJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

Kështu që, duke pasur studimet e duhura për këtë çështje, është një hap kritik i parë drejt hartimit të qasjeve relevante të politikave për të mobilizuar më tej resurset financiare të nevojshme për të arritur qëllimet e dëshiruara për transformimin e Kosovës në industrializim. Në përfundim, Kosova duhet të aplikoj një strategji të qëndrueshme të rritjes dhe transformimit që kërkon më shumë kursim dhe që përqendrohet në transformimin e vendit drejt industrializimit. Planifikimi për kursim të mëtejshëm kërkon njohjen e potencialit të bankave tregtare në akumulimin e burimeve të cilat do të jenë në dispozicion për zhvillimin ekonomik të Kosovës.

1.3 . Objektivi i përgjithshëm i studimit

Ojetivi i këtij studimi është të sigurojë një analizë të thellë të marrëdhënieve që ekzistojnë midis akumulimit të depozitave vendase nga bankat tregtare në Kosovë dhe rritjes së qëndrueshme ekonomike të Kosovës.

1.4 . Objektivat specifike të studimit

Objektivat specifike të studimit janë:

- * Të tregojë marrëdhënien që ekziston mes rritjes së depozitave në Kosovë dhe rritjes ekonomike të Kosovës.
- * Të identifikojë faktorët kryesorë që ndikojnë në akumulimin e depozitave në Kosovë.
- * Të tregojë performancën e akumulimit të depozitave dhe investimin e tyre nga çdo bankë tregtare, por edhe sipas grupimeve të kapitalit, etj, nga viti 2010-2017 dhe prespektivën e tyre.

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RITJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RITJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

* Të paraqesë gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet lidhur me veprimet që duhet të ndërmarrin bankat tregtare dhe shteti i Kosovës për të rritur akumulimin e depozitave.

1.5. Pyetjet për hulumtim

Pyetje të ngjashme për të kryer hulumtimin përfshijnë:

- (i) Cila është marrëdhënia që ekziston mes rritjes së akumulimit të kursimeve nga bankat tregtare në Kosovë dhe rritjes ekonomike të vendit?
- (ii) Cila është performanca e akumulimit të depozitave vendase nga bankat tregtare nga viti 2010-2017?
- (iii) Cilët janë faktorët që ndikojnë në akumulimin e depozitave?
- (iv) A kanë të gjitha bankat tregtare të njëjtin kapacitet në akumulimin e depozitave?
- (v) Çfarë rekomandimi mund të sugjerohet bankave dhe shtetit të Kosovës të angazhohen për rritjen e akumulimit të kursimeve vendase?

Hipoteza

H₀: Rritja e akumulimit të kursimeve në depozita nga bankat tregtare të Kosovës kanë efekt pozitiv në rritjen e qëndrueshme ekonomike të Kosovës.

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RITJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RITJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

1.6. Rëndësia e studimit

Studimi ka një kontribut të madh për të siguruar informacionin bazë në fushën e akumulimit të burimeve financiare të brendshme nëpërmjet bankave tregtare për zhvillimin e ekonomisë së Kosovës. Gjithashtu, ky studim kontribuon në zhvillimin e sektorit financiar dhe mirëqenien e shoqërisë Kosovare në tërësi. Si edhe, përfitues të tjerë nga ky studim janë: Bankat tregtare në Kosovë dhe BQK si edhe do të shërbejë si gur themeli për studime dhe hulumtime të mëtejshme në fushën e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik të Kosovës.

1.7. Fushëveprimi i studimit

Qëllimi i këtij studimi është ndërtuar për të hulumtur rreth akumulimit të burimeve financiare vendase nëpërmjet bankave tregtare për zhvillimin ekonomik të Kosovës në periudhën 2010-2017. Edhe nëse ekzistojnë punime për kontributin e bankave tregtare në zhvillimin e ekonomisë së vendit, ky studim thellohet dhe është i vetëm për rolin e bankave në rritjen e akumulimit të depozitave dhe për kontributin që bankat tregtare japin në ekonominë e Kosovës përmes financimit të investimeve (për projektet e qeverisë, bizneseve, individëve) dhe të gjitha këto qojnë në rritjen ekonomike të vendit.

Në Kosovë ushtrojnë veprimtarinë 10 banka tregtare. Nga numri i bankave që operojnë si aktorë me peshë dominues në ekonomi, studimi i dha rëndësi tre bankave më të mëdha tregtare në Kosovë (3BMT) që janë edhe bankat me kapital nga vendet e Bashkimit Europian, por gjithashtu janë mbledhur të dhëna relevante edhe nga bankat e tjera tregtare në Kosovë për qëllime analize dhe krahasimi. Për ta bërë objektin e studimit të

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRITJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRITJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

menaxhueshëm, ky hulumtim përqendrohet në një aspekt madhor që përcakton depozitat dhe studimi është i kufizuar për të identifikuar disa nga faktorët specifikë që ndikojnë në akumulimin e tyre nga bankat tregtare.

1.8. Kufizimi i studimit

Edhe pse ky studim ka përfunduar me sukses, ka pasur vështirësi praktike. Në të mirë të tij, ky hulumtim duhet të ishte shtrirë për të mbuluar të gjitha faktet për rolin e bankave tregtare në zhvillimin e ekonomisë së Kosovës megjithatë, koha dhe materiali i kërkuar kanë detyruar kërkuesin që të kufizohet në disa fusha të fokusuara. Gjithashtu, intervistë e thellë u përdor për të mbledhur informacion nga zyrtarët më të lartë të të gjitha bankave tregtare në Kosovë veçanërisht për ata që janë të përfshirë në çështjet e depozitave dhe që ndodhen në secilën seli të bankave në Prishtinë, por për disa pyetje gjatë intervistës nuk kishte gatishmëri nga disa prej bankave të jepnin informacionet kryesore të kërkuara për shkak të frikës nga konkurrenca dhe arsye të tjera të panjohura të cilat mund të çojnë në paragjykimin e bërë në rezultat për shkak të më shumë varësie nga burimet e tjera të të dhënave sekondare. Përveç kësaj, kërkuesi kishte për qëllim mbledhjen e të dhënave të kërkuara nga të gjitha bankat tregtare në kohën e duhur, por disa banka janë angazhuara në industri në vitet e fundit dhe nuk kanë të dhëna për gjithë periudhën e kërkuar. Si edhe njëra prej bankave e ushtron veprimtarinë vetëm me një degë në veri të Kosovës.

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRIJTJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRIJTJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

1.9. Organizimi i studimit

Studimi është strukturuar si më poshtë:

Kapitulli i parë, merret me hyrjen e përgjithshme në studim, identifikimin e problemit, objektin e studimit, qëllimin e studimit, metodologjinë, kufizimet e studimit dhe organizimin e tezës.

Kapitulli i dytë, rishikon trajtimin analitik përmes literaturës për këtë studim. Shqyrton kërkimet lidhur me akumulimin e burimeve vendase (depozitat). Çështjet për t'u shqyrtuar përfshijnë, lidhja mes zhvillimit financiar dhe rritjes ekonomike, indikatorët në performancën e sistemit bankar, roli i ndërmjetësve financiar në akumulimin e burimeve financiare, rëndësia dhe burimet e akumulimit të kursimeve të brendshme për zhvillimin ekonomik të vendit, ecuria e bankave në Kosovë që prej luftës së Kosovës deri më sot, mbikëqyrja dhe mjedisi rregullator për depozitat dhe likuiditetin në Kosovë, roli i Bankave Tregtare në akumulimin e depozitave të brendshme dhe efektet e akumulimit të depozitave në rritjen e burimeve/kapitalit financiare dhe investimet në ekonomi.

Kapitulli i tretë, paraqet metodologjinë e këtij punimi duke prezantuar popullatën dhe madhësinë e mostrës; dizajnin kërkimor; burimet e të dhënave; vlefshmërinë dhe besueshmërinë e të dhënave si dhe metodën e analizës.

Kapitulli i katërt, është trupi kryesor i punës kërkimore i cili përmban analizat sasiore dhe cilësore të përdorura në vlerësimin e informacionit të fituar. Ky kapitull diskuton trendin e depozitave, kredive, raportin e varësis dhe ecurinë e tyre, faktorët kryesorë që kanë ndikuar në akumulimin e depozitave, problemet e hasura dhe sfidat. Gjithashtu, ky kapitull

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRITJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRITJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

përmban përpunimin empirik të të dhënave dhe vërtetimin e hipotezës, si edhe analizën cilësore bazuar në intervistat e kryera me drejtues kyç në bankata tregtare të Kosovës.

Kapitulli i pestë, vlerëson nevojën e akumulimit të depozitave vendase nga bankat tregtare në Kosovë për rritjen ekonomike të vendit. Ai gjithashtu përfshin gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e nxjerra nga studimi se si bankat tregtare mund të maksimizojnë akumulimin e depozitave dhe shteti Kosovës të ndërtojë politika të cilat janë të nevojshme për rritjen e depozitave në Kosovë

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RITJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RITJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

KAPITULLI II: RISHIKIMI DHE TRAJTIMI ANALITIK PËRMES LITERATURËS

2.1. Prezantim të trajtimit përmes literaturës

Në disiplinën e menaxhimit të zhvillimit që ofron idetë se si të menaxhohet akumulimi i burimeve vendase për financimin e zhvillimit ekonomik, është një përpjekje e rëndësishme për të krijuar qasje relevante të politikave nga institucionet përkatëse të një shteti për të mobilizuar më tej resurset financiare të nevojshme për të arritur zhvillimin e dëshiruar ekonomik të vendit. Si rezultat dhe një skemë efektive dhe e menaxhuar mirë e akumulimit të burimeve vendase, veçanërisht nga vendet në zhvillim si Kosova do të ishte një mënyrë thelbësore për të siguruar burime të rëndësishme zhvillimore për qëllim të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik të vendit.

Qasja në shërbimet financiare është e rëndësishme për ritjen ekonomike të një vendi në zhvillimin dhe zvogëlimin e varfërisë. Qasja në banka tregtare i mundëson një individ apo biznesi të grumbullojë fonde në një vend të sigurt me kalimin e kohës duke i mundësuar të forcojnë asetet produktive për investime në mikro-ndërmarrje, në asete të reja, pajisje ose në arsim apo shëndetësi, të cilat njëkohësisht luajnë një rol të rëndësishëm në përmirësimin e produktivitetit dhe të ardhurave të një vendi.

Megjithatë, në shumë vende në zhvillim, investimi nga bankat tregtare ose qasja në shërbimet formale financiare për shumicën e varfër të popullsisë mbetet shumë e kufizuar. Kredia është kanali kryesor përmes të cilit kursimet transformohen në investime. Megjithatë, jo të gjitha kursimet përdoren për të financuar investimet pavarësisht nga

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RITJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RITJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

kërkesa e lartë për kredi sepse tregu i kredive në vendet në zhvillim është i kufizuar/racionuar. Në të vërtetë, mungesa e kredisë për bizneset në rajonin e Evropës Jug-Lindore (ku bën pjesë edhe Kosova) krijon një kufizim të rëndësishëm për zhvillimin e këtyre vendeve.

Mungesa e fondeve e ka bërë të vështirë për firmat të investojnë në linja dhe makineri moderne, teknologji të informacionit dhe zhvillimin e burimeve njerëzore të cilat janë kritike në zvogëlimin e kostove të prodhimit, rritjen e produktivitetit dhe përmirësimin e konkurrencës.

Investimet e ulëta janë identifikuar kryesisht tek bankat që nuk dëshirojnë të japin kredi në dispozicion të prodhuesve, për shkak të mospërputhjes mes natyrave afatshkurtra të fondeve të bankave dhe natyrës afatmesme dhe afatgjatë të fondeve të nevojshme nga industritë (siç përmendet edhe në raporte të Bankës Qëndrore të Kosovës) dhe akoma më pak kreditim në drejtim të bujqësisë, duke ditur peshën e rëndësishme që ka ky sektor në ekonominë e Kosovës.

Në literaturë gjenden disa punime të cilat kanë trajtuar marrëdhënien midis kursimeve dhe rritjes ekonomike;

Solow në vitin 1956 theksoi rëndësinë e kursimit në rritjen ekonomike. Modigliani në vitin 1970 në anën tjetër mbështeti faktin se rritja më e lartë rrit pasurinë e jetës së kursimtarëve të rinj në krahasim me jo-kursimtarët në pension, duke shkaktuar kështu rritjen e kursimeve totale në një ekonomi. Kursimet më të mëdha si rezultat shkaktojnë investime më të larta dhe rritje të prodhimit.

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RITJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RITJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

Gjithashtu, në vitin 1973 dy studiues McKinnon dhe Shaw përforcuan idenë se roli i kursimeve në zhvillimin ekonomik të një vendi është shumë i rëndësishëm për faktin se rritja e nivelit të investimeve përshpejton rritjen ekonomike.

Edhe sipas Bisat, El-Erian dhe Helbling në 1997 në analizën e detajuar të rritjes, investimit dhe kursimit për ekonomitë arabe, evidentuan se investimi i sektorit privat konsiderohej si motori i rritjes ekonomike, ndërkohë që roli i sektorit publik ishte më së shumti një komplementar i cili siguron bazën e duhur për trajtimin e këtyre aspekteve. Vendi duhej të bënte reforma të thella strukturore për nxitjen e investimeve dhe kursimeve, si dhe për forcimin e institucioneve. Në këtë mënyrë, vendet arabe do të kenë mundësinë për të shfrytëzuar me efikasitet potencialin ekonomik që ka dhe për të përmirësuar standardin jetësor të popullit në një mënyrë të qëndrueshme.

Sipas Saltz ein 1999, i cili hulumtoi një hipotezë alternative: se normat më të larta të rritjes së PBB-së shkaktojnë një kursim të shtuar. Normat më të larta të rritjes së të ardhurave nxisin normën e kursimeve dhe tërheqin më shumë kursime të huaja. Gjetjet mbështesin hipotezën e fundit në shumë raste. Sajid dhe Sarfraz në 1999 përdorën teknikën Korrektim të Bashkëintegritetit dhe Vektorit të Korrigjimit për të eksploruar marrëdhënien shkakësore midis kursimeve dhe rritjes ekonomike dhe në përfundim rezultatet treguan një marrëdhënie të ndërsjellë afatgjatë midis kursimit dhe nivelit të prodhimit.

Carroll, Overland dhe Weil në vitin 2000 argumentojnë se formimi i zakonit duket më i fortë kur merren në konsideratë provat dinamike. Kjo tregon se kur gjenerohet rritje e PPB (GDP) kjo vjen dhe shoqërohet nga rritje e kursimeve/depozitave. Duke marrë parasysh se të gjitha vendet kanë të njëjtat shije në teknologji dhe si rezultat të njëjtin ritëm të

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RITJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RITJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

qëndrueshëm të rritjes ekonomike të vendit, studimi tregon se formimi i zakonit në konsum krijon një korrelacion pozitiv midis kursimit dhe rritjes përgjatë shtigjeve të tranzicionit drejt zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik të vendit.

Anoruo dhe Ahmad në 2001 shfrytëzuan Bashkë-integrimin dhe VECM për të eksploruar marrëdhëniet shkakore midis rritjes ekonomike dhe normës së kursimit të brendshëm/vendas për disa vende afrikane. Ata përdorën tre lloj metodash për analizë: Procedura e zgjeruar e njësisë Dickey-Fuller, kuadri Johansen dhe Juselius dhe më në fund testimi i Granger-causality. Rezultatet e testit të bashkëintegritit sugjeruan ekzistencën e një marrëdhënie afatgjatë midis rritjes ekonomike dhe shkallës së rritjes së kursimit, ndërkohë që rezultatet e testit të Granger Causality tregonin kundërshtimin e mençurisë konvencionale, rritja ekonomike shkakton ritme rritjeje të kursimeve të brendshme për shumicën e vendeve.

Sipas A. P. Thirlwall në vitin 2002: “sfida e rritjes së kursimeve është shumë e rëndësishme për Egjiptin në mënyrë që të mbajë normën e arritur të rritjes dhe të rrisë normën e investimeve.” Thirlwall studioi rolin e liberalizimit financiar në mënyrë që të stimulojë kursimet dhe investimet, dhe si rezultat rritjen ekonomike të Egjiptit. Nga studimi u konstatua se nëse Egjipti do të vazhdojë të rritet më shumë se 5% në vit pa u mbështetur në huamarrjen e huaj, do të ishte sfiduese për vendin që të vijojë të rrisë ritmin e rritjes së kursimeve vendase. Ndërsa sa i përket kursimeve të pavullnetshme të cilat kryesisht vareshin nga përpjekjet tatimore, rezultuan të jenë të mira sipas standardeve ndërkombëtare që tregojnë se mund të jetë e mundur që vendi të ketë arritur kapacitetin e tij

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RITJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RITJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

të tatueshëm në lidhje me nivelin aktual të zhvillimit. Sidoqoftë, studimi ka rezerva për kursimet e detyruara që vijnë nga inflacioni si pasojë zgjerimit monetar.

Romm në vitin 2003 shqyrtoi shkallën e kursimeve private dhe ndërveprimin e tij me investimet dhe rritjen nëpërmjet Johansen VECM dhe rezultatet sugjeruan se rritja e kursimeve/depozitave vendase ka ndikim direkt dhe indirekt në rritjen ekonomike të një vendi, ndërkohë që më pas rritja ekonomike ka një efekt pozitiv në rritjen e kursimeve vendase, që si pasojë do të kemi përsëri rritjen mëtejshme ekonomike të vendit.

Alguicil, Cuadros dhe Orts në vitin 2004 paraqitën dëshmi në favor të parashikimit të modelit Solow se kursimet më të larta çojnë në rritjen më të lartë ekonomike si argument në kundërshtim edhe të studimeve të tjera që e kundërshtojnë këtë.

Lean and Song në vitin 2008 shqyrtoi marrëdhëniet midis rritjes dhe kursimeve të brendshme dhe ekonomisë në Kinë dhe konstatoi se rritja ekonomike në Kinë është parë të jetë e bashkë-integruar me dy variabla të tjerë: kursimi i ekonomive familjare dhe rritja e kursimit të ndërmarrjeve/bizneseve. Në afat të shkurtër ekziston një shkak bilateral midis rritjes së kursimit të ekonomisë familjare dhe rritjes ekonomike të Kinës, ndërsa në një periudhë afatgjatë ka një shkakësi jodirekte nga rritja ekonomike që çon në rritjen e kursimeve nga ndërmarrjet / bizneset.

Agjion, Comin, Howitt dhe Tecu në vitin 2009 në modelin e tyre teorik, rritja ekonomike rezulton nga risitë që i lejojnë sektorët të arrijnë maksimumin e zhvillimit teknologjik, argumentojnë se: “Në vendet e varfra, ku nevoja për zhvillim kërkon bashkëpunimin e sipërmarrësve vendas me investitorë të huaj, kursimet vendase kanë shumë rëndësi sepse ju mundësojnë sipërmarrësve vendas/lokal të vendosin kapitalin e tyre financiar në investim gjë që rrit sigurinë edhe për investitorët e huaj që të bëhen pjesë e investimeve në zhvillim të këtyre vendeve”.

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RITJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RITJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

Ndërsa, në vendet e pasura, kursimi i brendshëm nuk ka rëndësi për rritjen, pasi sipërmarrësit vendas janë të përfshirë në zhvillim edhe teknologjik dhe nuk kanë nevojë të tërheqin investitorë të huaj. Sipas një regresioni të kryqëzuar për një vend, tregon se kursimet e mbetura janë të lidhura pozitivisht me rritjen e produktivitetit në vendet e varfra, por ky korelacion nuk është në vendet e pasura.

Olapido në vitin 2010 përdori metodologjinë Toda dhe Yamamoto dhe Dolado dhe Lutkepohl - TYDL për të zbuluar lidhjen shkakësore midis kursimeve dhe rritjes ekonomike në Nigeri dhe rezultatet sugjeruan se kursimet dhe rritja ekonomike janë integruar pozitivisht duke treguar një marrëdhënie të qëndrueshme afatgjatë të ekuilibrit.

investimeve të huaja direkte (Ernest, 2004), por të përmendim këtu që në këtë analizë nuk janë marrë parasysh mangësitë në ekonomi që lidhen me rritjen vetëm përmes investimeve të huaja direkte.

Marrëdhënia midis kursimeve të brendshme dhe zhvillimit ekonomik.

Rritja ekonomike është qëllimi i përbashkët i të gjitha shteteve/kombeve. Gjithkush jeton me një standard jetese më të rehatshëm dhe më të mirë se kurrë më parë dhe mban një mirëqenie më të mirë për shkak të rritjes së zhvillimit të tyre ekonomik. Qeveria në çdo vend synon të ul varfërinë dhe të rrisë nivelin e të ardhurave kombëtare. Prandaj, për të arritur objektivin kryesor të rritjes ekonomike, qeveritë mund të zbatojnë lloje të ndryshme të politikave të tilla si nxitja e kursimit, stimulimi i investimeve dhe prodhimit në vendet e tyre (Rasmidatta, 2011).

Investimi kontribuon në rritjen e pasurisë agregate, por investimi nuk mund të rritet pa rritur sasinë e kursimeve. Kështu, kursimet kryejnë një rol të madh në sigurimin e kapaciteteve kombëtare për investime dhe prodhim, të cilat do të ndikojnë në potencialin e rritjes ekonomike. Një pengesë serioze ndaj zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik mund të shkaktohet nga shkalla e ulët e kursimeve të atij vendi. Në perceptimin e përgjithshëm, rritja e kursimeve agregate kontribuon në investime më të mëdha dhe çon në rritjen më të madhe të Prodhimit Përgjithshëm Kombëtar në periudhën afatshkurtër. Kjo do të thotë që shkalla më e lartë e kursimit çon në konsum më të ulët, i cili gjithashtu mund të rezultojë në një sasi më të madhe të investimeve kapitale dhe në fund një shkallë më të lartë të rritjes ekonomike (Rasmidatta, 2011).

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RITJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RITJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

Nga ana tjetër, në disa studime empirike sugjerojnë se kur rritet ekonomia, ekonomia do të kontribuonte në rritjen e të ardhurave personale dhe të shpenzimeve të konsumit për frymë.

Sipas teorisë së prirjes marginale për të kursyer, kursimi zgjerohet nga rritja e të ardhurave. Si rezultat, duke ndjekur këtë koncept mund të kuptohet lehtë se kur ka rritje ekonomike edhe shuma e kursimeve gjithashtu rritet. Në anën tjetër, edhe nëse kursimi ndikon në normën e rritjes së një vendi, nuk ka ndikim afatgjatë në rritjen ekonomike, por vetëm për një periudhë të përkohshme ((Slow, 2004), por nuk tregon qartë thellësinë e efektit.

Burimet e kursimit të brendshëm. Rasmidatta (2011) identifikoi se, burimet e kursimit të brendshëm zakonisht kategorizohen si më poshtë:

1. Kursimet e familjeve/individëve: kursimet e bëra ose të grumbulluara nga anëtarët individualë në një familje përbëhen nga kursimi i sektorit të ekonomisë familjare/shtëpiake.
2. Kursimet private të sektorit të biznesit/korporatave: Kursimet e bëra në korporatat private quhen kursime të sektorit privat. Sektori privat korporativ përbëhet nga:
 - (i) Biznesi vogël, i mesëm dhe i madh (kompani jofinanciare),
 - (ii) Bankat tregtare dhe Institucionet e tjera financiare.
3. Kursimet e sektorit publik: Kursimet e sektorit publik janë të përbëra:
 - (i) kursimet e qeverisë dhe
 - (ii) Kursimet e krijuara nga ndërmarrjet e sektorit publik në formën e burimeve të brendshme.

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRITJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRITJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

2.6. Ecuria e bankave në Kosovë që prej luftës së Kosovës deri më sot

Populli dhe ekonomia e Kosovës, si pjesë e ish Jugosllavisë deri në fund të viteve 1990, ka përjetuar një prej normave më të larta të hiperinflacionit të paraportuara që ka njohur historia botërore duke shkaktuar dëme të mëdha të sistemit financiar dhe të qytetarëve. Depozituesit Kosovar i kursenin paratë e tyre në bankat e Jugosllavisë të cilat funksionin në Kosovë. Depozitat ishin kryesisht në valutën e markës gjermane (DEM) dhe në Dinar, monedha e ish-Jugosllavisë.

Sipas punimit të Institutit Cato, me autor Steve H. Hanke dhe Nicholas Cruss të botuar në 2012, paraqiten disa referenca për hiperinflacionin. Në vitet 1922-1923 të Weimar Germany, në të cilin norma mujore e inflacionit arriti kulmin në 32,400%; në muajin Korrik të vitit 1946, në Hungari u regjistrua norma më e madhe e hiperinflacionit mujor dhe ishte 12 nivele magnitude më të larta se ajo e muajit më të lartë të hiperinflacionit të Weimarit; hiperinflacion tjetër që është përjetuar në Jugosllavi gjatë viteve 1990. Në Janar 1991, nën kontrollin e Slobodan Millosheviçit, parlamenti serb urdhëroi Bankën Kombëtare Serbe (banka qendrore rajonale e Serbisë në atë kohë) që të lëshonte 1.4 miliardë dollarë kredi për njerëz pranë Millosheviçit. Kjo shumë ishte e barabartë me më shumë se gjysmën e të gjitha parave të reja që Bankës Kombëtare të Jugosllavisë (Banka Qëndrore e Jugosllavisë në atë kohë) kishte planifikuar të krijonte në vitin 1991. Si rrjedhim, udhëheqësit e Kroacisë dhe Sllovenisë vendosën për t'u larguar nga Republika Socialiste Federale e Jugosllavisë.

Në Janar 1992, Jugosllavia përjetoi hiperinflacionin e dytë më të lartë dhe të dytë më të gjatë në historinë botërore duke kulmuar në Janar të vitit 1994, kur norma zyrtare mujore e

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRRITJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRRITJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

inflationit ishte 313 milionë %, ose 4 nivele magnitude më të larta se hiperinflacioni i Weimar-Gjermani. Gjithashtu, hiperinflacioni jugosllav zgjati 24 muaj, vetëm dy muaj më i shkurtër se hiperinflacioni sovjetik në fillim të viteve 1920. Banorët e vendeve të Jugosllavisë së mbetur nuk kishin mundësi të blinin ushqime në tregun e lirë, të uritur ata mbanin radhë të gjata në dyqanet shtetërore për ushime të cilësisë së ulët ose kërkuan mbështetje tek të afërmit e tyre që jetonin në fshat. Ndërmjet 1 janarit 1991 dhe 1 prillit 1998, Dinari u zhvlerësua zyrtarisht 18 herë (tre prej të cilave tejkaluan 99%) dhe 22 zero u zhvlerësuan nga shumat në llogaritë bankare.

Në këtë periudhë, shumë depozita të shqipëtarëve të Kosovës mbetën të bllokuara, të pasigurta dhe të zhvlerësuara dhe sistemi financiar në Kosovë ishte nën udhëheqjen e përcaktuar nga regjimi i Serbisë.

Pas përfundimit të luftës në Qershor të vitit 1999, në bazë të rezolutës 1244 (MTA, 1999)¹⁰ përgjegjësinë mbi administrimin e Kosovës e mori Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë, këtej e tutje për lehtësi ashtu siç edhe përdoret në materialet e shkruara do të njihet si UNMIK.

Banka Qëndrore e Kosovës fillimisht e emërtuar si “Autoriteti Bankar dhe i Pagesave të Kosovës” (ABPK) u themelua në 15 Nëntor 1999, nga UNMIK në bazë të Rregullores Nr. 1999/20¹¹. Kapitali i autorizuar sipas kësaj rregullore ishte 5 milion marka Gjermane (DEM). Qëllimi i themelimit ishte që me këtë institucion të kontribohet në forcimin e ekonomisë në Kosovë, duke ofruar një sistem efikas pagesash si dhe një sistem bankar të

¹⁰ *Military Technical Agreement between the International Security Force ("KFOR") and the Governments of the Federal Republic of Yugoslavia and the Republic of Serbia*

¹¹ *Rregullorja e UNMIK (Nr.1999/20): Mbi Autoritetin Bankar dhe të Pagesave të Kosovës*

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRITJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRITJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

shëndoshë. Me këtë rregullore ABPK-ja definohet si "një person juridik publik i veçantë", ndërsa objektivat kryesore të saj ishin:

1. Të zhvillojë një sistem efikas dhe të sigurt për pagesat e brendshme;
2. Të zhvillojë likuiditetin, aftësinë e pagesës si dhe funksionimin efikas të një sistemi bankar të bazuar në tregun e qëndrueshëm.

Në ato vite nuk ka pasur të themeluara banka tregtare, rrjedhimisht një ndër detyrat e ABPK-së ishte "licencimi, mbikëqyrja dhe rregullimi i bankave", detyrë të cilën e kreu me futjen e Rregullores Nr. 1999/21 mbi Licencimin, Monitorimin dhe Rregullimin e bankave tregtare si dhe institucioneve tjera financiare.

ABPK konsiderohet si institucioni që ndërtoi bazat për zhvillimin e tregjeve financiare në Kosovë. Në 24 Gusht 2006, UNMIK-u miratoi rregulloren e re mbi "Autoritetin Qëndror Bankar të Kosovës", me këtë rregullore u fuqizua AQBK-së, por objektivat e saj vazhduan të jenë të mangëta:¹² 1. Të nxisë sigurinë, aftësinë e pagimit dhe funksionimin efikas të sistemit financiar stabil të bazuar në treg, duke inkurajuar daljen e instrumenteve financiare të sigurta në treg dhe 2. Të mbështesë politikat e përgjithshme të ekonomisë në Kosovë, me synim të kontributit në ndarjen efikase të resurseve në pajtim me parimin e ekonomisë së tregut të hapur. AQBK për objektivin e dytë për shkak të rrethanave përveç raporteve mbi sektorin real të ekonomisë nuk pati ndonjë sukses të theksuar.

¹² Rregullore e UNMIK-ut mbi Autoritetin Qendror Bankar të Kosovës http://www.bqk-kos.org/repository/docs/2010/RA2006_47.pdf

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRRITJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRRITJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

Më 15 Qershor 2008, me hyrjen në fuqi të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, hyri në fuqi edhe Ligji Nr. 03/ L-047¹³ (i revokuar më 20 Gusht 2010 duke u zëvendësuar me Ligjin Nr. 03/L-209) mbi Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës-BQK, i cili Bankën Qendrore të Kosovës e përcakton si institucion publik dhe të pavarur që i përgjigjet Kuvendit të Kosovës dhe i siguron asaj pavarësi të plotë funksionale, operative dhe financiare.

Objektivi kryesor i BQK-së është “Të nxisë dhe të mbajë një sistem financiar stabil, duke përfshirë një sistem të sigurt, të qëndrueshëm dhe efikas të pagesave”.

Objektiva shtesë të BQK-së janë:

1. Të kontribuojë në arritjen dhe ruajtjen e stabilitetit të çmimeve vendase;
2. Të mbështet politikat e përgjithshme ekonomike të Qeverisë;
3. Të veprojë në pajtim me parimin e ekonomisë së tregut të hapur me konkurrencë të lirë duke favorizuar shpërndarjen efikase të resurseve.

Në fund të muajit Prill të vitit 2012, u miratua ligji¹⁴ i ri për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jo bankare.

Kosova mbështetur edhe nga sistemi bankar në vend ka pas zhvillim shumë të madh krahasuar me Kosovën e para luftës. Pavarsisht vlerësimeve positive, gjithmonë ka vend për përmirësim dhe kjo evidentohet edhe për vendet e tjera të rajonit në raportin më të fundit të BERZH. Rritja ekonomike në vitin 2016 llogaritet të jetë 3.4 për qind, pak më e

¹³ 2 BQK (2010):Ligji për Bankën Qëndrore të Rep. së Kosovës.pdf

¹⁴ Ligji Nr. 04/L-093 “Për Bankat Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare”

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRIJTEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRIJTJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

ulët se 4 për qind, sa ishte në vitin 2015, por vazhdon të jetë e mirë pas ngadalësimit që pati në vitin 2014 (1.2 për qind), thuhet në raport.

Një program i FMN-së me Qeverinë e Kosovës thuhet në raport, skadoi në gusht 2017. Programi 22 mujor prej 185 milionë eurosh u miratua në korrik të vitit 2015. Në mars të vitit 2017 ai u zgjat deri në gusht, për të ndihmuar vazhdimin e politikave dhe për të lejuar përparime në reformat strukturore. Megjithatë, FMN-ja nuk dha vlerësim përfundimtar dhe nuk bëri livrimin e rreth 15 milionë eurove të fundit të programit, për shkak të mungesës së një qeverie të re, pas zgjedhjeve të përgjithshme të qershorit, thuhet më tutje në raportin e BERZH-it.

Raporti i vlerëson disa nga masat e marra nga Qeveria e Kosovës për të përmirësuar klimën e investimeve. Këtu përfshihet ligji i ri për investimet strategjike, i cili është hartuar për të thjeshtuar procesin për investitorët dhe për të shtuar investimet e huaja të drejtpërdrejta, si edhe përparimi në fushën e zbatimit të kontratave dhe të prokurimeve publike. Raporti i BERSH-it vlerëson gjithashtu masat e marra për të lehtësuar tregtinë mes Kosovës dhe Shqipërisë dhe planet për të përmirësuar lidhjet rajonale të transportit.

Ndër përparësitë kryesore për vitin 2018, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim radhit nevojën për reforma të mëtejshme për përmirësimin e klimës së investimeve. Fushat kryesore që kërkojnë vëmendje përfshijnë rritjen e ndikimit dhe efektivitetit të Këshillit Kombëtar të Zhvillimit Ekonomik, forcimi i kapacitetit të Autoritetit të Konkurrencës dhe mbështetja për zbatimin e ligjit për falimentimin dhe të ligjeve tjera tregtare. Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim thotë se infrastruktura ndërkufitare e transportit duhet të vazhdojë të rritet. Kjo duhet të përfshijë përparimin drejt rehabilitimit dhe

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRIJTEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRIJTJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

përmirësimit të rrugëve kryesore dhe hekurudhore ndërkufitare si dhe përmirësimit të kapacitetit të agjencisë së shërbimeve për kontrollin ajror të vendit. Kosova duhet të ruajë qëndrueshmërinë fiskale. Politikat e matura të ndjekura nga Kosova kanë çuar në uljen e borxhit publik dhe do të jenë të rëndësishme për të rritur besimin e investitorëve, thuhet në raportin e BERZH-it.

Megjithatë, raporti thotë se vendet në të cilat vepron kjo bankë kanë nevojë për një model të ri rritjeje, për t'i ndihmuar ato të kalojnë në një fazë të rritjes së qëndrueshme në të ardhmen. Sipas raportit, rritja ekonomike në këto vende është duke mbetur mbrapa, krahasuar me rritjen që është shënuar në tregje të ngjashme në zhvillim dhe se pas krizës financiare të viteve 2008-2009, shumë ekonomi duket se kanë arritur një “nivel të mesëm të ardhurash”, por nuk po arrijnë të zhvillohen përtej këtij niveli.

Sektori privat u lejua të angazhohej në bankat dhe bizneset e sigurimeve që shënojnë një epokë të re për zhvillimin e sektorit financiar të Kosovës. Si rezultat, investitorët privatë kanë gëzuar mundësinë për të investuar në bizneset e bankave. Aktualisht, industria bankare kosovare ka 10 banka tregtare, të cilat janë plotësisht të zotëruara nga kapital privat vendas dhe i huaj. Operacioni i industrisë mbikëqyret nga Banka Qëndrore e Kosovës (BQK).

Sektori bankar në Kosovë vazhdon të jetë sektori kryesor që kontribuon në stabilitetin dhe zgjerimin e aktiviteteve financiare në vend. Dhjetë banka të licencuara kanë operuar në treg në vitin 2017, nga të cilat, tetë janë në pronësi të huaj. Asetet e bankave të huaja përbëjnë 88 përqind të gjithsej aseteve dhe 90 përqind të gjithsej kapitalit të bankave në treg.

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRIJTEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRIJTJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

Gjithsej asetet e sektorit bankar arritën në 3.88 miliardë euro më 31 dhjetor 2017 (2016: 3.64 miliardë euro). Rritja e gjithsej aseteve në vitin 2017 ishte 6.6 përqind dhe është disi më e ulët se rritja e vitit të mëparshëm prej 7.4 përqind. Rritja e gjithsej aseteve të bankave është ndikuar kryesisht nga një rritje e kredive dhe paradhënieve për konsumatorët, e cila vazhdon të jetë kategoria kryesore e aseteve.

Në territorin e Republikës së Kosovës, bankat tregtare të cilat veprojnë dhe ushtrojnë aktivitetet e tyre përmes degëve/agjensive/zyrave të tyre, janë:

1. PROCREDIT Bank

ProCredit Holding është kompania prind e një grupi global bankash ProCredit e cila operon në Evropën Lindore, Amerikën Latine si dhe në Gjermani. ProCredit Holding është themeluar si Internationale Micro Investitionen AG (IMI) në vitin 1998 nga kompania pioniere konsulente për zhvillimin financiar Zeitinger Invest GmbH. ProCredit Holding është aksionar 100%. “ProCredit Bank SH.A. Kosova” (“Banka”) është regjistruar në Republikën e Kosovës, më 9 Dhjetor 1999, si shoqëri aksionare. Banka ka filluar punën e saj, më 12 Janar 2000. Banka është filial në pronësi të plotë të “ProCredit Holding AG & Co. KGaA” (ProCredit Holding). Selia dhe vendi i biznesit- Selia e bankës ndodhet në rrugën “George Bush”, Nr. 26, 10000, Prishtinë, Republika e Kosovës.

Numri i degëve/pikave: 7 regjione (Prishtinë, Pejë, Mitrovicë, Gjakovë, Ferizaj, Prizren dhe Gjiilan) me 23 degë/pika shërbimi. Numri i punëtorve: 492 në 2017, ndërsa numri më i madh i punësuar ka qenë 2543 në vitin 2011. Arsyejtimi: Aplikimi/shtimi i teknologjisë informative, zvogëlim i degëve/pikave.

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRITJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRITJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit (gjithsej kapitali ndaj mjeteve të peshuara me rrezik) / Capital adequacy ratio (total capital to risk weighted assets): 18.5%. Treguesi i kthimit në mjetet mesatare (KMM) (të hyrat neto ndaj mjeteve mesatare) / Return on average assets (ROAA) indicator (net income to average assets): 2.4%. Treguesi i kthimit në ekuitetin mesatar (KEM) (të hyrat neto ndaj ekuitetit mesatar) / Return on average equity (ROAE) indicator (net income to average equity): 19.7%. Margjina neto e interesit (të hyrat neto nga interesi ndaj mjeteve mesatare fitimprurëse) / Net interest margin (net interest income to average earning assets): 4.7%. Asetet ne fund të 2017- 793,238,000.00€. Detyrime ne fund të 2017-695,968,000.00€

2. RAIFFEISEN Bank

Raiffeisen Bank International AG e konsideron Austrinë, ku është një korporatë dhe bankë investuese udhëheqëse, si dhe Evropën Qendrore dhe Lindore (EQL), si tregun e saj amë. Bankat filiale mbulojnë 14 tregje në gjithë rajonin e EQL. Pas bashkimit në mars të vitit 2017 me Raiffeisen Zentralbank Österreich AG (RZB AG), aksionari i saj kryesor i mëparshëm, RBI AG mori të gjitha të drejtat, obligimet dhe funksionet e kompanisë transferuese RZB AG në tërësi, në veçanti rolin e institucionit qendror për Grupin Bankar Austriak Raiffeisen. Raiffeisen SEE Region Holding GmbH është aksionari që ka në pronësi 100% të Raiffeisen Bank Kosovo J.S.C. Raiffeisen SEE Region Holding GmbH është 100 % në pronësi indirekte të Raiffeisen. Bank International AG. Banka operon sipas licencës bankare të lëshuar nga BQK më 8 nëntor 2001. Aktivitetet kryesore afariste të Bankës janë aktivitetet bankare komerciale dhe retail brenda Kosovës. Më 31 dhjetor 2017 Banka ka 8 degë dhe 38 nëndegë brenda Kosovës (31 dhjetor 2016: 8 degë dhe 42

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRITJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRITJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

nëndegë). Zyra e regjistruar e Bankës është e vendosur në adresën në vijim: Rruga UÇK nr. 51, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës.

Numri i punëtorve: 882 në 2017, ndërsa numri më i madh i punësuar ka qenë 1144 në vitin 2011. Arsyetimi: Aplikimi/shtimi i teknologjisë informative, zvogëim i degëve/pikave.

Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit (gjithsej kapitali ndaj mjeteve të peshuara me rrezik) / Capital adequacy ratio (total capital to risk weighted assets): 20.38%. Treguesi i kthimit në mjetet mesatare (KMM) (të hyrat neto ndaj mjeteve mesatare) / Return on average assets (ROAA) indicator (net income to average assets): 2.4%. Treguesi i kthimit në ekuitetin mesatar (KEM) (të hyrat neto ndaj ekuitetit mesatar) / Return on average equity (ROAE) indicator (net income to average equity): 17.61%. Margjina neto e interesit (të hyrat neto nga interesi ndaj mjeteve mesatare fitimprurëse) / Net interest margin (net interest income to average earning assets): 5.05%. Asetet ne fund të 2017- 900,919,000.00€. Detyrime ne fund të 2017-775,604,000.00€

3. NLB Bank

NLB Banka Sh.a. është bankë komerciale (“Banka”) e regjistruar në Regjistrin e Kosovës nën Certifikatën e Regjistrimit nr. 70053484 të datës 18 dhjetor 2007. Banka është krijuar nga bashkimi i dy bankave, NLB Kasabank dhe Banka e re e Kosovës (gjatë vitit 2007 të dy bankat ishin nën kontroll të Nova Ljubljanska Banka d.d.), dhe ka fituar licencën për aktivitete bankare më 19 dhjetor 2007 nga Banka Qendrore e Kosovës (“BQK”). Banka kontrollohet nga Nova Ljubljanska Banka d.d. Ljubljana me qendër në Slloveni (Banka amë), e cila posedon 81.21% të aksioneve të zakonshme sipas datës 31 dhjetor 2017.

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRRITJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRRITJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

Aksionari i vetëm i Nova Ljubljanska Banka d.d. Ljubljana është Republika e Sllovenisë që posedon 100% të aksioneve sipas datës 31 dhjetor 2017. Qendra e Bankës gjendet në Rr. Ukshin Hoti nr. 124, Prishtinë, Kosovë.

Banka vepron si bankë komerciale për të gjitha kategoritë e klientëve, përmes rrjetit të saj me 9 degë në Prishtinë, Gjakovë, Pejë, Ferizaj, Mitrovicë, Gjiilan, Besianë, Prizren, dhe 35 nën-degë. Banka më 31 dhjetor 2017 ka pasur 481 të punësuar.

Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit (gjithsej kapitali ndaj mjeteve të peshuara me rrezik) / Capital adequacy ratio (total capital to risk weighted assets). 15.9%. Treguesi i kthimit në mjetet mesatare (KMM) (të hyrat neto ndaj mjeteve mesatare) / Return on average assets (ROAA) indicator (net income to average assets): 2.2%. Treguesi i kthimit në ekuitetin mesatar (KEM) (të hyrat neto ndaj ekuitetit mesatar) / Return on average equity (ROAE) indicator (net income to average equity): 20.7%. Margjina neto e interesit (të hyrat neto nga interesi ndaj mjeteve mesatare fitimprurëse) / Net interest margin (net interest income to average earning assets): 4.9%. Asetet ne fund të 2017- 584,868,000.00€. Detyrime ne fund të 2017-519,273,000.00€

4. Dega e TEB Kosovë

Me 19 Dhjetor 2007, TEB sh.a. ka marrë licencë për veprimtari bankare bazuar në rregullat e BQK-së. Banka filloi gjatë Janarit 2008. Banka është e kontrolluar nga TEB Holding me veprimtari në Turqi ("Prindi"), e cila zotëron 100% të aksioneve të zakonshme. Aksionarët e TEB Holding janë pjesë e "BNP Paribas" dhe "Çolakoglu Group", ku secili zotëron nga 50% të aksioneve të Bankës.

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRITJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRITJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

Më 31 dhjetor 2017 Banka ka 27 degë në 7 Regjionet (Prishtinë, Gjakovë, Pejë, Ferizaj, Mitrovicë, Gjiilan, Prizren) . Zyra e regjistruar e Bankës është e vendosur në adresën në vijim: Rr. Agim Ramadani nr.15, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës. Numri i punëtorve: 593 në 2017.

Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit (gjithsej kapitali ndaj mjeteve të peshuara me rrezik) / Capital adequacy ratio (total capital to risk weighted assets): 21.11%. Treguesi i kthimit në mjetet mesatare (KMM) (të hyrat neto ndaj mjeteve mesatare) / Return on average assets (ROAA) indicator (net income to average assets): 3.14%. Treguesi i kthimit në ekuitetin mesatar (KEM) (të hyrat neto ndaj ekuitetit mesatar) / Return on average equity (ROAE) indicator (net income to average equity): 17.59%. Margjina neto e interesit (të hyrat neto nga interesi ndaj mjeteve mesatare fitimprurëse) / Net interest margin (net interest income to average earning assets): 7.05%. Asetet ne fund të 2017- 486,700,000.00€. Detyrime ne fund të 2017-400,333,000.00€

5. BKT (Dega Kosovë)

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a.- Dega në Kosovë ("BKT Kosova Branch" ose "Banka") është në pronësi të plotë dega e Bankës Kombëtare Tregtare Sh.a ("BKT") në Tiranë. BKT - Dega e Kosovës është regjistruar më 30 Gusht 2007 me Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës ("BQK") për të operuar si bankë në Republikën e Kosovës dhe është subjekt i rregulloreve të BQK-së. Banka ofron një gamë të gjerë të shërbimeve universale për ndërmarrjet publike dhe private dhe për të individë në Republikën e Kosovës. Burimi kryesor i financimit për Bankën janë depozitat, të cilat janë të pranuar në forma të ndryshme duke përfshirë llogaritë rrjedhëse, kërkesën dhe depozitat me afat, si në EUR

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRITJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRITJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

ashtu edhe në ato të huaja monedhë. BKT ofron një shumëllojshmëri të kredive të korporatave dhe të konsumit, kartat e debitit dhe të kreditit në përputhje me EMV, ATM, kanale alternative të sofistikuara, shërbime të kualifikuara ndërkombëtare bankare dhe thesari të ndryshëm produktet. Zyra administrative e degës së BKT-Kosovës ndodhet në Prishtinë.

Rrjeti në Kosovë përfshin 27 njësi. Tetë njësi janë të vendosura në Prishtinë, dhe njësi të tjera janë të vendosura në Prizren, Pejë, Gjiilan, Ferizaj, Mitrovicë, Gjakovë, Vushtrri, Fushë Kosovë, Podujevë, Denas, Rahovec, Viti, Lipjan, Aeroporti i Prishtinës dhe Skenderaj.

Numri i punëtorve: 348 në 2017, ndërsa numri ka qenë më i madh në vitet paraprake.

Arsyetimi: Aplikimi/shtimi i teknologjisë informative.

Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit (gjithsej kapitali ndaj mjeteve të peshuara me rrezik) / Capital adequacy ratio (total capital to risk weighted assets): 11.49%. Treguesi i kthimit në mjetet mesatare (KMM) (të hyrat neto ndaj mjeteve mesatare) / Return on average assets (ROAA) indicator (net income to average assets): 1.87%. Treguesi i kthimit në ekuitetin mesatar (KEM) (të hyrat neto ndaj ekuitetit mesatar) / Return on average equity (ROAE) indicator (net income to average equity): 21.60%. Margjina neto e interesit (të hyrat neto nga interesi ndaj mjeteve mesatare fitimprurëse) / Net interest margin (net interest income to average earning assets): 4.19%. Asetet ne fund të 2017- 340,881.00€. Detyrime ne fund të 2017-310,218,000.00€.

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRITJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRITJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

6. Banka Për Biznesin-BPB

Banka Private e Biznesit Sh.a. ka marrë licencën për aktivitete bankare me 29 mars 2001 dhe ka filluar operimin me 24 prill 2001. Bazuar në vendimin e Bordit të Drejtorëve më 28 shkurt 2005 dhe pas miratimit final nga Banka Qendrore e Kosovës ("BQK") më datë 22 mars 2005, Banka ka ndryshuar emrin nga Banka Private e Biznesit në Banka për Biznes ("Banka"). Në vitin 2006, Banka është regjistruar si shoqëri aksionare ("Sh.a") me kapital vendor-gjithsejt 18 aksionar.

Banka operon si një bankë komerciale dhe e kursimeve për të gjitha kategoritë e konsumatorëve brenda Kosovës nëpërmjet rrjetit të 8 degëve dhe 19 nën degëve të saj të vendosura në Kosovë (2016: 7 degëve dhe 19 nën degë). Zyra e regjistruar e Bankës është e vendosur në adresën në vijim: Rruga UÇK nr. 51, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës. Numri i punëtorve: 368 -2017.

Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit (gjithsej kapitali ndaj mjeteve të peshuara me rrezik) / Capital adequacy ratio (total capital to risk weighted assets): 15.4%. Treguesi i kthimit në mjetet mesatare (KMM) (të hyrat neto ndaj mjeteve mesatare) / Return on average assets (ROAA) indicator (net income to average assets): 3.0%. Treguesi i kthimit në ekuitetin mesatar (KEM) (të hyrat neto ndaj ekuitetit mesatar) / Return on average equity (ROAE) indicator (net income to average equity): 31.9%. Margjina neto e interesit (të hyrat neto nga interesi ndaj mjeteve mesatare fitimprurëse) / Net interest margin (net interest income to average earning assets): 6.9%. Asetet ne fund të 2017- 204,923.000.00€. Detyrime ne fund të 2017-184,942,000.00€

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRRITJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRRITJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

7. Banka Ekonomike-BE

Banka Ekonomike është licencuar më 28.05.2001, ndërsa punën e ka filluar në fillim të qershorit të po këtij viti. Nga momenti i licencimit, Banka Ekonomike, ka pësuar ndryshime të rëndësishme, në të gjitha aspektet e zhvillimit dhe është banka e vetme me 100% kapital vendor. Banka Ekonomike ka një rrjetë të zhvilluar në mënyrë graduale dhe të shpërndarë në gjithë territorin e Kosovës.

Banka Ekonomike aktualisht ka 31 njësi bankare, nga të cilat, 7 degë janë në qendrat kryesore të Kosovës dhe 24 nëndegë gravitojnë nëpër njësitë më të vogla regjionale. Zyra e regjistruar e Bankës është e vendosur në adresën në vijim: Rruga UÇK nr. 51, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës. Numri i punëtorve: 341 -2017 ky nr ka shënuar rritje në krahasim me 2013 që kishte 303.

Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit (gjithsej kapitali ndaj mjeteve të peshuara me rrezik) / Capital adequacy ratio (total capital to risk weighted assets): 14.59%. Treguesi i kthimit në mjetet mesatare (KMM) (të hyrat neto ndaj mjeteve mesatare) / Return on average assets (ROAA) indicator (net income to average assets): 1.67%. Treguesi i kthimit në ekuitetin mesatar (KEM) (të hyrat neto ndaj ekuitetit mesatar) / Return on average equity (ROAE) indicator (net income to average equity): 15.5%. Margjina neto e interesit (të hyrat neto nga interesi ndaj mjeteve mesatare fitimprurëse) / Net interest margin (net interest income to average earning assets): 6.21%. Asetet ne fund të 2017- 239,329,000.00€. Detyrime ne fund të 2017-213,164,000.00€.

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRITJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRITJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

8. Iş Bank-Dega Kosovë

Türkiye İş Bankası A.Ş.- Dega në Kosovë ("Banka" ose "Dega") është degë e Türkiye İş Bankası A.Ş. Njësi turke. Banka funksionon si një bankë komerciale dhe e kursimeve për të gjitha kategoritë e konsumatorëve brenda Kosovës. Banka vepron nën një licencë bankare me numër 011 të lëshuar nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, regjistruar në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë më 19 nëntor 2012. Türkiye İş Bankası A.Ş.- Dega në Kosovë është një degë e Türkiye İş Bankası A.Ş. Aksionarët kryesorë të Türkiye İş Bankası A.Ş dhe pjesëmarrjet e tyre në kapitalin aksionar më 31 dhjetor 2017 janë si vijon: - Fondi i Pensionit Isbank, duke vepruar në emër të punonjësve të Bankës Aktive dhe të Pensionit: 39.95%; -Float falas: 31.96% (rreth 60% e notave të lira mbahen nga investitorë të huaj); - Aksionet e Ataturkut: 28.09%. Partia Popullore Republikane (CHP) është trashëgimtari testamentar i aksioneve fillimisht i mbajtur nga Ataturku (themeluesi i Isbank). Banka ofron një gamë të gjerë të shërbimeve universale për ndërmarrjet publike dhe private dhe për të individë në Republikën e Kosovës. Burimi kryesor i financimit për Bankën janë depozitat, të cilat janë të pranuar në forma të ndryshme duke përfshirë llogaritë rrjedhëse, kërkesën dhe depozitat me afat, si në EUR ashtu edhe në ato të huaja monedhë.

Banka operon me dy degë. Një zyrë ndodhet në UÇK 43, në Prishtinë dhe një tjetër në rrugën Zahir Pajaziti, në Prizren.

Asetet ne fund të 2017- 99,728,197.00€. Detyrime ne fund të 2017-90,655,072.00€.

Mungojnë të dhënat tjera për tregus tjerë financiar

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRRITJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRRITJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

9. Dega e Ziraat Bank Prishtinë

E themeluar në vitin 1863, Ziraat Bank është bankë Turke më rrënjë më të thella, e cila ofron gamë të gjerë të shërbimeve bankare në Turqi. Banka gjithashtu qëndron si një fuqi kombëtare dhe rajonale me aftësinë për të ofruar shërbime të integruara financiare.

Numri i punëtorve: 68-2017

Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit (gjithsej kapitali ndaj mjeteve të peshuara me rrezik) / Capital adequacy ratio (total capital to risk weighted assets): 77.33%. Treguesi i kthimit në mjetet mesatare (KMM) (të hyrat neto ndaj mjeteve mesatare) / Return on average assets (ROAA) indicator (net income to average assets): -1%. Treguesi i kthimit në ekuitetin mesatar (KEM) (të hyrat neto ndaj ekuitetit mesatar) / Return on average equity (ROAE) indicator (net income to average equity): -2.53%. Margjina neto e interesit (të hyrat neto nga interesi ndaj mjeteve mesatare fitimprurëse) / Net interest margin (net interest income to average earning assets): 3.68%.

10. Dega e Komercialna Banka sh.a. Beograd (Kosovë)

Nuk ka të dhena të mjaftueshme

2.7. Mbikëqyrja dhe mjedisi rregullator për depozitat dhe likuiditetin në Kosovë

Politikat rregullatore dhe mbikëqyrëse të bankave mbesin të ndryshme. Vendet mund t'i kufizojnë bankat në një gamë të ngushtë aktivitetesh ose t'u lejojnë atyre të angazhohen në një grup të gjerë. Meqenëse fushëveprimi i aktiviteteve të lejueshme ndryshon në vende të ndryshme, sepse ekonomia dhe bankat nuk janë të njëjta në të gjitha vendet. Rregullimi

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRIJTJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRIJTJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

bankar në kuptimin e saj më të rreptë i referohet kornizës së ligjit dhe rregullave në të cilat veprojnë bankat. Ligji dhe rregullimi bankar shtrihen në aspekte të ndryshme të veprimtarisë bankare, duke përfshirë ata që mund të hapin banka, cilat produkte mund të ofrohen dhe si bankat mund të zgjerohen. Arsyeimi më i rëndësishëm për rregullimin në fushën bankare është trajtimi i shqetësimeve për sigurinë dhe stabilitetin e institucioneve financiare (Barth, Caprio, dhe Levine, 2006). Sektori bankar karakterizohet nga një nivel i lartë i krizës bankare.

Në përgjithësi, rregullimi i tregut bankar synon të sigurojë trajtimin e drejtë të pjesëmarrësve. Shumë rregullore janë miratuar në përgjigje të praktikave mashtruese. Një nga synimet kryesore të rregullimit është që të sigurojë zbardhjen apo zbulimin, transparencën e informacionit të saktë për vendimmarrjen e investimeve. Kur informacioni zbulohet vetëm për një grup të kufizuar investitorësh, atëherë ata do të kanë avantazhe të mëdha mbi grupet e tjera të investitorëve. Rregulloret e fundit u miratuan në përgjigje të falimentimeve të mëdha, rishikimin e qeverisjes korporative, me qëllim forcimin e rolit të auditorëve në mbikëqyrjen e procedurave të kontabilitetit dhe menaxhimit të risqeve nga Bankat Tregtare.

Akti Sorbanes-Oxley i vitit 2002 në SHBA është projektuar veçanërisht për të shtrënguar qeverisjen e kompanive pas falimentimit të Enron. Ajo pati pasoja direkte në nivel ndërkombëtar, para së gjithash përmes kompanive globale. Ligji për Reformën dhe Mbrojtjen e Konsumatorit në Shtetet e Bashkuara të vitit 2010 (Dodd-Frank) ka për qëllim të imponojë një rregullim më të rreptë financiar për tregjet financiare dhe ndërmjetësit financiar në SHBA, në mënyrë që të sigurohet mbrojtja e konsumatorit.

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRIJTJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRIJTJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

Në këtë linjë është punuar nga Banka Qëndrore e Kosovës në përmirësimin e kuadrit ligjor dhe rregullator të sistemit bankar të Kosovës. Kjo është në harmoni me zhvillimin e sistemit të rregullimit financiar në BE dhe në pjesë të tjera të botës. Kosova si vend që aderohet të jetë pjesë e Bashkimit Evropian, kryen përjasje të kuadrit të saj ligjor dhe rregullator me Direktivat e BE-së, Parimet e Basel dhe praktikatat më të mira të vendeve të zhvilluara.

Ligji Nr. 04/L-093 “Për Bankat Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare” përbën ligjin bazë mbi të cilin bazohet edhe kuadri rregullator për industrinë bankare në Kosovë. Ligji ka dhënë kompetenca dhe detyra që BQE të rregullojë, licencojë dhe mbikëqyrë industrinë bankare për të luajtur një rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik; në sistemin e pagesave dhe shlyerjes; në stabilitetin makroekonomik; dhe për të siguruar sigurinë, qëndrueshmërinë dhe stabilitetin e sistemit bankar të vendit.

Në Nenin 1 të këtij ligji gjendet: “Qëllimi i këtij ligji është nxitja dhe mbarëvajtja e një sistemi të qëndrueshëm financiar nëpërmjet promovimit të menaxhimit të shëndoshë dhe të matur të bankave, institucioneve mikrofinanciare dhe institucioneve tjera financiare jobankare dhe sigurimit të një niveli të përshtatshëm mbrojtës të interesave të depozitorëve.”

Në Neni 2: “Fushëveprimi. Ky ligj zbatohet për të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari bankare dhe financiare, aksionarët e tyre, Bordin e Drejtorëve dhe Menaxherët e lartë, punonjësit, agjentët dhe filialet e tyre si dhe për veprimtarinë e institucioneve mikrofinanciare dhe institucioneve tjera financiare jobankare.”

Veprimtaria bankare është veprimtaria e pranimit të depozitave nga publiku dhe përdorimin e fondeve qoftë tërësisht apo pjesërisht me qëllim të dhënies së kredive apo investimeve në rrezik të vetë bankës.

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRITJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRITJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

Depozitë - shuma e parave që i paguhet një banke nga një person ose subjekt juridik, e cila pranohet nga banka me kusht që të kthehet në tërësi, me ose pa interes a prim qoftë me kërkesë ose në kohën e dakorduar me atë person ose subjekt juridik;

BQK-ja refuzon një licencë, nëse sipas gjykimit të saj të arsyetuar, lëshimi i një licence të tillë do të:

2.1. Vinte në rrezik qëndrueshmërinë financiar të bankës së propozuar ose të sistemit bankar në përgjithësi;

2.2. Rrezikonte interesat e depozitorëve të bankës së propozuar; apo

2.3. Zvogëlonte në mënyrë substanciale konkurrencën.

Me licencat e tyre bankat në Kosovë autorizohen për t'u angazhuar në aktivitetet e pranimit të depozitave (në formën e llogarisë rrjedhëse, depozitave me afat ose në forma të tjera depozite) me ose pa interes në një valutë të këmbyeshme; blerjen dhe shitjen për llogari të vetë bankës, të letrave me vlerë të lëshuara ose të garantuara nga qeveria ose Banka Qëndrore e Republikës së Kosovës ose Bashkimit Evropian të denominuara dhe të pagueshme në valutën euro të depozitave të bankës dhe me afat maturimi që nuk tejkalon një vit; dhënien e kredive, duke përfshirë kreditë konsumuese dhe hipotekare; blerjen dhe shitjen me ose pa të drejtë tërheqjeje të parave dhe financimin e transaksioneve tregtare; dhe blerjen dhe shitjen e mjeteve të kredive nga një bankë tjetër a institucion financiar; etj.

BQK-ja mund të kërkojë nga banka e huaj që është licencuar për të operuar më një ose më shumë degë në Kosovë që ta kthejë degën në subjekt të varur të bankës së huaj nëse BQK-

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRITJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRITJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

ja konsideron se operacionet e degës mund të rrezikojnë stabilitetin financiar të sektorit banka ose mund të jenë të dëmshme për interesin e depozitorëve.

Lidhur me konfliktin e interesave, çdo drejtor, menaxher i lartë apo punonjës banke ka për obligim ligjor pavarësinë, besueshmerinë dhe kujdesin ndaj bankës ku shërbejnë dhe ndaj depozitorëve të bankës dhe për vendosjen e interesave të bankës para interesave të veta.

Në Nenin 46 të këtij ligji, shprehet kufizimi në koncentrimin e depozitave për bankat: “Një bankë nuk mund të mbajë depozita nga çfarëdo fonde një burimore në shumë më të madhe se njëzet përqind (20%) të depozitave të saj të përgjithshme. Për qëllimet e këtij paragrafi “një burimor” përkufizohet të jetë një subjekt juridik, një person ose shuma e përgjithshme e të gjithë shfrytëzuesve të të hyrave nga organet qeveritare të cilat klasifikohen si organizata buxhetore të Kosovës.”

Sipas Nenit 58, Zbatimi dhe masat përmirësuese, shprehet se BQK ka të drejtë: “të kërkojë që normat e interesit që banka paguan mbi depozitat të mos tejkalojë normat mbizotëruese të interesit mbi depozitat në shuma dhe maturim të krahasueshëm në rajonin ku banka është vendosur, siç përcaktohet nga BQK-ja”

Në Kapitullin për administrimin zyrtar të bankave nga BQK, në Nenin 60 gjenden shkaqet për caktimin e administratorit zyrtar:

“1. BQK-ja mund ta caktojë një administrator zyrtar në një bankë nëse:

1.1. BQK-ja përcakton se banka ka shkelur ndonjë dispozitë të ligjit ose të rregullores, apo është angazhuar në praktika të pasigurta dhe jo të shëndosha, në atë mënyrë që dobëson gjendjen e bankës, rrezikon seriozisht **interesat e depozitarëve** apo shpërmdan aktivën e bankës;

1.2. BQK-ja ka shkak të arsyeshëm për të besuar se banka ose menaxherët e lartë ose drejtorët e saj janë përfshirë në aktivitete kriminale të dënueshme me burgim prej njëviti a më shumë, në atë mënyrë që rrezikon **interesat e depozitorëve**,”

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRITJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRITJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

Lidhur me fushën e këtij studimi, paraqet interes të citojmë disa prej kërkesave të rregullores “Për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit” të miratuar më datë 29 nëntor 2012, ku shprehet në qëllimin dhe fushëveprimin të saj se kjo rregullore është të vendosë standardet dhe kërkesat minimale për menaxhimin efektiv të rrezikut të likuiditetit nga bankat, dhe se kjo rregullore aplikohet për të gjitha bankat dhe degët e bankave të huaja të licencuara nga BQK-ja për të operuar në Republikën e Kosovës.

Ndërsa në nenin 11 të saj përcaktohen parimet e menaxhimit të rrezikut të likuiditetit, të cilat janë për:

- mbështetjen në burime të qëndrueshme financimi,
- minimizim të hendekut të maturitetit kontraktual dhe hendekut të maturitetit,
- diversifikimin e burimeve të financimit sipas llojit, monedhës, instrumenteve, maturimit, numrit të klientëve dhe tregjeve, duke konsideruar nivelin e likuiditetit të tyre,
- zgjerimin e ekuilibruar/të kontrolluar të veprimtarisë dhe të ruajtjes së një vlere të mjaftueshme të aktiveve likuide,
- disponueshmërinë e burimeve njerëzore për menaxhimin efektiv të rrezikut të likuiditetit.

Kërkesa të tjera të kësaj rregullore shprehen në nenin 14 të saj lidhur me monitorimin e burimeve të financimit dhe koncentrimi i tyre, ku kërkohet që banka të monitorojë në mënyrë periodike burimet e financimit me qëllim ruajtjen e një baze të diversifikuar të këtyre burimeve si dhe identifikimin e koncentimeve të mundshme. Ndërkohë që koncentrimet analizohen sipas burimit të financimit, llojit të financimit, tregut, koncentrimit gjeografik, monedhës, sipas maturitetit, depozitorët më të mëdhenj, llojet e

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRTJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRTJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

depozitave, si edhe monitoron nivelin e koncentrimin të llogarive rrjedhëse dhe depozitave, etj. Ndërsa në nenin 17, për normat e likuiditetit kërkohet që bankat të mbajnë likuiditetin në një shumë, strukturë dhe norma që e lejojnë atë të përmbushë detyrimet e saj dhe angazhimet e marra sipas afateve kohore, me një kosto të arsyeshme dhe me një rrezik minimal. Si dhe, banka përlllogarit dhe siguron në çdo kohë respektimin e treguesit të mjeteve likuide ndaj detyrimeve afatshkrutëra në valutën Euro dhe valutën e huaj në nivelin minimal 20% (njëzet përqind) dhe valutat totale në nivelin minimal 25 % (njëzet e pesë përqind).

2.8. Roli i bankave tregtare në akumulimin e depozitave të brendshme në Kosovë

Nevoja për të zhvilluar institucionet e brendshme të tregut financiar dhe modelet e sjelljes të nevojshme për të gjeneruar dhe mobilizuar burimet e brendshme si një kusht kyç e kanë origjinën në punën klasike të Schumpeter (1934). Megjithëse ndryshon madhësia relative e ndikimit që i atribuohet bankave dhe institucioneve të tjera financiare në vendet në zhvillim, përsëri ekziston një konsensus i pranueshëm se burimet financiare janë një faktor shumë i rëndësishëm në zhvillimin ekonomik. Meqenëse problemi i akumulimit të burimeve financiare është i lidhur ngushtë me problemin e kursimeve, qasja e fundit kërkon një marrëveshje institucionale e cila inkurajon dhe akumulon kursimet në njërën anë dhe që kanalizon kursimet për t'u angazhuar në investime produktive nga ana tjetër. Me fjalë të tjera, varësia më e madhe nga burimet e brendshme të kapitalit kërkon një gamë të gjerë të institucioneve financiare plotësisht të pavarura, të organizuara dhe të përshtatura, të cilat duhet të akumulojnë burimet e brendshme me qëllim të formimit të kapitalit (Agu, 1984).

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RITJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RITJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

Bankat tregtare si ndërmjetës financiare kanë rolin kryesor dhe themelor në inkurajimin, akumulimin e kursimeve/depozitave vendase dhe kreditimin e tyre përmes degëve dhe zyrave të tyre (Khatkhate, D.R dhe K.Riechel, 1980).

Burimi kryesor i fondeve për bankat tregtare në Kosovë janë depozitat që ato mobilizojnë nga familjet dhe tepricat e tjera të kompanive. Ekonomia në zhvillim karakterizohet nga mjedise makroekonomike të paqëndrueshme si inflacioni, politika të papërshtatshme fiskale dhe monetare dhe kontrole të normave të interesit (Opoku, 2011).

Efekti neto është ndryshimi i likuiditetit që ndikon në kursimet dhe formimin e kapitalit. Aty ku mjedisi makroekonomik është i favorshëm për kursimet atëherë bankat tregtare janë në një pozicion më të mirë për të rritur kursimet. Përkundrazi, kur politikat makroekonomike e zhdukin likuiditetin nga duart e njerëzve, atëherë depozitat zvogëlohen dhe mund të ndikojnë negativisht në rritjen e kapitalit dhe investimet në vend (Opoku, 2011).

Bankat tregtare janë kontrolluesi kryesor i sistemit financiar në Kosovë që kryen ndërmjetësimin financiar. Ato kontrollojnë pjesën më të madhe të fondeve të investimeve nga depozitat vendase dhe janë kreditorët kryesorë të korporatave, SME-ve dhe investitorëve individualë. Megjithatë, shuma e fondeve të brendshme që akumulojnë bankat tregtare në Kosovë është shumë më poshtë se niveli i mjaftueshëm. Vëllime të mëdha fondesh lihen jashtë sistemit bankar dhe nevojiten përpjekjet e bankave tregtare për t'i shfrytëzuar ato në përdorime produktive.

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RITJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RITJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

Bankat tregtare në vendet në zhvillim vazhdojnë të mbizotërojnë në ndërmjetësimin financiar dhe kanë detyrimin të zgjerojnë depozitat e tyre me qëllim që të shtrijnë më shumë hua (Opoku, 2011).

Niveli afatgjatë i investimeve në ekonominë kombëtare lidhet ngushtë me nivelin e kursimeve kombëtare. Kursimet e popullsisë janë pjesë përbërëse e sistemit ekonomik. Ekzistenca e kursimeve rrit mundësinë e zhvillimit të ardhshëm. Kursimet e popullsisë në Kosovë janë burimi më i rëndësishëm i investimeve për zhvillimin e sektorit real (bujqësia dhe prodhimi), sepse kapitali i huaj investohet kryesisht në prodhimin e burimeve natyrore. Është me rëndësi jetike që shteti të mobilizojë kursimet e njerëzve në ekonomi. Për shkak të kësaj, shteti do të jetë më pak i varur nga investimet e huaja dhe investimet vendase të akumuluar për shkak të kursimeve të njerëzve do të sigurojnë stabilitet më të mirë të vendit. Kjo në afat të gjatë mund të kontribuojë në rritjen ekonomike dhe zhvillimin e vendit (Bahiramil, 2010).

Për të ruajtur një normë të qëndrueshme rritjeje në ekonominë e Kosovë ishte e nevojshme të rriteshin investimet me burime të brendshme. Shuma e kursimeve të brendshme mund të shërbejë mirë për këtë qëllim. Rishpërndarja e burimeve financiare nga ata që zotërojnë për ata që kanë nevojë është thelbësore për ekonominë. Tradicionalisht familjet grumbullojnë burime financiare dhe bizneset kanë nevojë për këto burime. Kështu, kursimet e brendshme dhe investimet janë të ndërlidhura. Për të transformuar kursimet në investime, kursimet duhet të tërhiqen nga bankat tregtare në vend dhe gjithashtu procesi i transformimit të kursimeve në investime të kryera nga tregjet financiare dhe ndërmjetësuesit financiar (ibid).

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RITJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RITJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

Studimi tregon se për të mbështetur rritjen ekonomike është e nevojshme të sigurohet stabiliteti makroekonomik dhe të zhvillohen institucione të forta financiare dhe të tregut të fondeve për të siguruar akumulimin dhe transformimin e kursimeve në investime. "Raporti i kursimeve private ka tendencë të rritet bashkë me zhvillimin e sistemit financiar ((Koskela, E., Viren, M., 1983).

Institucionet e forta financiare lehtësojnë rrjedhën e fondeve nga kursimet në investime. Edhe nëse kursimet janë të larta në vend por pa tregje të zhvilluara të kapitalit dhe ndërmjetësuesve financiar atëherë këto kursime nuk do të përdoren efektivisht pasi nuk mund të kanalizohen në investime. Nga ana tjetër, zhvillimi i pamjaftueshëm i sistemit të ndërmjetësve financiar ul normën e rritjes së ekonomisë dhe mund të bëjë të pamjaftueshme akumulimin e kursimeve.

2.9. Përfundime

Në përfundim të kapitullit për trajtimin e literaturës është e nevojshme të konstatojmë se për të mbështetur rritjen ekonomike të Kosovës është e nevojshme të sigurohet stabiliteti makroekonomik dhe të zhvillohen banka tregtare eficiente dhe të mirë- qeverisura për të siguruar rritjen e akumulimit të kursimeve të kosovarëve dhe transformimin e këtyre kursimeve në investime për ekonominë e Kosovës.

"Raporti i kursimeve private ka tendencë të rritet së bashku me zhvillimin e sistemit financiar" (Koskela E., Viren M. 1983 faqe 117). Bankat tregtare që janë të mirë-qeverisura lehtësojnë qarkullimin e fondeve nga kursimet në investime.

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRIJTEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRIJTJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

Edhe në qoftë se kursimet janë të larta në një vend si Kosova e cila ka edhe mungesë të tregut të kapitaleve, por ky vend nuk ka banka tregtare të zhvilluara dhe eficiente atëherë nuk do të ketë akumulim dhe përdorim të këtyre kursimeve pasi ato nuk mund të kanalizohen në investime përmes bankave tregtare të cilat janë institucionet financiare të specializuara për ndërmjetësim financiar dhe që sipas kuadrit ligjor në fuqi të shtetit të Kosovës janë të vetmet institucione financiare që kanë si veprimtari të lejuar dhe kryesore të tyre pikërisht akumulimin e depozitave dhe investimin e tyre për rritjen e kapitalit financiar në ekonomi. Si rrjedhin, zhvillimi i pamjaftueshëm i sistemit bankar të Kosovës sjell uljen e normës së rritjes së ekonomisë së Kosovës dhe bën të pavlefshëm mundësinë e rritjes ekonomike të vendit përmes akumulimit të kurimeve.

Banka Qëndrore e Kosovës, si organi rregullator dhe mbikëqyrës ka një rol të madh në sigurimin e performancës optimale nga ana e bankave tregtare në Kosovë. Zhvillimi i sektorit real të çdo ekonomie nuk është një çështje që duhet t'i lihen variablat e rastit, Banka Qëndrore e Kosovës duhet të ndërhyjë për të siguruar që objektivat e saj janë arritur vazhdimisht. Kreditorët e këqinj pavarësisht se në një nivel të ulët për Kosovën krahasuar me vendet e tjera të rajonit, duhet të ndiqen pa tolerancë përmes legjislacionit për të siguruar që depozitat e Kosovarëve të mos investohen në drejtimin e gabuar dhe gjithashtu të forcohet disiplina në sjelljen e huamarrësve. Këto do të sigurojnë që bankat të kenë një performancë optimale pasi më shumë depozita do të kanalizohen në investime produktive dhe do të ketë rritje të gjallërisë në tregjet e parasë dhe kapitalit, duke arritur kështu edhe një rritje të shëndoshë ekonomike të Kosovës.

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RITJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RITJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

Shteti i Kosovës si hartues i politikave të Kosovës duhet të fokusohet në rritjen e nivelit të kursimeve private vendase, sepse problemi kryesor për vendet në zhvillim është mungesa e investimeve, të cilat si rrjedhim kufizojnë rritjen ekonomike të vendit. Kursimet e deritanishme të kosovarëve kanë shërbyer si potenciali kryesor i burimeve financiare për investime kapitali në Kosovë dhe kanë dhënë kontribut të padiskutueshëm dhe të pazëvendësueshëm për zhvillimin dhe rritjen e ekonomisë së shtetit të pavarur të Kosovës.

Duke kanalizuar kursimet në ekonomin e Kosovës nëpërmjet investimeve në kapital financiar të shëndetshëm atëherë Kosova bëhet më e zhvilluar ekonomikisht dhe politikisht. Është e rëndësishme të sigurohet vijueshmëri e rritjes së kursimeve, sepse kjo do të çojë në akumulimin e kapitalit dhe akumulimi i kapitalit do të siguroj vijueshmërinë e rritjes ekonomike të vendit.

Rritja e nivelit të akumulimit të kursimeve të brendshme në sistemin bankar të Kosovës do të shërbejë për zgjidhjen e problemeve të papunësisë dhe zhvillimin e sipërmarrjes dhe do të ndikojë pozitivisht në normën e zhvillimit ekonomik të Kosovës.

Një problem i madh me të cilin ballafaqohet çdo vend në zhvillim është barra e borxheve të jashtme dhe varësia nga bankat ndërkombëtare apo bankat e vendeve të tjera. Bankat tregtare në vend pas sigurimit të rritjes së akumulimit të kursimeve mund të sigurojnë nxitje për sipërmarrësit vendas për të marrë rreziqe dhe për të përdorur burimet (faktorët e prodhimit) për prodhim të mirave për konsum. Pra, bankat tregtare mund të ndihmojnë në arritjen e vetë-mjaftueshmërisë së vendit ku ato ushtrojnë veprimtarinë e tyre. Bankat mund të ofrojnë kredi për të zhvilluar sektorë të ndryshëm ekonomikë dhe sidomos ato prodhuese. Kjo do të rezultojë në reduktimin e importeve dhe në rritjen e eksporteve.

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRIJTJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRIJTJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

Prandaj, bankat janë shumë të rëndësishme për të arritur vetë-mjaftueshmërinë e burimeve financiare.

Zbatimi i teknologjisë moderne. Zhvillimi ekonomik pa përdorimin e teknologjisë së përparuar dhe më të përditësuar është e pamundur. Pothuajse në të gjitha sektorët ekonomikë në Kosovë ashtu si edhe në vendet e tjera të pazhvilluara përdoren teknikat e prapambetura të prodhimeve për shkak të varfërisë dhe mungesës së kapitalit financiar. Bankat tregtare mund të sigurojnë më shumë fonde për njerëzit për të bërë të mundur përdorimin e teknikave moderne të prodhimit. Nga zbatimi i teknologjisë moderne arrihet rritje në nivelin e prodhimit kombëtar të një vendi, ulje të kostos së prodhimit dhe kursim të kohës.

Nëse një vend në zhvillim zotëron një sistem bankar të shëndetshëm finaciarisht, të mirë qeverisur dhe eficient, atëherë rritja e nivelit të akumulimit të kursimeve në bankat tregtare është një matës i besueshëm për zhvillimin ekonomik të atij vendi¹⁵.

¹⁵Për më tepër shih: Rritja dhe zhvillimi i financimit në ekonomitë e tranzicionit: Roli i kursimeve të brendshme/vendore, 2000. Komisioni Ekonomik i Kombeve të Bashkuara për Evropën)

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRIJTJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRIJTJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

KAPITULLI I III: METODOLOGJIA E KËRKIMIT

3.1. Hyrje

Ky kapitull mbulon metodat e studimit. Objekti i kërkimit, metodat dhe teknikat, popullsia dhe madhësia e mostrës së studimit, natyra dhe burimi i të dhënave, si edhe vlefshmëria dhe besueshmëria e të dhënave.

Për arritjen e objektivave të këtij studimi lidhur me ndikimin e kursimeve/depozitave vendase nga bankat tregtare në Kosovë dhe rritjes së qëndrueshme ekonomike të saj krahas studimit të literaturës përkatëse u realizua edhe një intervistë e thelluar, me pyetje të hapura dhe të pastrukturuara me përfaqësues të lartë të bankave, të cilët janë shumë të rëndësishëm dhe besohet të rrisin cilësinë dhe besueshmërinë e të dhënave. Prandaj, intervistat u kryen me dhjetë (10) persona kyç të bankave në zyrën e tyre në mënyrë personale

Metodologjia e përdorur në këtë punim do jetë në funksion të realizimit të këtij qëllimi. Ajo kombinon të dhënat primare me ato sekondare. Të dhënat sekondare janë rezultat i rishikimit dhe i analizës së thelluar të një literature që lidhet specifikisht me ndikimin e depozitave në rritjen e qëndrueshme të ekonomisë së Kosovës. Kjo literaturë është siguruar nga kërkimet e ndryshme elektronike, studime të ngjashme të vendeve fqinje dhe rajonit etj, institucione ndërkombëtare si BB etj, si dhe nga një sërë burimesh të tjera duke shërbyer për të plotësuar pjesën teorike të punimit.

Metodat e arritjes së qëllimit të studimit janë nga më të ndryshmet duke parë dhe duke vlerësuar njëkohësisht avantazhet dhe disavantazhet e secilës prej tyre. Përdorimi i intervistave si metodë për mbledhjen e të dhënave në këtë material mundëson jo vetëm

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRITJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRITJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

analizimin e lidhjeve të mundshme ndërmjet variablave të marrë në studim, por jep mundësinë edhe të disa rekomandimeve lidhur me këtë çështje.

Sipas Khandwalla (1976) nuk ka një metodë kërkimi që mund të konsiderohet si më e mira. Secila nga metodat e përdorura shoqërohet me avantazhe dhe disavantazhe. Zgjedhja e metodës mund të bëhet duke u mbështetur në disa kriteret.

Sipas (Boyce 2006) Intervistimi i thelluar është një teknik hulumtimi cilësor që përfshin kryerjen e intervistave intensive individuale me një numër të vogël të të anketuarve për të eksploruar perspektivat e tyre mbi një ide, program apo situatë të veçantë. Përveç kësaj, intervistat e thelluara janë të dobishme për të eksploruar çështje të reja në thellësi të cilat shpesh përdoren për të siguruar kontekstin e të dhënave të tjera (të tilla si të dhënat e rezultateve), duke ofruar një pamje më të plotë të asaj që ndodhi dhe pse.

Besueshmëria dhe vlefshmëria e analizës konsiderohet si shumë të rëndësishme gjithashtu. Vlefshmëria e lidhur me kriteret ka të bëjë me aftësinë e pyetjeve për të bërë parashikimet e duhura. Për këtë mund të përdoret analiza statistikore e korrelacionit. Besueshmëria (testimi i besueshmërisë) ka të bëjë me faktin nëse intervistat do prodhojnë ose jo rezultate të qëndrueshme në kohë të ndryshme dhe në zgjedhje të ndryshme.

Pra, gjatë hartimit të pyetjeve të intervistës u bë kujdes që të mbaheshin parasysh dy elementë kryesore si: besueshmëria e cila ka të bëjë me faktin nëse intervista do të prodhojë ose jo rezultate të qëndrueshme në kohë të ndryshme dhe për zgjedhje të ndryshme, si dhe vlefshmëria e pyetjeve. Për të vlerësuar vlefshmërinë e përmbajtjes u përdor metoda e “panelit të ekspertëve”, të cilët morën pjesë në hartimin e intervistës. Pyetjet janë formuluar në mënyrë të tillë që të jenë sa më të kuptueshme nga të gjithë të intervistuarit. Gjatë

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRRITJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRRITJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

hartimit të saj një rëndësi të veçantë ju kushtua jo vetëm strukturimit të pyetjeve por edhe formulimit të tyre në mënyrën e duhur në mënyrë që edhe përgjigjet të ishin të vlefshme dhe në dobi të synimit kryesor. Kampioni i zgjedhur përfundimisht ka intervistat e 10 drejtuesve kryesorë të bankave tregtare në Kosovë. Intervistat janë kryer gjatë një komunikimi ballë për ballë me ta në ambjentet e punës së tyre.

3.2 Hartimi i Kërkimeve

Objektivi kryesor i këtij studimi është të identifikojë akumulimin e burimeve të brendshme financiare nëpërmjet Bankave Tregtare për zhvillim ekonomik dhe gjithashtu identifikimin e sfidave që mund të jenë pengesë për performancën efektive të akumulimit të depozitave të bankave në Kosovë. Nga këndvështrimi i këtij objektivi specifik, lloji i dizajnit të hulumtimit të ndërmarrë në këtë studim hulumtues është tip përshkrues sepse është më i dobishëm për të eksploruar dhe përshkruar praktikën ekzistuese të bankave dhe gjithashtu është më e përshtatshme për të përshkruar sfidat të cilat pengojnë performancën e bankave tregtare.

Dizajn i mostrës. Ekzistojnë 10 banka private tregtare që operojnë në industrinë bankare të Kosovës, të cilat janë konsideruar për qëllime krahasimi.

3.3. Popullsia dhe madhësia e mostrës

Popullsia e studimit është 10 (dhjetë) bankat tregtare në Kosovë. Bankat tregtare që ishin në veprim gjatë periudhave janë konsideruar në hulumtimin për shkak të qasjes në të dhënat e gatshme. Gjatë studimit është konsideruar për peshim të gjetjeve edhe pesha e tregut që

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRITJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRITJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

ka secila bankë në tregun bankar të Kosovës. Bazuar në qëllimin e mbledhjes së të dhënave nga të gjitha bankat tregtare që operojnë në Kosovë, studimi përfshin:

NLB Banka; Banka për Biznes; Türkiye Cumhuriyeti Ziraat Bankasi **(Dega në Kosovë)**; Banka Ekonomike; Raiffeisen Bank Kosovo; ProCredit Bank; TEB SH.A.; Banka Kombëtare Tregtare **(Dega Kosovë)**; Türkiye Is Bankasi **(Dega në Kosovë)**; Komercijalna Banka ad Beograd **(Dega Mitrovicë)**;

3.4. Lloji i të dhënave dhe burimet

Burimi i të dhënave sekondare i përdorur përfshinte pasqyrat financiare të audituara dhe të publikuara dhe raportet vjetore për vitet 2010 deri në vitin 2017. Burime të ndryshme janë përdorur për të siguruar të dhënat e nevojshme për këtë studim kërkimor. Të dhënat e përdorura janë siguruar nga: Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN); Banka Botërore (BB), Banka e Shqipërisë (BSH); Indeksi Mundi. Si edhe faqet e internetit të bankave të ndryshme tregtare, broshura, puna kërkimore e kaluar, libra si dhe mediat e shkruara u analizuan gjithashtu për informacione. Periudhat u zgjodhën për shkak të qasjes në të dhëna të gatshme nga Raportet Vjetore të BQK të cilat u mbledhën nëpërmjet kontakteve me organet përkatëse.

Gjithashtu, Për të qenë në gjendje të zbatojë Testin e Bashkë-Integritetit Johansen dhe për të zbuluar marrëdhëniet që ekzistojnë midis PBB-së dhe kursimeve të brendshme në këtë studim janë vërejtur të dhëna vjetore për periudhën 2010 - 2017 në Kosovë.

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRIJTEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRIJTJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

3.5. Vlefshmëria e të dhënave

Vlefshmëria ka të bëjë me saktësinë e të dhënave. Pra, vlefshmëria i referohet masës në të cilën të dhënat e marra janë të sakta për qëllimin. Studiuesi ushtroi vlefshmëri duke kërkuar një raport vjetor të audituar dhe të publikuar nga organi kompetent përkatës i bankave. Të dhënat sidomos, Raportet Vjetore të BQK-së nuk përbënin ndonjë problem për kërkuesin, pasi që ato ishin “jashtë zonës së tyre të indiferencës” dhe prandaj ishin të vërtetë. Kjo ndihmoi studiuesin të merrte informacionin përkatës për qëllimin e studimit. Intervistat e thella u krijuan për të mbledhur informacione të vlefshme dhe të besueshme përmes përgjigjeve të të intervistuarit në një rend të planifikuar pyetjesh, por duke ju ofruar konfidencialitetin e plotë.

3.6. Besueshmëria e të dhënave

Besueshmëria e të dhënave ka të bëjë me konsistencën e saj. Kështu, besueshmëria i referohet masës në të cilën të dhënat janë të njëjta pa marrë parasysh burimin e tyre. Kjo është, të dhënat në mënyrë specifike, raportet vjetore të BQK-së nuk ishin në kundërshtim me njëra-tjetrën dhe prandaj ishin të besueshme sepse të dhënat e të gjitha raporteve vjetore të BQK-së burojnë nga pasqyrat financiare të audituara dhe mbikëqyrura të secilës bankë.

3.7. Metoda e Analizës së të Dhënave

Analiza e të dhënave siç përcaktohet nga Montgomery (1991) është një ekzaminim i kujdesshëm i informacionit të mbledhur në një formë të organizuar me qëllim që të kuptohet tendenca në rritje në çdo situatë. Creswell (2005) përkufizoi analizën e të dhënave si një proces i cili përfshin nxjerrjen e konkluzioneve dhe shpjegimin e gjetjeve në fjalë për

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRRITJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRRITJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

njëstudim.

Për analizën e të dhënave u përdorën si metodat sasiore ashtu edhe ato cilësore. Të dhënat sasiore të fituara të llojeve të ndryshme nga burimet përkatëse u analizuan me përdorimin e teknikave të thjeshta deskriptive statistikore, si përqindjet dhe mesataret. Tabela dhe grafikët janë përdorur për paraqitjen e të dhënave të analizuar. Të dhënat që janë mbledhur përmes intervistës së thelluar janë analizuar duke përdorur qasjen induktive. Sipas Talja (1998), analiza cilësore shpesh filloi duke analizuar dhe numëruar shpërndarjen e përgjigjeve në pyetje me pyetje.

3.8 Metodatat empirike të përdorura

Metodat e përdorura për analizën e këtij studimi i referohen kryesisht metodave që i përshtaten serive kohore dhe kryesisht testit Dickey – Fuller (DF) , Augmentit Dickey – Fuller (ADF) dhe testin Ganger Causality.

3.8.1 Testi Ganger Causality.

Testi Granger është një mënyrë për të hetuar shkakshmërinë midis dy variablave në një seri kohore. Metoda është një llogari probabilitare e kauzalitetit; ai përdor grupe të të dhënave empirike për të gjetur modele korrelacioni. Një variabël X është shkak për variabël Y nëse X është shkak i Y ose Y është shkak i X. Shkakësia është e lidhur ngushtë me idenë e kauzës dhe efektit, megjithëse nuk është saktësisht e njëjtë. Një variabël X është shkak për variabël Y nëse X është shkak i Y ose Y është shkak i X. Megjithatë, me testin Granger, nuk jemi duke testuar një marrëdhënie të vërtetë shkak-pasojë.

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRIJTJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRIJTJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

Ajo që duam të dimë është nëse një ndryshore e caktuar vjen para një tjetër në serinë kohore.

Me fjalë të tjera, në rast se gjeni të dhënat e Grangerit në të dhënat tuaja, nuk ka një lidhje shkakësore në kuptimin e vërtetë të fjalës.

Shënim: Kur ekonometritë thonë "shkaku", ajo që ata nënkuptojnë është "Granger-shkaku", edhe pse një fjalë më e përshtatshme mund të jetë "përparësi", (Leamer, 1985).

Testi Granger është një procedurë "nga poshtë lart", ku supozimi është se proceset e gjenerimit të të dhënave në çdo seri kohore janë variabla të pavarur; atëherë grupet e të dhënave analizohen për të parë nëse ato lidhen.

E kundërta është një metodë "lart poshtë" e cila supozon se proceset nuk janë të pavarura; grupet e të dhënave pastaj analizohen për të parë nëse ato gjenerohen në mënyrë të pavarur nga njëri-tjetri.

Hipoteza zero për provën është se vlerat x -të mbetura nuk shpjegojnë variacionin në y .

Me fjalë të tjera, ai supozon se $x(t)$ nuk e bën Granger-shkaktojë $y(t)$. Teorikisht, ju mund të ekzekutoni testin Granger për të kuptuar nëse dy variabla lidhen me një moment të menjëhershëm në kohë. Procedura mund të bëhet komplekse për shkak të numrit të madh të opsioneve, duke përfshirë zgjedhjen nga një sërë ekuacionesh për llogaritjet e vlerës f . Mund të kalojmë shumicën dërrmuese të hapave të ndërmjetëm duke përdorur softwerin.

Testi i shkakësisë së Granger është pjesë e shumë paketave softwerike të njohura ekonomike, duke përfshirë E-Views dhe PC-Give. Çdo numër i mbetjeve mund të zgjidhet me disa klikime. Sigurohemi që koha është e palëvizshme përpara se të vazhdojmë. Të dhënat duhet të transformohen për të eliminuar mundësinë e autokorrelacionit. Gjithashtu

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRRITJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRRITJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

duhet të sigurohemi që modeli të mos ketë rrënjë njësi, pasi këto do të anashkalojnë rezultatet e testimit.

Shënojmë hipotezën e pavlefshme dhe hipotezën alternative. Për shembull, $y(t)$ nuk e bën Granger-shkaktojë $x(t)$. Zgjedhim vonesat. Kjo kryesisht varet nga sa të dhëna kemi në dispozicion. Një mënyrë për të zgjedhur vonesat i dhe j është që të ekzekutojmë një test të rendit të modelit (dmth. Të përdorë një metodë përzgjedhjeje të rendit të modelit).

Mund të jetë më e lehtë vetëm të marrësh disa vlera dhe të ekzekutosh testin Granger disa herë për të parë nëse rezultatet janë të njëjta për nivele të ndryshme të vonesave.

Rezultatet nuk duhet të jenë të ndjeshme ndaj vonesave. Gjejmë vlerën f .

Dy ekuacione mund të përdoren për të gjetur nëse $\beta_j = 0$ për të gjitha vonesat j :
ne testin e Grangerit : i kufizuar (i lartë) dhe i pakufizuar (në fund).

$$\begin{aligned} y(t) &= \sum_{i=1}^{\infty} \alpha_i y(t-i) + c_1 + v_1(t) \\ y(t) &= \sum_{i=1}^{\infty} \alpha_i y(t-i) + \sum_{j=1}^{\infty} \beta_j x(t-j) + c_2 + v_2(t) \end{aligned} \quad (1)$$

Në mënyrë të ngjashme, këto ekuacione testojnë nëse $y(t)$ Granger-shkakton $x(t)$:

Llogarisim f -statistic duke përdorur ekuacionin e mëposhtëm:

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRRITJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRRITJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

$$x(t) = \sum_{i=1}^{\infty} \alpha_i x(t-i) + c_1 + u_1(t)$$

$$x(t) = \sum_{i=1}^{\infty} \alpha_i x(t-i) + \sum_{j=1}^{\infty} \beta_j y(t-j) + c_2 + u_2(t)$$

(2)

Hedhim poshtë hipotezën zero nëse statistika F është më e madhe se vlera f .

$$F = \frac{(ESS_R - ESS_{UR})/q}{ESS_{UR}/(n-k)}$$

(3)

Nëse keni një numër të madh të variablave dhe vonesave, testimi juaj F mund të humbasë fuqinë. Një alternativë do të ishte që të kryhet një test i chi-katror (katrorëve të vegjël), i ndërtuar me raportin e gjasave ose testet e Uollit. Edhe pse të dyja versionet japin praktikisht të njëjtin rezultat, F -test është shumë më i lehtë për të kandiduar të parin Testin e Gangerit do e testojmë në aplikimin me të dhënat tona në hapat e analizës.

3.8.2 Testi Dickey – Fuller (DF), Augmentit Dickey – Fuller (ADF)

Në statistikat, testi Dickey-Fuller teston hipotezën zero që një rrënjë njësie është e pranishme në një model autoregresiv.

Hipoteza alternative është e ndryshme në varësi të versionit të provës që përdoret, por zakonisht është stacionaritet ose prirje stacionare. Ky emërtim është përdorur për nder të statistikaneve David Dickey dhe Wayne Fuller, të cilët zhvilluan testin në vitin 1979.

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRRITJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRRITJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

Testimi i Dickey Fuller (ADF) është test i rrënjës njësi për stacionaritet.

Rrënjët e njësisë mund të shkaktojnë rezultate të paparashikueshme në analizën e serive kohore.

Testi i shtuar i Dickey-Fuller mund të përdoret me korrelacion serik.

Testi i ADF mund të trajtojë modelet më komplekse sesa testi Dickey-Fuller, dhe është gjithashtu më i fuqishëm. Por duhet të përdoret me kujdes, sepse - ashtu si shumica e testeve të rrënjës njësi - ka një shkallë relativisht të lartë të Shkallës I. Lidhur me këtë test kemi hipotezat e ndërtuara për provën: Hipoteza zero për këtë provë është se ekziston një rrënjë njësie.

Hipoteza alternative ndryshon pak në bazë të ekuacionit që do përdorim .

Alternativa bazë është se seria kohore është stacionare (ose trend-stacionare). E rëndësishme është dhe zgjedhja e modeleve dhe vonesave. Para se të ekzekutoni një test ADF, inspektohen të dhënat për të gjetur një model të përshtatshëm regresioni.

Për shembull, një tregues jo-zero tregon se regresioni do të ketë një afat konstant.

Tre modelet themelore të regresionit janë:

• Nuk ka konstante, asnjë trend: $\Delta y_t = \gamma y_{t-1} + v_t$

• Konstant, pa trend: $\Delta y_t = \alpha + \gamma y_{t-1} + v_t$

• Konstantja dhe trendi: $\Delta y_t = \alpha + \gamma y_{t-1} + \lambda t + v_t$

Dickey Fuller shton diferencat e mbetura me këto modele si më poshtë :

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRRITJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRRITJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

Jo konstante, Jo tendencë:
$$\Delta y_t = \gamma y_{t-1} + \sum_{s=1}^m a_s \Delta y_{t-s} + v_t \quad (4)$$

Konstante, Jo tendencë:
$$\Delta y_t = \alpha + \gamma y_{t-1} + \sum_{s=1}^m a_s \Delta y_{t-s} + v_t \quad (5)$$

Konstante dhe tendencë:
$$\Delta y_t = \alpha + \gamma y_{t-1} + \lambda_t + \sum_{s=1}^m a_s \Delta y_{t-s} + v_t \quad (6)$$

Për të vazhduar me testin duhet të zgjidhet një gjatësi vonese . Gjatësia e vonesës duhet të zgjidhet në mënyrë që mbetet të mos lidhen në mënyrë seriale. Kemi disa opsione për zgjedhjen e vonesave:

Minimizojmë kriterin e informacionit të Akaike (AIC) ose kriterin e informacionit Bayesian (BIC), ose bie derisa vonesa e fundit është statistikisht e rëndësishme. Megjithëse ka software që mund të ekzekutojë testin, zakonisht për të interpretuar rezultatet, në përgjithësi, një p-vlerë prej më pak se 5% do të thotë që mund të refuzosh hipotezën e pavlefshme se ekziston një rrënjë njësie.

Gjithashtu mund të krahasojmë statistikën e llogaritura DFT me një vlerë kritike të tabelës. Nëse statistika e DFT-së është më negative sesa vlera e tabelës, refuzohet i hipoteza zero e rrënjës njësi. Shënim: Sa më negativ të jetë statistika e testit të DF-së, aq më e fortë është prova për hedhjen poshtë të hipotezës zero të një rrënjë njësi. Statistikat e testit të DF referuar burimit të Fuller, W. A. (1976) në tabelën e mëposhtme

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRRITJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRRITJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

$$DF_{\tau} = \frac{\hat{\gamma}}{SE(\hat{\gamma})} \quad (7)$$

Critical values for Dickey–Fuller t-distribution.				
	Without trend		With trend	
Sample size	1%	5%	1%	5%
T = 25	-3.75	-3.00	-4.38	-3.60
T = 50	-3.58	-2.93	-4.15	-3.50
T = 100	-3.51	-2.89	-4.04	-3.45
T = 250	-3.46	-2.88	-3.99	-3.43
T = 500	-3.44	-2.87	-3.98	-3.42
T = ∞	-3.43	-2.86	-3.96	-3.41

Fig 2. Shembull të Dickey –Fuller t-distribution,

Excel nuk ka një funksion të ndërtuar për testin e ADF-së, por mund të përdoret me të dhënat duke përdorur karakteristikat e regresionit dhe t-test në softuer.

Hapat nuk janë të lehta për t'u bërë dhe kërkojnë shumë formula (është shumë më e lehtë për të bërë në softwerë të tjerë si R ose SAS).

Ne konsiderojmë procesin në formën stochastike;

$$y_i = \phi y_{i-1} + \varepsilon_i$$

Nëse $|\phi| = 1$, kemi atë që quhet një rrënjë njësie.

Në veçanti, nëse $\phi = 1$, kemi një stacion të rastit (pa domethënie), e cila nuk është stacionare.

Në fakt, nëse $|\phi| = 1$, procesi nuk është i palëvizshëm, ndërsa nëse

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RITJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RITJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

$|\phi| < 1$, procesi është i palëvizshëm.

Ne nuk do ta konsiderojmë rastin kur $|\phi| > 1$ më tej që në këtë rast procesi quhet eksploziv dhe rritet me kalimin e kohës.

Ky proces është një proces autoregresiv i rendit të parë, AR (1), të cilin e studiojmë më hollësisht në Proceset Autoregresive.

Gjithashtu do të shohim pse proceset e tilla pa rrënjë njësi janë të palëvizshme dhe pse përdoret termi "rrënjë".

Testi Dickey-Fuller është një mënyrë për të përcaktuar nëse procesi i mësipërm ka një rrënjë njësie. Qasja e përdorur është shumë e drejtpërdrejtë. Së pari llogaritni diferencën e parë, dmth;

$$y_i - y_{i-1} = \phi y_{i-1} + \varepsilon_i - y_{i-1}$$

$$\text{i.e. } y_i - y_{i-1} = (\phi - 1)y_{i-1} + \varepsilon_i$$

Nëse përdorim operatorin delta, të përcaktuar nga $\Delta y_i = y_i - y_{i-1}$ dhe vendosim $\beta = \phi - 1$,

atëherë ekuacioni bëhet ekuacioni linear i regresionit;

$$\Delta y_i = \beta y_{i-1} + \varepsilon_i$$

ku $\beta \leq 0$ dhe kështu që testi për ϕ transformohet në një test që parametri i pjerrësisë $\beta = 0$.

Kështu, kemi një test (pasi β nuk mund të jetë pozitiv) ku

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRITJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRITJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

$H_0: \beta = 0$ (ekuivalent me $\phi = 1$)

$H_1: \beta < 0$ (ekuivalent me $\phi < 1$)

Nën hipotezën alternative, nëse b është vlerësimi i katrorëve më të vegjël (OLS) të β , dhe kështu $\phi\text{-bar} = 1 + b$ është vlerësimi OLS i ϕ , atëherë për një vlerë n mjaft të madhe kemi si më poshtë :

$$\sqrt{n}(\phi - \hat{\phi}) \sim N(0, s.e.)$$

ku $s.e. = \sqrt{1 - \phi^2}$

Mund të përdorim metodën e zakonshme të regresionit linear, përveç se kur hipoteza zero e mban koeficienti t nuk ndjek një shpërndarje normale dhe kështu nuk mund të përdorim testin e zakonshëm t .

Në vend të kësaj, ky koeficient ndjek një shpërndarje tau, kështu që testi ynë konsiston në përcaktimin nëse statistika tau τ (e cila është ekuivalente me statistikën e zakonshme t) është më pak se τ_{crit} bazuar në një tabelë të vlerave statistikore kritike tau të paraqitura në tabelen e Dickey-Fuller.

Nëse vlera e llogaritur e tau është më e vogël se vlera kritike në tabelën e vlerave kritike, atëherë kemi një rezultat të rëndësishëm; përndryshe pranojmë hipotezën e pavlefshme se ka një rrënjë njësie dhe se koha nuk është stacionare. Për të kuptuar më mirë këtë test do sqarohet në hapat e mëposhtëm me të dhënat tona në shërbim të arritjes së objektivave .

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRIJTEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRIJTJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

KAPITULLI IV: ANALIZAT (TRAJTIMI EMPIRIK, SASIOR DHE CILËSOR)

4.1. Hyrje

Në kapitujt e mëparshëm u prezantua rishikimi i literaturës dhe metodat e hulumtimit të miratuara në këtë studim, ndërsa ky kapitull merret me analizën e të dhënave nga burimet sekondare dhe ato primare, diskutimin dhe zbulimin e tyre.

Ky kapitull ka 4 pjesë, pjesa e parë paraqet një prezantim të përgjithshëm të ecurisë së tregut bankar në Kosovë duke u fokusuar tek veprimtaria kryesore e tyre që është akumulimi i depozitave dhe investimi i tyre gjithashtu.

Pjesa e dytë e kapitullit paraqet trajtimin empirik për vërtetimin e hipotezës së ngritur për lidhjen mes rritjes së akumulimit të kursimeve nga bankat tregtare dhe rritjes ekonomike të Kosovës.

Pjesa e tretë diskuton mbi performancën e përgjithshme të bankave tregtare në akumulimin e burimeve vendase, si burimet e mobilizuara mbështesin zhvillimin e ekonomisë, dhe pjesa e fundit paraqet gjetjet dhe sfidat e bankave tregtare në resurset vendase efektive të cilat janë në dispozicion për të financuar ekonominë bazuar në rezultatet e thelluara të intervistës.

Në 17 vitet e fundit Kosova ka qënë në fazën historike të transformimit ekonomik, duke pasë një rritje të jashtëzakonshme ekonomike. Sipas të dhënave të publikuara Kosova ka pasë rritjen më të lartë krahasuar me vendet e tjera të Evropës Jug-Lindore, por këto 5 vitet

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RITJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RITJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

e fundit rritja nuk ka qënë me të njëtin ritëm si më parë por është luhatur me një mesatare mes 3.5 deri në 5 %. Sipas raporteve të institucioneve ndërkombëtare, për vendet në zhvillim, bankat tregtare në Kosovë kanë luajtur rol të rëndësishëm në akumulimin e kursimeve dhe përmes tyre në mbështetjen e investimeve dhe aktiviteteve zhvillimore.

Në Kosovë, të gjitha bankat tregtare mobilizojnë 3 lloje të depozitave: llogari rrjedhëse (depozita të transferueshme), llogari kursimi (depozitat e kursimit) dhe depozita me afat (depozitat e afatizuara), nga të gjithë agjentët ekonomikë, përfshirë individët, ndërmarrjet private dhe , institucionet financiare dhe qeverinë. Madhësia e depozitave ka qënë vazhdimisht në rritje gjatë kohës, edhe pse norma ndryshon nga viti në vit dhe ka tendencë rënëse. Akumulimi i depozitave ka marrë vrull të fortë gjatë viteve të pas-shpalljes së pavarësisë, kryesisht për shkak të rimëkëmbjes së ekonomisë dhe një sërë rishikimesh të politikave të marra nga qeveria. Disa nga instrumentet e përdorura nga bankat tregtare në fillimin e veprimtarisë së tyre për akumulimin e kursimeve të brendshme në Kosovë kanë përfshirë zgjerimin e rrjetit të bankave, dhe iniciativa tradicionale që të rrisin akumulimin e depozitave.

Sipas Raportit Vjetor 2017 të BQK, në vitin 2017 vlera totale e aseteve të sistemit financiar të Kosovës arriti në rreth 5.91 miliardë euro, nga të cilat rreth 3.87 miliardë euro më 31 dhjetor 2017 (2016: 3.64 miliardë euro) janë asete të sektorit bankar duke shënuar rritje vjetore prej rreth 6.4% dhe është disi më e ulët se rritja e vitit të mëparshëm prej 7.4 përqind.

Depozitat një nga faktorët kryesorë që ndikojnë drejtpërsëdrejti në ekonominë e çdo vendi sidomos të vendeve në zhvillim përfshirë këtu edhe atë të Kosovës vërehet se kanë një


ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRIJTJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRIJTJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

trend rritës duke arritur maksimumin e tyre në vitin 2017. Pikërisht shtimi i tyre nga viti në vit e bën më të ndjeshëm ndikimin e tyre në ekonominë e Kosovës, ku peshën më të madhe pavarësisht se me trend rënës e kanë bankat me kapital nga vendet e Bashkimit Evropian (Raiffesen Bank Kosovo, Procredit Bank, NLB-Prishtina).

Totali i depozitave në sektorin bankar arriti në rreth 3.09 miliardë euro, një rritje vjetore prej 6.7 përqind, e cila është disi më e vogël kur krahasohet me normën e rritjes prej 7.2 përqind në vitin 2015. Në vitin 2017, depozitat nga individët privatë mbetën pothuajse në të njëjtin nivel (një rritje prej vetëm 2.1 përqind në krahasim me atë prej 8 përqind në vitin 2016), kurse depozitat nga bizneset u rritën me 13.8 përqind dhe përbëjnë tre të katërtat e depozitave në rritje. Numri i përgjithshëm i llogarive bankare të klientëve ka një rritje me 4.95% krahasuar me 2016 dhe arrijnë në rreth 1.97 milion të zotëruara në masën prej 98.45% nga rezidentët. Vlera gjithsej e kredive të dhëna nga bankat tregtare arriti në rreth 2.49 miliard euro. Sipas revistës për vlerësimin Tremujor të ekonomisë, 2017, raportohet se përqindja e alokimit të kredive dhe paradhënieve deri më 31 dhjetor 2017 ishte 64 përqind për korporatat jo-financiare dhe 36 përqind për individët. Përqendrimi në sektorë ekonomik i kredive dhe paradhënieve të reja për biznese vazhdoi të dominohet nga sektori tregtar me një pjesëmarrje të përgjithshme prej 50.1 përqind, pasuar nga prodhimi me 12.3 përqind dhe ndërtimi me 8.3 përqind.

Në vijim ecuria e rritjes së akumulimit të kursimeve dhe kreditimit nga bankat tregtare në Kosovë.

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RITJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RITJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE



Grafik 1. Ecuria e depozitave dhe kredive në Kosovë

Burimi: Të dhënat e publikuara nga bankat dhe BQK të përpunuara nga autori


Një pjesë tjetër e kursimeve të akumuluar nga bankat tregtare në Kosovë investohet prej tyre në blerjen e letrave me vlerë të qeverisë së Kosovës. Investimet e sektorit bankar në bono qeveritare dhe bono të thesarit shënuan ulje të lehtë në 486.7 milionë euro në vitin 2017 (2016: 510.3 milionë euro), një ulje kjo prej 5 përqind. Vlera e portofolit të bonove u kthye pak a shumë në vlerën e fundvitit 2015.

Vlera gjithësej e kredive në Kosovë është e financuar nga depozitat e klientëve të bankave tregtare në Kosovë. Raporti i kredive ndaj depozitave luhet rreth 80% më 31 dhjetor 2017 duke shënuar ngritje nga 77 përqind sa ishte më 31 dhjetor 2016. Ky është një tregues i rëndësishëm për rolin dhe rëndësinë që ka akumulimi i kursimeve në Kosovë, pasi një mbështetje në financimin nga depozitat lokale, sidomos nga individët privatë e bën këtë mënyrën më të besueshme të financimit krahasuar me opsionet tjera dhe gjithashtu është imune ndaj luhatjeve ndërkombëtare në tregjet financiare.

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRIJTJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRIJTJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

Gjithashtu, nga raportimet e bankave tregtare në Kosovë këto vitet e fundit ka pasë kufizim të rrjetit bankar nga disa banka gjë e cila ka ndikuar në një tkurrje të peshës së depozitave dhe kredive që zotërojnë këto banka në tregun bankar të Kosovës, pavarësisht se për vitin 2017, rezulton se rreth 357,300 llogari kanë aplikuar online banking duke mundësuar shërbimet bankare për të kryer pagesa apo për të kontrolluar gjendjen e llogarisë përmes internetit. Këto të fundit kanë pasë një rritje të konsiderueshme falë investimeve në teknologji dhe konsiderohet inkurajuese trendi i shpejt i rritjes së përdorimit të instrumenteve elektronike të pagesave.

Referuar rritjes së akumulimit të depozitave që prej krijimit të shtetit të Kosovës edhe përmes përthithjes së remitancave kemi një tregues në rritje të investimeve të bankave në ekonomine e Kosovës, e reflektuar kjo rritje edhe në grafikët në vijim:




Grafik 2. GDP per capita në/€

Burimi: Të dhënat e publikuara nga bankat dhe BQK të përpunuara nga autori

Ndërsa lidhur me normën nominale të GDP ajo ka patur gjithashtu tendencë rritje duke filluar që prej vitit 2008 deri në 2017 krahasuar me Normën reale të rritjes së saj (të shprehur në %) e cila në periudha të caktuara ka patur luhatje ku vlerën minimale e ka patur

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRIJTJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRIJTJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

në 2014 me 1.2% dhe atë maksimale në vitin 2008 me 5.4%. ndërsa gjatë tre viteve të fundit ajo ka qënë thujase kostante duke u luhatur nga 3.5% në 3.7%.



Grafik 3. Norma nominale e GDP dhe norma reale e rritjes së saj
Burimi: Të dhënat e publikuara nga bankat dhe BQK të përpunuara nga autori

Bankat tregtare luajnë një rol jetësor në zhvillimin ekonomik të Kosovës. Ato grumbullojnë kursimet e lira të njerëzve dhe i bëjnë ato të disponueshme për investime. Ato gjithashtu krijojnë depozita të reja shumë të nevojshme në procesin e dhënies së kredive dhe blerjen e letrave me vlerë të qeverisë dhe korporatave në një të ardhme të afërt. Ato lehtësojnë tregtinë brenda dhe jashtë vendit duke pranuar dhe shlyer shkëmbimin e faturave. Bankat gjithashtu rrisin lëvizjen e lirë të kapitalit financiar. Sistemi i organizuar bankar gjithashtu është nevoja e ditës për çdo vend dhe për më tepër i vendeve në zhvillim. Bankat tregtare janë mënyra më efektive për të gjeneruar rritjen e kredisë në tregun e Kosovës, ku kemi edhe mungesë të tregut të kapitalit (Bursës). Bankat mund të luajnë një rol të rëndësishëm në nxitjen e formimit të kapitalit, në kontrollimin e spekulimeve në ruajtjen e balancës

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRITJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRITJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

midis kërkesave dhe disponueshmërive dhe në burimet e drejtpërdrejta fizike në kanalet e dëshiruara.

Bankat tregtare kryejnë shumë funksione. Ata plotësojnë nevojat financiare të sektorëve si bujqësia, industria, tregtia, komunikimi, kështu që ato luajnë rol shumë të rëndësishëm në procesin e plotësimit të nevojave sociale-ekonomike. Bankat tregtare pranojnë lloje të ndryshme të depozitave nga publiku, duke përfshirë ruajtjen e depozitave në llogari kursimi, llogari rrjedhëse, dhe depozita me afat. Këto depozita paguhen pas një periudhe të caktuar kohore. Bankat tregtare ofrojnë kredi dhe paradhënie të formave të ndryshme. Ato gjithashtu japin kredi me afat për të gjitha llojet e klientëve kundrejt sigurisë së duhur. Krijimi i kredisë është funksioni më i rëndësishëm i bankave tregtare.

Në Kosovë, burimi kryesor i financimit për të mbështetur ecurinë ekonomike kombëtare është tregu i bankave tregtare. Megjithatë, edhe institutet financiare jobankare si institucionet financiare të zhvillimit, shoqëritë e sigurimeve dhe pensione, dhe operatorët e tjerë financiar, gjithashtu marrin pjesë në përmbushjen e nevojave financiare të ekonomisë. Kështu që faktorët që ndikojnë në ecurinë e rritjes ekonomike dhe bankare janë depozitat të cilat transformohen në kredi dhe investime duke siguruar interesa për depozituesit, fitime për investuesit, fitime për bankat dhe rritje të buxhetit për qeverinë që do të thotë më shumë shërbime sociale për të gjithë kosovarët. Bankat tregtare të Kosovës dhe institucionet respektive shtetërore shprehin në intervistat e kryera se e kuptojnë qartë marrëdhënien pozitive që ekziston mes rritjes së veprimtarisë së ndërmjetësimit financiar dhe rritjes ekonomike të Kosovës.

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RITJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RITJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

Bankat tregtare luajnë një rol shumë të rëndësishëm për ekonominë e Kosovës dhe studimet demonstrojnë një marrëdhënie pozitive për rritjen ekonomike të Kosovës. Gjatë dekadës së fundit, interesi i konsiderueshëm u fokusua në lidhjen ndërmjet sektorit financiar dhe rritjes ekonomike. Teoria e rritjes endogjene u shfaq në fund të viteve 1980 dhe hapën rrugën për teoritë e reja që eksplorojnë lidhjen. Përveç kësaj, metoda të përmirësuara empirike i shtuan vlera të konsiderueshme studimeve pasuese. Ky studim në vijim hulumton me modele empirike kontributet e bankave tregtare në akumulimin e depozitave me qëllim investimin e tyre në rritjen ekonomike të Kosovës.

4.2 Analiza Empirike

Lidhur me metodat e përdorura për analizën e këtij studimi ato i referohen kryesisht metodave që i përshtaten serive kohore dhe kryesisht testit Dickey – Fuller (DF) , Augmentied Dickey – Fuller (ADF) dhe testit Ganger Causality. Fillimisht seria kohore duhet testuar lidhur me stacionaritetin nëpërmjet testit ADF. Nëse seritë janë jo-stacionare atëherë ato duhet të përfshihen në model në formën e tyre stacionare dhe më pas të analizohet modeli i regresionit linear.

Trajta e ekuacionit ka formëm:

$$Y_t = \mu + p \cdot Y_{t-1} + \varepsilon_t$$

Dhe hipotezat për stacionaritetin janë:

$$H_0: p=0$$

$$H_1: p<1$$

Shohim fillimisht stacionaritetin nëpërmjet grafikut i cili i referohet vlerave të normës së GDP-së për periudhën 2010-2017. Dihet se nëse seria ka tendencë/trend rritës ose zbritës

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRIJTJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRIJTJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

në kohë, atëherë mund të themi se kushti i stacionaritetit mund të jetë çenuar. Pra, e thënë ndryshe ajo mund të jetë një seri e rrënjës njësi (Unit Root). Edhe grafiku ynë tregon se GDP (norma nominale) kanë trend rritës duke filluar nga 2010 deri në 2017. Pra seria e vlerave të GDP-së është seri e rrënjës njësi.



Grafiku 4. GDP 2010-2017

Burimi: Të dhënat e publikuara nga bankat dhe BQK të përpunuara nga autori

4.2.1 Aplikimi i testit Ganger Causality

Para ndërtimit të modelit i referohemi edhe analizës së testit Ganger Causality.

Nëpërmjet testit Ganger Causality analizohet roli i variablave në model, pra për të hequr dyshimet se cili nga variablat është shkaku dhe cili është pasoja.

Testi Ganger Causality jep përgjigje se ndryshimi i një faktori X në një periudhë kohe të mëparshme (t-k) sjell pasojë apo ndikon tek variabli Y në kohën t.

Prandaj hipotezat janë:

H_0 : X nuk shkakton (Granger cause) me Y në regresin e parë

H_a : Y nuk shkakton (Granger cause) me X në regresin e dytë

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRITJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRITJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

Kështu të dhënat e tabelës më poshtë tregojnë se asnjë nga variablat nuk shkakton Granger cause midis tyre. Kjo na lejon të ndërtojmë ekuacionin linear ku GDP është variabli i varur ndërsa, depozitat, remitancat dhe kreditë janë variablat e pavarur.

Marrim vlerat përkatëse në tabelën më poshtë:

Tabela 1. Testi Granger Causality

Pairwise Granger Causality Tests
Date: 08/17/18 Time: 09:48
Sample: 2010 2017
Lags: 2

Null Hypothesis:	Obs	F-Statistic	Prob.
DEPOZITAT does not Granger Cause GDP	6	952.073	0.0229
GDP does not Granger Cause DEPOZITAT		58.3679	0.0922
KREDITE does not Granger Cause GDP	6	41.9991	0.1085
GDP does not Granger Cause KREDITE		2.47142	0.4102
REMITANCAT does not Granger Cause GDP	6	0.71625	0.6412
GDP does not Granger Cause REMITANCAT		1.65366	0.4818
KREDITE does not Granger Cause DEPOZITAT	6	6.64755	0.2645
DEPOZITAT does not Granger Cause KREDITE		5.40781	0.2909
REMITANCAT does not Granger Cause DEPOZITAT	6	1.65669	0.4815
DEPOZITAT does not Granger Cause REMITANCAT		2.83038	0.3875
REMITANCAT does not Granger Cause KREDITE	6	5.05721	0.3000
KREDITE does not Granger Cause REMITANCAT		3.98526	0.3339

Shikojmë që duke kaluar me sukses këtë test ne mund të testojmë testin tjetër .

4.2.2 Aplikimi i testit Augmentit Dickey – Fuller (ADF)

Analizojmë më tej serinë tonë duke ju referuar testit Augmented Dickey- Fuller (ADF) si në tabelën 2.

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRRITJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRRITJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

Tabela 2. Testi Augmented Dickey- Fuller për GDP

Null Hypothesis: GDP has a unit root Exogenous: Constant Lag Length: 1 (Automatic - based on SIC, maxlag=1)				
			t-Statistic	Prob.*
Augmented Dickey-Fuller test statistic			1.509007	0.9947
Test critical values:	1% level		-5.119808	
	5% level		-3.519595	
	10% level		-2.898418	
*MacKinnon (1996) one-sided p-values. Warning: Probabilities and critical values calculated for 20 observations and may not be accurate for a sample size of 6				
Augmented Dickey-Fuller Test Equation Dependent Variable: D(GDP) Method: Least Squares Date: 07/24/18 Time: 19:04 Sample (adjusted): 2012 2017 Included observations: 6 after adjustments				
Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
GDP(-1)	0.190513	0.126251	1.509007	0.2284
D(GDP(-1))	0.951048	0.522726	1.819401	0.1664
C	-1.034414	0.819969	-1.261529	0.2963
R-squared	0.534089	Mean dependent var		0.266667
Adjusted R-squared	0.223482	S.D. dependent var		0.061210
S.E. of regression	0.053938	Akaike info criterion		-2.695095
Sum squared resid	0.008728	Schwarz criterion		-2.799215
Log likelihood	11.08528	Hannan-Quinn criter.		-3.111897
F-statistic	1.719502	Durbin-Watson stat		1.898931
Prob(F-statistic)	0.318020			

Sipas të dhënave të saj vlera e t-Statistics në testin ADF është

t- statistics = 1.509 > -5.119 (1% level)

-3.519 (5% level)

-2.898 (10% level)

Pra, mund të themi se kemi të bëjmë me një seri jo-stacionare ku vlera e probabilitetit është 0.9947.

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRITJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRITJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

Shohim fillimisht lidhur me diferencën e parë. Kështu referuar të dhënave në Eviews lidhur me diferencën e parë kemi se

$$\begin{aligned} t\text{-statistics} &= -3.09 > -5.11 \text{ (1\% level),} \\ &> -3.51 \text{ (5\% level) dhe} \\ &< -2.89 \text{ (10\% level).} \end{aligned}$$

Probabiliteti F (statistics) =0.03 gjë e cila na lejon të themi se seria jonë është stacionare në diferencat e saj të para dhe konsiderohet një seri e integruar në diferencat e para.

Vlera e $R^2=0.70$ një vlerë kjo relativisht e lartë. Ndërkohë që vlera e f- statistiks =9.58 (Tabela 2), pra mund të themi se hipoteza H_0 bie poshtë dhe si rrjedhim mund të përfshihet në modele lineare.

Për të përforcuar këtë i referohemi tabelës nr 3, si më poshtë me të dhënat referuese për vlerën e koeficientit R^2 si dhe vlerës së f- statistiks si vijon :

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRRITJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRRITJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

Tabela 3. ADF test për diferencën e parë

Null Hypothesis: D(GDP) has a unit root
Exogenous: Constant
Lag Length: 0 (Automatic - based on SIC, maxlag=1)

	t-Statistic	Prob.*
Augmented Dickey-Fuller test statistic	-3.096283	0.0797
Test critical values: 1% level	-5.119808	
5% level	-3.519595	
10% level	-2.898418	

*MacKinnon (1996) one-sided p-values.

Warning: Probabilities and critical values calculated for 20 observations and may not be accurate for a sample size of 6

Augmented Dickey-Fuller Test Equation
Dependent Variable: D(GDP,2)
Method: Least Squares
Date: 07/24/18 Time: 19:40
Sample (adjusted): 2012 2017
Included observations: 6 after adjustments

Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
D(GDP(-1))	-0.767405	0.247847	-3.096283	0.0364
C	0.198826	0.076586	2.596130	0.0603
R-squared	0.705600	Mean dependent var		-0.025000
Adjusted R-squared	0.632000	S.D. dependent var		0.102127
S.E. of regression	0.061954	Akaike info criterion		-2.463664
Sum squared resid	0.015353	Schwarz criterion		-2.533077
Log likelihood	9.390991	Hannan-Quinn criter.		-2.741531
F-statistic	9.586968	Durbin-Watson stat		1.268122
Prob(F-statistic)	0.036352			

Kjo na lejon të ndërtojmë ekuacionin linear ku GDP është variabli i varur ndërsa, depozitat, remitancat dhe kreditë janë variablat e pavarur. Këtë e provuam në testin e Ganger Causality të aplikuar në hapat më parë .

Referuar të dhënave tona dhe atë që duam të provojmë si dhe pas aplikimeve të testeve të mëparshme arritëm në ndërtimin e ekuacioneve në vijim.

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RITJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RITJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

4.2.3 Aplikimi i ekuacioneve regressive lineare

- Ekuacioni me faktor vetëm depozitat

Fillimisht i referohemi modelit të ekuacionit të thjeshtë linear duke marrë si variabël të pavarur vetëm depozitat.

Kështu referuar të dhënave të Eviews ekuacioni do të ketë trajtën si më poshtë:

$$GDP = 1.842422 + 0.001444 \text{ (depozitat)}$$

Referuar faktit që prob (F- statistic) =0.000 dhe vlera e F-statistics është gjithashtu relativisht e lartë F- Statistics= 330.8186 shihet gjithashtu se në këtë rast modeli parashikon në masën 98.2% ndryshimin e vlerës së GDP-së si pasojë e ndryshimit të faktorit- depozitë këtë reflektuar në (Tabela 4).

Pra e thënë ndryshe, nëse faktori – depozitë rritet me 1 njësi, vlera e GDP-së (normës nominale) do të rritet me 0.001444 herë.

Koeficienti para faktorit depozitë edhe pse ka vlerë të vogël është pozitiv ashtu sikurse edhe pritej. Pra, që do të thotë se depozitat janë faktor i rëndësishëm në rritjen e GDP-së, duke i dhënë përgjigje objektivit të parë të studimit.

- Të tregojë marrëdhënien që ekziston mes akumulimit të depozitave/kursimeve në Kosovë dhe rritjes ekonomike të Kosovës.

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRIJTJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRIJTJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

Tabela 4. Ndërtimi i modelit me faktor depozitat.

Dependent Variable: GDP
Method: Least Squares
Date: 08/17/18 Time: 09:50
Sample: 2010 2017
Included observations: 8

Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
DEPOZITAT	0.001444	7.94E-05	18.18842	0.0000
C	1.842422	0.195590	9.419830	0.0001
R-squared	0.982186	Mean dependent var	5.342500	
Adjusted R-squared	0.979217	S.D. dependent var	0.686497	
S.E. of regression	0.098967	Akaike info criterion	-1.575745	
Sum squared resid	0.058767	Schwarz criterion	-1.555885	
Log likelihood	8.302981	Hannan-Quinn criter.	-1.709695	
F-statistic	330.8186	Durbin-Watson stat	1.996863	
Prob(F-statistic)	0.000002			

- Ekuacioni me faktor depozitat dhe kreditë.

Nëse faktorit depozita i shtojmë edhe faktorin kredi, për të analizuar më tej efektin e këtyre faktoreve i referohemi serish ndërtimit të ekuacionit.

Kështu të dhënat e tabelës së mëposhtme tregojnë se ekuacioni me factor depozitat dhe kreditë dhe variabla të varur GDP ka trajtën si më poshtë:

$$GDP = 1.771828 + 0.001121 (\text{depozitat}) + 0.000459 (\text{kreditë})$$

Ekuacioni është i vlefshëm nga ana statistikore pasi vlera e Prob (F-Statistic) =0.0000 dhe vlera e F-Statistic= 158.2999.

Ekuacioni tregon se ndikimi i depozitave është më i lartë krahasuar me kreditë pasi koeficienti β i depozitave është më i lartë pavarësisht se të dy koeficientët janë pozitiv duke treguar se rritja e secilit factor ndikon në rritjen e nivelit të GDP-së.

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRRITJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRRITJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

Duke ju referuar probabilitetit të të dy faktorëve probabiliteti i faktorit depozit është më i vogël 0.0339 duke e konfirmuar edhe njëherë rëndësinë e faktorit depozitë krahsuar me faktorët e tjerë.

Këtë e shohim te tabela 5 si më poshtë:

Tabela 5. Modeli me factor depozitat dhe kreditë.

Dependent Variable: GDP
Method: Least Squares
Date: 08/17/18 Time: 10:52
Sample: 2010 2017
Included observations: 8

Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
DEPOZITAT	0.001121	0.000387	2.896729	0.0339
KREDITE	0.000459	0.000538	0.853755	0.4322
C	1.771827	0.216571	8.181280	0.0004
R-squared	0.984453	Mean dependent var	5.342500	
Adjusted R-squared	0.978234	S.D. dependent var	0.686497	
S.E. of regression	0.101281	Akaike info criterion	-1.461830	
Sum squared resid	0.051290	Schwarz criterion	-1.432040	
Log likelihood	8.847321	Hannan-Quinn criter.	-1.662756	
F-statistic	158.2999	Durbin-Watson stat	1.675376	
Prob(F-statistic)	0.000030			

- Ekuacioni me faktor depozitat dhe remitancat

Nëse këtij modeli përvec faktorit depozitë i shtojmë edhe faktorin remitancat trajta e tij do jetë si më poshtë:

$$GDP = 1.806295 + 0.001426(\text{depozitat}) + 0.000143 (\text{remitancat})$$

Madje ky model ka një vlerë të lartë të përcaktueshmërisë $R^2 = 98.4\%$ ku ndër të dy faktorët e këtij modeli, faktori depozitë është më i rëndësishëm pasi edhe probabiliteti është më i vogël Prob=0.000.

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRITJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRITJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

Tabela 6. Modeli me faktor depozitat dhe remitancat

Dependent Variable: GDP
Method: Least Squares
Date: 08/17/18 Time: 09:55
Sample: 2010 2017
Included observations: 8

Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
DEPOZITAT	0.001426	8.60E-05	16.57972	0.0000
REMITANCAT	0.000143	0.000194	0.739663	0.4927
C	1.806295	0.209199	8.634341	0.0003
R-squared	0.983943	Mean dependent var	5.342500	
Adjusted R-squared	0.977520	S.D. dependent var	0.686497	
S.E. of regression	0.102928	Akaike info criterion	-1.429583	
Sum squared resid	0.052971	Schwarz criterion	-1.399792	
Log likelihood	8.718331	Hannan-Quinn criter.	-1.630508	
F-statistic	153.1972	Durbin-Watson stat	1.399778	
Prob(F-statistic)	0.000033			

- Ekuacioni me faktor depozitat, remitancat dhe kreditë

Ndërkohë nëse përveç këtyre dy faktorëve (variblave) do shtojmë edhe faktorin kredi gjithashtu forma e re e modelit do ketë trajtën:

$$GDP = 1.769447 + 0.001193(\text{depozitat}) + 8.10 (\text{remitancat}) + 0.000342 (\text{kreditë})$$

Ajo që vihet re është se, R^2 është sërish i lartë 98.5% dhe në këtë model kur janë përfshirë të gjithë faktorët së bashku.

Madje remitancat kanë koeficient të lartë dhe kjo ka kuptim pasi rritja e depozitave si rrjedhim e sasisë më të madhe të likuiditetit në duart e qytetarëve si pasojë e remitancave sjell efekte pozitive në ekonomi.

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRRITJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRRITJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

Statistikisht ky përfundim vlen pasi vlera e Prob (F-statistics)=0.0004 ndërsa F- statistics =86.77472 (Tab. 7).

Tabela 7. Modeli duke përfshirë depozitat, remitancat, faktorin kohë dhe faktorin kredi.

Dependent Variable: GDP
Method: Least Squares
Date: 08/17/18 Time: 09:58
Sample: 2010 2017
Included observations: 8

Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
DEPOZITAT	0.001193	0.000480	2.487145	0.0677
REMITANCAT	8.10E-05	0.000245	0.330938	0.7573
KREDITE	0.000342	0.000691	0.494168	0.6471
C	1.769447	0.238993	7.403744	0.0018
R-squared	0.984867	Mean dependent var	5.342500	
Adjusted R-squared	0.973517	S.D. dependent var	0.686497	
S.E. of regression	0.111717	Akaike info criterion	-1.238842	
Sum squared resid	0.049923	Schwarz criterion	-1.199121	
Log likelihood	8.955369	Hannan-Quinn criter.	-1.506743	
F-statistic	86.77472	Durbin-Watson stat	1.412433	
Prob(F-statistic)	0.000427			

- Ekuacioni me faktor vetëm remitancat

Refereruar ekuacionit të mësipërm ku remitancat kanë një koeficient domethënës ndërtojmë një tjetër ekuacion midis GDP dhe remitancave për të parë lidhjen e drejtpërdrejtë të tyre.

Kështu referuar të dhënave të tabelës 7 kemi këtë ekuacion si më poshtë:

$$GDP = 41.764384 + 0.01043 (\text{remitancat})$$

Koeficienti i përcaktueshmërisë $R^2=10.1\%$ pra i vogël krahasuar me koeficientët e tjerë gjë e cila na tregon se vetëm remitancat nuk mund të jenë faktor përcaktues në rritjen e GDP ato janë kryesisht faktor mbështetës por jo determinant.

Për këtë arsye remitancat të para në ndërveprim edhe me faktorët e tjerë si depozitat apo kreditë kanë efekt të ndjeshëm.

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRIJTJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRIJTJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

Këtë fakt e konfirmojnë gjithashtu edhe vlera e Prob (F-Statistic)=0.442 dhe vlera e ulët e F-Statistic =0.675427 gjithashtu.

Tabela 8. Modeli duke përfshirë vetëm remitancat

Dependent Variable: GDP
Method: Least Squares
Date: 08/17/18 Time: 10:04
Sample: 2010 2017
Included observations: 8

Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
REMITANCAT	0.001043	0.001269	0.821843	0.4426
C	4.764384	0.746056	6.386096	0.0007
R-squared	0.101181	Mean dependent var	5.342500	
Adjusted R-squared	-0.048622	S.D. dependent var	0.686497	
S.E. of regression	0.702989	Akaike info criterion	2.345366	
Sum squared resid	2.965159	Schwarz criterion	2.365226	
Log likelihood	-7.381464	Hannan-Quinn criter.	2.211416	
F-statistic	0.675427	Durbin-Watson stat	0.427663	
Prob(F-statistic)	0.442591			

- Përfundime:

1. Vërtetohet hipoteza H_0 e ngritur për këtë studim se rritja e akumulimit të kursimeve të kosovarëve nga bankat tregtare kanë efekt pozitiv në rritjen e qëndrueshme ekonomike të Kosovës.
2. Rezultatet e regresionit tregojnë se depozitat, kanë një ndikim të rëndësishëm pozitiv në rritjen ekonomike të Kosovës.
3. Testi Granger-Causality konfirmon marrëdhënien shkakësore të depozitave, përparimeve dhe përfitimit me rritjen ekonomike. Në anën tjetër tregon marrëdhënien unidirektale të

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RITJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RITJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

investimeve dhe fitimet e interesit me rritjen ekonomike të investimeve dhe të ardhurave nga interesi drejt rritjes ekonomike.

Ai rekomandon që politikëbërësit duhet të bëjnë politika për të përmirësuar sektorin bankar në Kosovë, për shkak se sektori bankar është duke kontribuar ndjeshëm në rritjen ekonomike të Kosovës.

4. Remitancat si dhe kreditë gjithashtu janë faktor që vënë në lëvizje ekonominë e Kosovës nëpërmjet ndikimit të tyre të drejtpërdrejtë në investime.

4.3. Analiza e të dhënave sasiore

4.3.1. Analizë e tregut për akumulimin e kursimeve të brendshme dhe kreditimin e ekonomisë së Kosovës


Financimi i zhvillimit të qëndrueshëm do të duhet të mbështetet në sistemet financiare vendase dhe në fund të fundit për investitorët vendas, për të mobilizuar kursimet dhe për t'i kanalizuar ato në investime produktive. Sektori bankar është burimi kryesor në financimin e ekonomisë duke ofruar hua për individët, firmat dhe qeverinë.

Duke ditur rolin që kanë institucionet financiare në ekonominë e një vendi forcimi dhe rritja e tyre përbën një hap pozitiv në këtë drejtim.

Të dhënat e grafikut më poshtë tregojnë se vlera e depozitave janë rritur vit pas viti krahasuar me vitet e mëparshme. Dhe grafikun në vijim do të shikojmë se ka pasë dhe vite kur pavarësisht se pritej rritje e kursimeve në depozita kemi pasë ulje të tyre. Rënia më e madhe ka qenë në vitin 2002 ku kemi rënie me rreth 87 milion euro krahasuar me vitin

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRIJTJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRIJTJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

2001, ndërsa në vitin 2010 kemi rënie me të ulët me rreth 10 milion euro krahasuar me vitin 2009.



Grafik 5. Ecuria depozita dhe kredi 2000-2017.

Burimi: Të dhënat e publikuara nga bankat dhe BQK të përpunuara nga autori

Të tilla rënie të cituara më sipër reflektojnë edhe lidhjen me situatat politike në vend dhe rëndësinë që ka shteti për efektin që jep në stabilitet, rritje të kursimeve dhe investimeve të cilat duken në pjesën e grafikut i cili paraqet kreditimin me një tendencë rritëse vit pas viti pavarësisht se me një rritje jo të konsiderueshme e cila është e lidhur fort me trendin e akumulimit të kursimeve në Kosovë. Pavarësisht luhatjeve në rritjen e veprimtarisë së bankave, industria bankare është ndër sektorët me performancë më të mirë të ekonomisë së Kosovës dhe ka kontribuar shumë në drejtim të financimit të investimeve, pavarësisht ritmit të rritjes së depozitave në industri në këto 4 vitet e fundit e cila ka qenë në nivelin më të ulët krahasuar me rritjen e para vitit 2014.

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRITJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRITJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

Rritja e depozitave ka vijuar të jetë positive në vitet e tjera, pavarësisht se shqetësues është edhe ritmi i rritjes i cili ka devijanca të konsiderueshme nga viti në vit dhe kjo tregohet me grafikun në vijim.



Grafik 6. Rritja në % krahasuar me vitin paraardhës për Depozitat nga 2007-2017

Burimi: Të dhënat e publikuara nga bankat dhe BQK të përpunuara nga autori

Nga përpunimi i të dhënave dhe prezantimi në grafikun më sipër evidentojmë se ritmi i rritjes së depozitave për një vend në zhvillim ka qenë ai deri në vitin 2009, pavarësisht se rritje dyshifrore është shfaqur edhe në vitin 2013, por kjo ka qenë një kulm rastësor i cili duket qartë se nuk vjen si pasojë e strategjive të qarta nga bankat tregtare dhe shteti për rritjen e akumulimit të kursimeve të kosovarëve. Periudha tjetër ka një rritje të pafuqishme dhe vijuar me rënie dhe ngritje respektivisht 6.51% në 2015, 7.21% në 2016 dhe 6.79% në 2017. Këto ritme nuk sjellin rritjen e kërkuar ekonomike të Kosovës. Pra, ajo çfarë evidentohet gjithashtu nga ky grafik është se pavarësisht rritjes në total të shumës së depozitave/ kursimeve në bankat tregtare në Kosovë, kemi një tendencë rënëse në ritmin e

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRIJTJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRIJTJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

rritjes krahasuar me vitin paraardhës në harkun kohor të 10 vjetëve të fundit, gjë e cila reflektohet edhe në volumin e investimeve të bankave për ekonominë e shtetit të Kosovës.

Kërkimi i burimeve të reja potenciale të depozitave nëpërmjet vlerësimit të potencialit të depozitave të nivelit të ekonomisë familjare dhe ndjekjes së zonave strategjike të qeverisë për të pasur akses ndaj klientëve të rinj, janë të rëndësishme për të rritur normën e rritjes së depozitave. Në vijim bazuar në përpunimin e të dhënave zbulojmë rritjen vjetore të depozitave për çdo bankë duke krahasuar volumin actual me atë të vitit parardhës.

Tabela 9. Rritja vjetore e depozitave për çdo bankë tregtare në %


Bank/Annual	2017	2016	2015	2014	2013	2012	2011
Banka 1	-0.36	0.60	-0.94	3.79	3.36	1.48	4.31
Banka 2	1.53	7.46	11.82	8.59	7.18	-4.73	4.20
Banka 3	27.35	20.55	12.43	2.18	-2.33	20.56	14.56
Banka 4	6.00	21.00	5.76	-4.34	22.09	11.09	35.35
Banka 5	5.82	14.41	18.10	8.65	54.25	109.83	38.38
Banka 6	15.02	10.48	-0.75	-0.25	19.35	14.30	13.53
Banka 7	14.20	-2.43	9.62	-3.58	55.20	13.93	47.27
Banka 8	7.88	2.90	6.76	13.90	18.66	10.80	20.81
Banka 9	39.35	55.84	77.48				
Banka 10	133.33	65.00					
Total Market	7.26	7.27	6.57	3.65	16.27	7.80	11.85

Burimi: Të dhënat e publikuara nga bankat dhe BQK si edhe përpunim nga autori

Nga kjo tabelë zbulohet se banka të ndryshme kanë pasë performaca të ndryshme përgjatë këtyre viteve, përsëri kjo normë rritje për gjithë tregun paraqet një ecuri të paqëndrueshme duke pasë një pikë kulmore për rritje me 16.27% në vitin 2013 por duke zbritur në 3.65% në vitin 2014. Në vitet në vijim rritja ka qenë më e stabilizuar në rreth 7%, ndërsa ritmi i rritjes për banka të veçanta ka vijuar të jetë me luhatje të vazhdueshme. Kjo evidentohet

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RITJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RITJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

edhe në grafikun që paraqet ecurinë e rritjes/rënies për çdo vit për secilën nga 10 bankat tregtare që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në Kosovë nga viti 2010 deri në vitin 2017.



Grafik 7. Pesha e depozitave (%) e çdo banke ndaj totalit


Burimi: Të dhënat e publikuara nga bankat dhe BQK të përpunuara nga autori

Përsa i përket normës vjetore të rritjes, siç prezantohet në grafikun dhe tabelën më sipër të 10 bankave tregtare të Kosovës, depozita totale kanë vijuar rritjen deri në vitin 2017. Depozitat e disa bankave kanë shënuar rritje më të lartë se rritja e tregut në vitin 2017, kryesisht për shkak të zgjerimit të rrjeteve bankare dhe instrumenteve të bazuara në teknologji. Luhatjet në rritjen e depozitave mund të nxiten nga disa faktorë. Rezultati i përgjithshëm i tabelës nënkupton që, në industrinë bankare kosovare, edhe nëse ka një sasi të lartë depozite vjetore e cila tregohet në tabelë, *norma e rritjes së depozitave është e paqëndrueshme. Koncretisht norma e rritjes vjetore të depozitave të bankave më të mëdha siç paraqitet në grafikët e mësipërm ka natyrë të paqëndrueshme. Paqëndrueshmëria në*

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRIJTJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRIJTJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

rritjen e depozitave rrit ekspozimin e rrezikut të përgjithshëm të bankave. Prandaj, nevoja për menaxhim të kujdesshëm të likuiditetit të të gjitha bankave në përgjithësi dhe bankave më të mëdha në veçanti është kritike.

Çdo bankë tregtare krahasuar me të dhënat e vitit 2010 apo datën e fillimit të veprimtarisë në Kosovë, tregon rritje të volumit të depozitave të akumuluar. Bazuar në këto të dhëna dhe nëse nuk do të ketë ndryshime të strategjive të bankave për 5 vjeçarin e ardhshëm do të kemi vijim të rritjes së akumulimit të kursimeve nga bankat tregtare në Kosovë, e paraqitur sipas grafikut në vijim.



Grafik 8. Parashikim i rritjes së akumulimit të kursimeve në Kosovë deri në 2022

Burimi: Të dhënat e publikuara nga bankat dhe BQK të përpunuara nga autori


Në kryerjen e ushtrimit për parashikimin e rritjes së depozitave në Kosovë evidentojmë se në vitin 2022 totali i depozitave do të jetë:

- * sipas skenarit pesimist do të jetë rreth 3.7 miliard euro,
- * sipas skenarit normal do të jetë rreth 3.92 miliard euro,
- * sipas skenarit optimist do të jetë rreth 4.13 miliard euro.

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRIJTJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRIJTJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

Nga ky parashikim evidentojmë edhe njëherë normën e ulët të rritjes së akumulimit të kursimeve në Kosovë, pasi prej disa vitesh bankat akumulimi i depozitave ka qenë në norma të ulëta, duke kujtuar si histori të largët trendin e viteve 2000 si edhe atë të vitit 2013. Një normë e ulët e akumulimit të depozitave orienton edhe një normë të ulët të rritjes së kredive për ekonominë e Kosovës.

Shumica e bankave më të mëdha në Kosovë e kanë ulur disbursimin e kredive. Ka disa arsye për këtë. Sipas intervistave të bëra me zyrtarët e lartë të bankave tregtare në Kosovë, rezerva e BQK është një nga faktorët që u vendos në aktivitetet e kreditimit të bankave tregtare që nga viti 2012. Ajo ngriti detyrimin rezervë për bankat tregtare në 20 dhe 25%. Përveç kësaj, kërkesa për likuiditet është rritur edhe nga bankat më të 3BMT si pasojë e kërkesave për raportimet e grupeve bankare që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në vendet e BE-së. Nëse do të vijohet me të njëjtin trend, parashikimi i kryer bazuar në të dhënat e deritanishme paraqitet me grafikun në vijim:



Grafik 9. Parashikim i rritjes së kreditimit në Kosovë deri në 2022

Burimi: Të dhënat e publikuara nga bankat dhe BQK të përpunuara nga autori

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRIJTJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRIJTJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

Në kryerjen e ushtrimit për parashikimin e rritjes së kreditimit në Kosovë evidentojmë se në vitin 2022 totali i kredive: do të jetë:

* Sipas skenarit pesimist do të jetë rreth 2.45 miliard euro,


* Sipas skenarit normal do të jetë rreth 3.25 miliard euro,

* Sipas skenarit optimist do të jetë rreth 4.5 miliard euro.

Marrëdhënia është e qartë mes të dy këtyre treguesve (depozita dhe kredi) duke u konsideruar shkak pasojë.

Pjesa e kredive dhe paradhënieve të bankave tregtare mund të tregojë kapacitetin e tyre për të përmbushur nevojat financiare të klientëve. Sistemi bankar siguron alokimin efikas të burimeve në një ekonomi nëpërmjet kreditimit të bizneseve dhe individëve që përdorin sisteme të ndryshme kredish. Pra në bazë të ritmit të akumulimit të depozitave do të jetë edhe ritmi i kreditimit të ekonomisë së Kosovës, e cila prezantohet edhe në grafikun në vijim që përmban trendin e ecurisë mes kredive të dhëna dhe depozitave të akumuluar.

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRIJTJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRIJTJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE




Grafik 10. Raporti Kredi ndaj Depozitave në Kosovë nga viti 2000 deri në 2017

Burimi: Të dhënat e publikuara nga bankat dhe BQK të përpunuara nga autori

Ky tregues është shumë i rëndësishëm dhe mbahet në vëmendje të drejtimit të lartë të bankave tregtare por edhe mbikëqyrësve të tyre. Kjo ecuri është si rezultat i ndikimit të madhësisë së depozitave në mesin e burimeve të tjera. Përpunimi dhe paraqitja e të dhënave tregon se akumulimi i kursimeve nga bankat ka efekt linear në kreditimin e ekonomisë dhe si pasojë rritjen PBB së Kosovës. Nëse kërkohet të ketë rritje më të lartë të PBB-së Kosovës duhet të vijojë rritja me ritme më të larta e akumulimi i depozitave nga bankat tregtare. Në rast se do të ruhet i njëjti trend për ecurinë e raportit kredi/depozita pa konsideruar efektin shtrëngues të kërkesavë të reja rregullatore sipas parimeve të BASEL për normën e likuiditetit por përkundrazi mbështetje me financim nga bankat mëmë (siç paraqitet aktualisht edhe në 2017 ky raport për Bankën 9 dhe Bankën 10, pavarisht peshës së vogël të tyre por edhe strategjisë afatgjatë që ato mund të aplikojnë për biznes në Kosovë) atëherë do të vijojnë rritjen e investimeve në ekonomi siç paraqitet në grafikun për parashikimin e ecurisë së këtij raporti në vijim;

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRIJTJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRIJTJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE



Grafik 11. Parashikim i ecursisë së Raportit Kredi ndaj Depozitave në Kosovë

Burimi: Të dhënat e publikuara nga bankat dhe BQK të përpunuara nga autori

Bazuar në grafikun më sipër ky raport mund të rritet përtej normës prej 80% për të kaluar edhe nivelin e 100% në një skenar optimist, por duke evidentuar që vetëm në vitin 2012 kemi pasë një Raport Kredi ndaj depozitave në rreth 83.8% dhe ky raport është ulur menjëherë në rreth 73% në vitin 2013 si pasojë e kërkesave të reja rregullatore për normën e likuiditetit, por edhe duke ndikuar në këtë ulje rritja e lartë e depozitave të akumuluar nga bankat në vitin 2013. Ky raport për Kosovën do të ruaj të njëjtën tendencë për të qëndruar në normën prej 73-78% pavarësisht se në grafikun më sipër tregohet për ruajtjen e trendit në rritje të këtij raporti pasi bankat tregtare në vendet në zhvillim nuk kreditojnë pa u bazuar në burimet financiare vendase dhe gjithmonë e më tepër kanë kërkesa rregullatore më shtrënguese.

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RITJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RITJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

4.3.2 Analizë sipas bankave të grupuara nga origjina e kapitalit

Në vitin 2014 bankat tregtare të Kosovës kanë akumulimin më të ulët të kursimeve në Kosovë që prej krijimit të shtetit të Kosovës. Në vijim në tërësi tregu ka rritje të akumulimit të kursimeve por në veçanti çdo bankë ka luhatje të trendit me rritje por edhe me rënie në disa raste.

Në varësi të objektivave të çdo banke por sidomos strategjive të përzgjedura dhe zbatimit të tyre, bankat kanë ndryshuar peshën që ato kanë pasë në totalin e depozitave të akumuluar përgjatë viteve 2010 deri në vitin 2017, sic prezantohen të përpunuara për çdo bankë sipas tabelës në vijim

Tabela 10. Peshë e depozitave që ka akumuluar çdo bankë ndaj totalit të depozitave të sistemit bankar përgjatë viteve 2010 deri në vitin 2017


Deposit Weight (%) cdo banke ndaj tot	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Banka 1	34.40	32.08	30.20	26.85	26.88	24.99	23.43	21.77
Banka 2	30.06	28.00	24.75	22.82	23.90	25.08	25.12	23.78
Banka 3	4.30	4.41	4.93	4.14	4.08	4.31	4.84	5.75
Banka 4	5.06	6.13	6.31	6.63	6.12	6.07	6.85	6.77
Banka 5	2.50	3.09	6.01	7.98	8.36	9.27	9.88	9.75
Banka 6	14.97	15.20	16.12	16.54	15.92	14.83	15.27	16.38
Banka 7	7.16	9.42	9.96	13.29	12.37	12.72	11.57	12.32
Banka 8	1.54	1.67	1.71	1.75	1.92	1.93	1.85	1.86
Banka 9	0.00	0.00	0.00	0.00	0.44	0.73	1.06	1.38
Banka 10	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.07	0.11	0.25
Total Market	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00

Burimi: Të dhënat e publikuara nga bankat dhe BQK si edhe përpunim nga autori

Nisur nga çfarë vërehet që në të dhënat e tabelës së mësipërme, si edhe analizës dhe informacioneve të marra nga intervistat por edhe burime të tjera sekondare, kërkimi vijon duke analizuar të dhënat për pozicionin dhe peshën e depozitave që kanë bankat të

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RITJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RITJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

grupuara sipas origjinës së kapitalit. Siç do të evidentohet nga të dhënat e grupuara në tabelën që do të vijë në vijim, është ndërtuar edhe grafiku përkatës për prezantim:



Grafik 12. Pesha e depozitave mbi totalin sipas origjinës së kapitalit të bankave tregtare në vite
Burimi: Të dhënat e publikuara nga bankat dhe BQK si edhe përpunim nga autori

Evidentojmë se bankat me kapital nga vendet e BE-së, në vitin 2010 zotëronin pothuajse 80% të depozitave të Kosovës, ndërkohë që në vitin 2017 ato kanë rënë me 18%. Situata paraqitet ndryshe për bankat me origjinë të kapitalit nga Turqia të cilat në vitin 2010 zotëronin vetëm 9.65% të depozitave të Kosovës, ndërsa në vitin 2017 ato kanë rritur zotërimin me mbi 14%. Për ilustrim në vijim paraqitet edhe tabela me të dhënat e detajuara:

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RITJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RITJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE


Tabela 11. Pesha e depozitave mbi totalin sipas origjinës së kapitalit

Deposit Weight per Year (%)	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Bank Kapital BE (Bankat 1, 2, 6)	79.44	75.29	71.07	66.21	66.71	64.90	63.83	61.93
Banka Kapital Turk (Bankat 5, 7, 9, 1)	9.65	12.51	15.97	21.27	21.17	22.79	22.63	23.70
Banka Kapital Serb (Banka 8)	1.54	1.67	1.71	1.75	1.92	1.93	1.85	1.86
Banka me Kapital Kosovar (Bankat 3)	9.37	10.53	11.24	10.77	10.20	10.38	11.69	12.52
Tottal Market	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00

Burimi: Të dhënat e publikuara nga bankat dhe BQK si edhe përpunim nga autori

Bankat tregtare me origjinë të kapitalit nga Kosova e kanë rritur pozicionin e tyre por me një përqindje shumë të ulët në masën rreth 3% duke zotëruar 12.5% të totalit të kursimeve të depozituara në Kosovë. Rënia e theksuar e bankave me kapital nga vendet e BE-së ka pasë qënë e ndikuar edhe nga politikat e bankave mëmë të cilat kanë pasë një tkurrje në strategjitë e tyre për rritje duke kufizuar rrjetin bankar, reduktim stafi por edhe interesat e depozitave me qëllim maksimizimin e fitimit. Bankat me kapital Kosovar nuk kanë aplikuar strategjitë e duhura dhe kanë vepruar në ndjekjen e rritjes pa analizuar tregun, njohur klientët dhe objektiva të qarta për të ardhmen dhe pozicionin e tyre në tregun bankar Kosovar. Pavarsisht se situata ndryshon nga njëra bankë tek tjetra, ato përsëri në ecuri kanë trend pothuajse të njëjtë. Cfarë trendi depozitash do të kenë në 5 vitet e ardhshme bazuar në të dhënat e përpunuara dhe nëse nuk do të ketë ndryshime të strategjive të bankave të sistemit bankar në Kosovë të grupuara sipas origjinës së kapitalit? Në vijim grafikët:

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRIJTJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRIJTJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE




Grafik13. Parashikimi deri në 2022 për peshën e depozitave që do të kenë akumuluar bankat me kapital nga vendet e BE

Burimi: Të dhënat e publikuara nga bankat dhe BQK si edhe përpunim nga autori

Përformanca e rritjes së 3BMT në terma të depozitave totale tregon gjithashtu se ajo ishte në ulje krahasuar bankat e tjera dhe sidomos ato të grupuara sipas kapitalit nga Turqia. Në parshikimin normal të kryer dhe prezantuar në grafikun e mësipërm tregohet se pjesa që do të zotërojë 3BMT pas 5 vjetësh nëse nuk ndryshon strategjitë e biznesit do të arrijë të zotëroj nivelin rreth 50% të depozitave të tregut të Kosovës.

Bankat me kapital nga Turqia kanë bërë shumë më mirë se sa bankat e tjera në akumulimin e depozitave për shkak të hapjes së tyre agresive përfshirë edhe zgjerimin e rrjetit bankar.

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRIJTJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRIJTJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE




Grafik 14. Parashikimi deri në 2022 për peshën e depozitave që do të kenë akumuluar bankat me kapital Turk

Burimi: Të dhënat e publikuara nga bankat dhe BQK si edhe përpunim nga autori

Siç tregohet në grafikun më sipër, në vitin 2022 pozicioni total i depozitave të bankave me kapital turk në një parashikim normal të ecurisë do të vijojë rritjen në nivelin rreth 34% të totalit të depozitave të tregut të Kosovës.

Siç është paraqitur në tabelat dhe grafikët e mësipërme, edhe pse ka rritje të akumulimit të depozitave të brendshme nga viti në vit në industrinë bankare në përgjithësi, ka një pabarazi të gjerë në normën e rritjes së depozitave midis bankave tregtare. Kjo evidentohet edhe në grupin e bankave me kapital kosovar siç paraqitet në grafikun në vijim;

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRIJTJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRIJTJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE



Grafik 15. Parashikimi deri në 2022 për peshën e depozitave që do të kenë akumuluar bankat me kapital nga Kosova

Burimi: Të dhënat e publikuara nga bankat dhe BQK si edhe përpunim nga autori

Pavarsisht veprimtarisë së tyre prej shumë vitesh në tregun bankar të Kosovës, ato në 2017 zotërojnë vetëm rreth 11.7% të tregut të depozitave. Sipas një parashikimi normal do të vijnë të mbajnë një rritje të lehtë duke arritur pas 5 vjetësh në nivelin rreth 14% të totalit të depozitave të tregut.


4.3.3. Analiza për 3BMT

Grupi i bankave me origjinë të kapitalit nga vendet e BE zotëron edhe grupimin më të madh të bankave tregtare në Kosovë, të quajtur në këtë punim si 3BMT. Në vijim paraqesim për analizë volumnin e depozitave të akumuluar që zotërojnë 3BMT ndaj totalit të tregut.

Grafiku në vijim tregon ecurin në vitet e fundit të kësaj tendence e cila nuk ka qenë e rastësishme dhe vetëm në një vit por ka një tendencë rënëse prej disa vitesh për shkak të një aktiviteti relativisht më të kufizuar të rrjetit bankar të 3BMT dhe ndërkohë që bankat e tjera

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RITJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RITJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

kanë qënë më shumë stabël dhe aktive në këtë drejtim si edhe strategjive të tjera konkurruese për akumulimin e depozitave me qëllim rritjen e investimeve/aseteve të bankave tregtare në Kosovë.




Grafik16. Ecuria e peshës së depozitave të çdo banke 3BMT ndaj totalit nga viti 2010
Burimi: Të dhënat e publikuara nga bankat dhe BQK si edhe përpunim nga autori

Si rezultat i humbjes së tregut nga 3BMT por edhe bankat e tjera private tregtare në Kosovë duhet të marrin në konsideratë strategjinë për zgjerimin e rrjetit të tyre duke konsideruar faktorë të tillë si niveli i konkurrencës dhe potenciali i depozitave. Meqenëse potenciali i depozitave është një tregues kyç që bankat e konsiderojnë në zgjerimin e degëve të tyre, akumulimi i tyre është një arsye për strategjinë e zgjerimit të degëve që sektori bankar duhet të konsideroj.

Bankat tregtare në Kosovë duhet të vendosin në objektivat e tyre rritjen e depozitave dhe në funksion të saj të evidentojnë strategjitë që japin efektivitetin më të lartë në tërësinë e analizës së kosto-përfitimeve për një aktivitet biznesi si banka. Një prej tyre është

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRIJTJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRIJTJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

përdorimi i rrjetit bankar si një strategji për zgjerimin e mbulimit gjeografik dhe segmente klientësh të papërfshirë financiarisht, duke u bazuar në qëllimin se ato mund të akumulojnë më shumë depozita vendase, si rrjedhim të rritin investimet, fitimin e tyre dhe rritjen ekonomike të Kosovës. Pozita në treg e secilës prej 3BMT lidhur me 2 aktivitet kryesore të tyre prezantohet pas përpunimit të të dhënave në grafikun në vijim.




Grafik 17. Pesha e depozitave dhe kredive në vitin 2017 të 3BMT ndaj totalit
Burimi: Të dhënat e publikuara nga bankat dhe BQK si edhe përpunim nga autori

Krahasuar me 3BMT, pjesëmarrja e depozitave nga bankat e tjera private tregtare është rritur nga viti 2010 në vitin 2017, si rezultat i politikës më stabël për shkurtimin dhe zgjerimin e rrjetit të bankave dhe përpjekjeve të tjera paralele të akumulimit të depozitave gjatë këtyre viteve.

Në vitin 2017, pjesa që 3BMT zotëron arrin rreth 62% të depozitave të tregut ndërkohë që në vitin 2010 ka qenë rreth 80% të totalit të depozitave të tregut bankar në Kosovë, duke treguar një trend të dukshëm rënës prej afërsisht 18%. Ulja e akumulimit të depozitave ka

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RITJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RITJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

sjellë edhe uljen e zotërimit të tregut të kredidhënies, pasi në vitin 2017, pjesa që 3BMT zotëron arrin rreth 60% të kredive të tregut ndërkohë që në vitin 2010 ka qenë rreth 79% të totalit të kredive të tregut bankar në Kosovë, duke reflektuar dukshëm trendin rënës prej afërsisht 19%. Pësja e 3BMT në depozita dhe kredi do të ishte akoma më e ulët nëse edhe banka e tretë në këtë grupim do të ndiqte të njëjtat strategji kufizimi rrjeti si edhe dy bankat e tjera më të mëdha. Kjo reflektohet edhe në grafikun në vijim ku evidentohet ecuria e secilës prej bankave në grupimin 3BMT.




Grafik 18. Ecuria e volumit të depozitave dhe kredive për 3BMT

Burimi: Të dhënat e publikuara nga bankat dhe BQK si edhe përpunim nga autori

Siç evidentohet nga prezantimi i të dhënave në grafikun më sipër dy prej bankave të grupimit 3BMT kanë qenë më konkurruese duke siguruar rritjen e peshës së tyre në treg si për depozitat por edhe për kreditë, duke bërë të mundur që njëra prej tyre nga banka e dytë në treg të kalojë në bankën e parë me zotërimin më të madh të tregut të Kosovës. Edhe banka e tretë ka një ritëm rritje ndër më të lartat në treg dhe kjo e bën atë të synoj rritje akoma më të madhe në të ardhmen.

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RITJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RITJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE



Grafik 19.Ecuria, devijancat dhe progresioni për depozitat dhe kreditë e 3BMT dhe totalit të tyre në Kosovë

Burimi: Të dhënat e publikuara nga bankat dhe BQK si edhe përpunim nga autori

Rritja ose ulja për çdo vit e depozitave të tregut bankar në Kosovë ashtu siç e kemi qartësuar gjatë gjithë këtij studimi reflektohet për çdo vit në rritjen ose uljen e investimeve (kryesisht kreditimit) të ekonomisë së Kosovës, por edhe rritjen ose uljen e fitimeve për bankat tregtare në Kosovë. Ajo që evidentohet pas përpunimit dhe prezantimit në grafikun më sipër, tregon edhe njëherë se tregu bankar i Kosovës vijon të ketë rritje të depozitave dhe si rrjedhim edhe investimeve të tyre. Sa i përket 3BMT ato kanë humbur një pjesë të tregut që zotëronin para vitit 2010 duke vijuar humbjen e tregut edhe sipas të dhënave të vitit 2017. Bankat 3BMT duhet të jenë më aktive sa i përket rolit të tyre në ekonominë e

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRIJTJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRIJTJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

Kosovës nëpërmjet akumulimit të burimeve financiare të kërkuara dhe sjelljes së përmirësimeve për zhvillimin e tregjeve financiare në Kosovë.


Tabela 12. Raporti Kredi/Depozita për çdo bankë tregtare

	Banka 1	Banka 2	Banka 3	Banka 4	Banka 5	Banka 6	Banka 7	Banka 8	Banka 9	Banka 10	Total Market (%)
2017	71.66	72.37	74.56	75.36	68.26	81.79	96.56	6.61	185.67	167.53	77.25
2016	69.98	70.88	77.22	74.90	67.17	81.09	105.66	5.44	178.18	269.70	76.62
2015	68.49	69.78	78.93	80.89	57.83	78.58	99.33	6.37	215.23	80.00	74.33
2014	65.41	78.23	77.67	78.24	60.43	69.93	99.97	7.42	186.49		73.75
2013	72.10	85.40	71.92	69.76	50.98	65.78	87.30	9.15			73.20
2012	84.74	87.80	78.88	77.38	91.66	74.72	100.00	10.86			83.80
2011	76.44	72.84	85.16	77.98	155.50	70.93	81.20	11.42			76.90
2010	70.46	66.13	85.93	89.44	117.85	79.44	80.55	12.04			79.53

Burimi: Të dhënat e publikuara nga bankat dhe BQK si edhe përpunim nga autori

Nga figura më sipër me të dhënat për çdo bankë dhe tregun lidhur me raportin kredi/depozita eidentojmë se ky tregues ka pasë luhatje për çdo vit por duke u kujdesur të qëndroj poshtë nivelit prej 80% siç janë edhe kërkesat për menaxhimin e riskut të likuiditetit nga BQK. Në vitin 2012 kemi nivelin më të lartë të këtij raporti. Duke konsideruar miratimin më datë 29 nëntor 2012 të rregullores “Për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit”, bankat tregtare të Kosovës ulën konsiderueshëm ritmin e ekspozimit të tyre duke u fokusuar më tepër në aplikimin e normave të larta të interest të kredive dhe kërkesa shumë të larta për mbulimin me kolateral të cilat shkojnë mbi 200% të shumës së kredisë. Të gjitha kreditë mbi 10,000 euro, sipas kërkesave të bankave komerciale janë të garantuara me kolateral.

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RITJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RITJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE




Grafik 20. Ecuria e Raportit Kredi/Depozita për çdo bankë tregtare

Burimi: Të dhënat e publikuara nga bankat dhe BQK si edhe përpunim nga autori

Grafiku më sipër tregon të njëjtën tendencë që evidentohet edhe në vendet e tjera në EJT për raportin hua depozita, pavarësisht se Kosova për gjithë tregun ka pasë një raport më të vogël se 100% ndryshe nga disa vende të tjera të EJT-së si psh Serbia e cila në shtator të vitit 2014 këtë raport e pati në nivelin 136% dhe ishte më i larti në rajon, duke krijuar pengim të financimit të ekonomisë së vendit shtuar këtu edhe raportin tjetër të kredive të këqija që ka qenë në nivelet më të larta të vendeve të EJT-së. Gjithashtu, Bosnja dhe Hercegovina dhe Mali i Zi kanë pasë raporte hua me depozita më të larta se 100.

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRIJTJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRIJTJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE




Grafik 21 Ecuria e Raportit Kredi/Depozita për gjithë tregun banker në Kosovë
Burimi: Të dhënat e publikuara nga bankat dhe BQK si edhe përpunim nga autori

Për Kosovën raporti kredi/depozita ka pasë kulmin e vet në vitin 2012 duke arritur në 83.8%. Ndërsa në vitin 2013 kemi një rënie të dukshme të këtij raporti me rreth 10%, i cili ka ardhë në rritje te lehtë për gjithë vitet e mëpasshmë deri në vitin 2017 ku raporti kredi/depozita është në nivelin rreth 77.25%. Siç evidentohet nga të dhënat e përpunuara dhe paraqitja grafike, analizojmë se ulja e raportit krededi/depozita por edhe rritja e lehtë e tij reflekton një mungesë të akumulimit të depozitave nga bankat tregtare dhe si rrjedhim edhe rritje të ngathët të kreditimit.

Tendenca për mbajtjen në nivele sa më të ulëta të mundëshme të raportit kredi/depozita evidentohet dukshëm për 3BMT në Kosovë sic paraqitet edhe në grafikun në vijim krahasuar me raportin e tregut.


ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRIJTJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRIJTJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE



Grafik 22. Raporti Kredi ndaj Depozitave të 3BMT sipas raportimeve të vitit 2017
Burimi: Të dhënat e publikuara nga bankat dhe BQK si edhe përpunim nga autori

Raporti kredi/depozita për 3BMT në Kosovë reflekton një nivel me rreth 3% më të ulët se ky raport për tregun. Kjo diferencë do të ishte edhe më e madhe nëse nuk do të përfshihej Banka 6 pavarësisht peshës më të vogël që ajo ka në 3BMT krahasuar me Banka 1 dhe Banka 2. Sipas analizës së evidentuar edhe në raportet e BB dhe FMN për vendet e EJT-së, nivelet e larta të likuiditetit dhe të kapitalit në EJT6 janë përgjigje e paqëndrueshmërisë së prurjeve financiare dhe pasigurisë së financimit nga bankat mëmë, ose daljes së mundshme prej tyre. Bankat e huaja nga eurozona dominojnë sektorin financiar në EJT, me përjashtim të Serbisë, dhe në tërësi aktivet e sektorëve financiar të EJT6-ës kanë rreth 80-90% pronësi të huaj. Tendanca e ecurisë së këtij raporti na jep mundësinë e kryerjes së parashikimeve të prezantuara në vijim;

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RITJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RITJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE




Grafik 23. Parashikimi deri në 2022 për ecurin e Raportit Kredi ndaj Depozitave për 3BMT
Burimi: Të dhënat e publikuara nga bankat dhe BQK si edhe përpunim nga autori

Evidentohet rënie e këtij raporti në nivelin rreth 69.48% për skenarin e ecurisë normale duke u ndikuar kryesisht nga parashikimi dhe pesha që ka në treg Banka 1 por edhe tendenca për të ruajtur një rritje të ulët nga Banka 2 pavarësisht rolit të deritanishëm që ka pasë Banka 6. Kjo vjen si pasojë e politikave të bankave mëmë, por që duhet përjasur me strategji të reja nga bankat tregtare në Kosovë duke vendosur në fokus rritjen e akumulimit të depozitave e cila sjell rritjen e financimit me qëllim gjenerimin e fitimeve dhe jo strategjitë passive për ruajtjen e këtij raporti vetëm duke ulur ekspozimin si pasojë e uljes së depozitave apo rritjen e lehtë të ekspozimit kur kemi rritjen normale që sjell vet tregu për rritjen e depozitave.

Tendenca e parashikimit të ecurisë së raportit kredi/depozita për Bankën 7 e cila është banka më e madhe e grupit të dytë (bankat me origjinë të kapitalit nga Turqia) që zotëron tregun bankar të Kosovës paraqitet si në vijim;

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRIJTJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRIJTJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE




Grafik 24. Parashikimi për ecurinë e Raportit Kredi/Depozita për Bankën 7

Burimi: Të dhënat e publikuara nga bankat dhe BQK si edhe përpunim nga autori

Bazuar në ecurinë e viteve të kaluar, evidentohet një rritje por karakteristikë e saj është devijacioni i përvitshëm me ulje dhe ngritje duke treguar një strategji të pakonsoliduar të vijimësisë së tyre në tregun e Kosovës.

Ndërsa, tendenca në të ardhmen për raportin kredi/depozita për Bankën 8 e cila evidentohet edhe nga grafiku në vijim që prej nisjes së veprimtarisë së saj në Kosovë duket se ka një strategji të qartë duke ushtruar veprimtarinë ëvetëm për akumulim të depozitave dhe jo financim përmes kreditimit por edhe ofrimin e shërbimeve të tjera bankare.

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRIJTJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRIJTJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE



Grafik 25. Parashikimi për ecurin e Raportit Kredi/Depozita për Bankën 8

Burimi: Të dhënat e publikuara nga bankat dhe BQK si edhe përpunim nga autori

Në raportin Kredi/Depozita, Banka 8 ka raportin më të ulët të evidentuar në gjithë bankat tregtare jo vetëm në Kosovë por edhe më gjerë. Nje raport prej 6.61% në vitin 2017 siç evidentuam edhe më sipër tregon strategjinë e bankës për të mbledhur depozita dhe në parashikimin normal për pas 5 vjetësh të kemi një raport rreth 0.17% duke e konsideruar këtë bankë më tepër si bankë kursimesh sesa bankë tregtare.

Rezultati i analizës së mësipërme tregon se industria bankare kosovare në drejtim të akumulimit të depozitave të brendshme, pavarësisht se në rënie vijon të mbizotërohet në mbi rreth 70% nga 3BMT të cilat janë edhe bankat me kapital nga vende të BE-së. Pavarësisht dominimit të tyre, sistemi bankar i shtetit të Kosovës ka përfituar nga veprimtaria e 3BMT duke njohur kërkesat mbikëqyrëse, know-how, zhvillimet teknologjike, mbështetjen me kapital, etj të bankave të tyre mëmë të cilat ushtrojnë veprimtarinë në vendet e BE-së. Konkurrenca e moderuar është e rëndësishme për industrinë bankare, si dhe për ekonominë në tërësi (De Nicoló, 2005). Ndërsa ai deklaroi se nëse konkurrenca bëhet më intensive, kjo

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRIJTJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRIJTJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

mund të çojë në pengim të bankave të tepërta, gjë që do të rezultojë në përkeqësimin e cilësisë së produkteve të bankave dhe gjendjes financiare. Përveç kësaj, do të ndodhë dështimi në konkurrencë, në burime joadekuate për të dhënë hua, në rënie të shpenzimeve për investime dhe në një aktivitet më të ngadalshëm ekonomik. Në rastin më të keq, bankat do të fillojnë të dështojnë, dhe frika mund të përhapet nga një bankë në tjetrën.

4.3.4. Disa tregues që bëhen faktor për rritjen ekonomike


Gjithashtu, në analizën e të dhënave evidentohet se ritmi i rritjes së depozitave diktohet kryesisht nga depozitat e ekonomive familjare, kategori që dominon strukturën e depozitave në sektorin bankar në masën 70% të totalit për vitin 2017, por ky segment ka ardhë duke humbur pjesë në zotërim në masën 3.2% krahasuar me vitin 2016, ndërsa depozitat e segmentit Ndërmarrje zënë 24.6% të totalit dhe për vitin 2017 në strukturën e depozitave të gjithë tregut kanë një rritje me 1.5% krahasuar me vitin 2016. Struktura e depozitave në banka ka ndryshuar në vitet e fundit ndërkohë që normat e interesit për depozita kanë shënuar ulje historike. Si rezultat, ka pasur më shumë depozita në llogaritë rrjedhëse dhe më pak depozita të afatizuara dhe llogari të kursimit. Më 31 dhjetor 2017, depozitat pa afat përbënin 60.3 përqind të totalit të depozitave, pasuar nga depozitat me afat me 24.2 përqind dhe depozitat e kursimit me 15.4 përqind. Sipas kërkesave të BQK në rregulloren për “Për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit” të miratuar më datë 29 nëntor 2012, në nenin 14 të saj kërkon monitorimin dhe marrjen e masave përkatëse në rast të rritjes së koncentritimit në llogaritë rrjedhëse. Kjo e fundit është një çështje sensitive në tregun e depozitave të Kosovës pasi referuar sa më sipër në fund të 2017 evidentohet se depozitat pa afat përbëjnë 60.3 përqind të totalit të depozitave. Ky është një rrisht i shtuar

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRIJTJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRIJTJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

duke kërkuar vëmendje për marrjen e masave me qëllim të paraprihet situatatve të mundëshme të tërheqjes së shpejtë të këtyre depozitave nga bankat dhe si rrjedhim edhe humbje të normës së likuiditetit dhe frikë për faliment për shkak të panikut që shoqëron mungesën e likuiditetit.

4.3.4.1. Norma e interesit

Norma mesatare e interesit për depozitat individuale ishte 1 përqind, ndërsa për bizneset ishte 1.7 përqind. Normat e interesit për kreditë kanë qenë me një rënie të lehtë për disa vite tashmë, ndërsa në vitin 2017, norma mesatare efektive e interesit për kreditë ka rënë nga 7.2 përqind në 6.8 përqind. Normat e interesit për kredi kanë rënë si për bizneset ashtu edhe për individët. Më 31 dhjetor 2017, norma mesatare e interesit për bizneset ishte 6.5 përqind duke shënuar rënie nga 6.8 përqind, ndërsa për individët ishte 7.3 nga 7.9 përqind në vitin 2016. Këto ndryshime në strukturën e depozitave kanë ardhë si pasojë e normave të interesit në depozita të aplikuara nga bankat tregtare përgjatë vitit 2017, ku sipas raportit vjetor të BQK-së për vitin 2017 evidentohen:



Grafik 26. Norma mesatare e interesit në depozita
Burimi: BQK (2018)-Raporti vjetor -2017


ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRIJTJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRIJTJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

Normat e interesit kanë pasë një rënie shume të ndjeshme pas vitit 2013 duke reflektuar edhe njëherë ritmin e rritjes së depozitave i cili ishte 16.27 në vitin 2013 dhe u ul në 3.65% në vitin 2014. Sipas grafikut më sipër evidentohet qartë tendenca dhe lidhja e drejtë që ekziston mes normës së interest të depozitave dhe akumulimit/rritjes se depozitave/kursimeve në sektorin bankar. Pavarisht se normat e interest për depozitat e Ndërmarrjeve janë më të larta se ato për Ekonomitë Familjare, efekti në rritjen e përgjithshme të depozitave në Kosovë nuk mund të jetë shumë i dukshëm sepse janë familjet ato që krijojnë më tepër kursime. Norma e interest të depozitave është nga faktorët kryesor për ecurin dhe akumulimit/rritjes se depozitave/kursimeve në sektorin bankar në Kosovë.

Në çdo treg bankar, ashtu edhe në Kosovë, depozitat me afat (të afatizuara) kanë norma interesi depozitash më të larta se depozitat e kursimit apo depozitat e transferueshme (paratë që akumulohen në llogaritë rrjedhëse të segmenteve familje apo ndërmarrje). Përveç se Dhjetor 2015, kur kemi pasë një normë interesi depozitash me afat lehtësisht mbi 1%, për të gjitha periudhat e tjera norma e interest ka qenë më e ulët dhe sidomos për dy kategorit e tjera të depozitave (të transferueshme dhe të kursimeve) ku norma e interest ka qenë nga 0% në 0.3%, sipas raportit vjetor të BQK-së për vitin 2017:

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRIJTJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRIJTJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

Fig 3. Norma mesatare e interesit në depozita për ekonomitë familjare, sipas kategorive



Burimi: BQK (2018)-Raporti vjetor -2017


Një indikator i matjes së nivelit të konkurrencës në sektorin bankar, është diferenca e normave të interesit të kredive dhe normave të interesit të depozitave, që në Kosovë shënohet me mbi rreth 6 %. Ka një reduktim të këtij treguesi përgjatë viteve të fundit por vazhdon të mbetet diferenca më e madhe në rajon. Diferenca e lartë mes normës së interesit të kredive dhe depozitave në Kosovë konsiderohet si një indikator i efikasitetit të ulët të ndërmjetësimit të bankave tregtare në Kosovë. Nga njëra anë dekurajon kursimtarët potencial të rrisin volumin e depozitave në banka pasi ata nuk kanë motivim se do të mund të kenë një kthim nga investimi i tyre, kur interesat pothuajse janë 0%, për të mos u shprehur për normën reale të interesit. Nga ana tjetër dekurajon edhe investitorët të kërkojnë të marrin kredi pasi kanë kosto të larta financimi. Siç e kemi prekur edhe më herët, roli ndërmjetësimit bankar në ekonominë e Kosovës është decisiv edhe për shkak të mungesës së tregut të kapitaleve, duke i bërë bankat tregtare të vetmin burim për financim në Kosovë.

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRIJTJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRIJTJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

Si rrjedhim, motivimi i ekonomive familjare të Kosovës për të kursyer dhe depozituar në bankat tregtare të Kosovës ngelet i ulët ndikuar nga ky faktor. Por nga ana tjetër, normat e interesit për kreditë janë dukshëm shumë të larta, gjë e cila krijon fitim për bankat tregtare por nuk ndihmon në rritjen e qëndrueshme ekonomike të Kosovës. Kjo evidentohet edhe në grafikun e mëposhtëm i cili sipas raportit vjetor të BQK-së për vitin 2017, tregon se sektori bankar në Kosovë karakterizohet me fitime të konsiderueshme në masën 85.4 milion Euro, ndërsa në harkun e 4 viteve të fundit bankat tregtare në Kosovë kanë fituar në total 315.6 milion euro, duke mbajtur nivel të lartë të profitabilitetit. Fitimi kryesor i bankave realizohet nga të ardhurat nga investimet e depozitave të akumuluar në Kosovë, ky është biznesi kryesor i bankave tregtare. Pavarësisht vështirësive të mëdha ekonomike të Kosovës gjatë viteve të fundit, bankat kanë pasur mundësi që të ulin interesat e dhëna për depozitat me disa here më shumë se sa ulja e interesave të kredive, duke mundësuar kështu marzhe të larta fitimi për çdo njësi depozite të akumuluar. Ndikim në treguesit financiar të bankave ka dhënë edhe rënia e kredive joperformuese nga 4.9% në 3.1%, duke qenë në një nivel shumë të ulët krahasuar me vendet e Ballkanit Perëndimor. Ky tregues duhet të motivoj bankat tregtare të ulin normat e interesit të kredive dhe investimin në projekte afatgjata për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të Kosovës.

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRIJTJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRIJTJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

Fig 4. Fitimi neto i sektorit bankar, në miliona euro



Burimi: Përpunimi i të dhënave të BQK nga autori

Deri më 31 dhjetor 2017, fitimi neto i sektorit bankar ishte 85.4 milionë euro (2016: 75.5 milionë euro). Në përgjithësi, shpenzimet e sektorit bankar ishin në të njëjtin nivel me vitin 2016. Edhe pse shpenzimet administrative u rritën me 4.8 përqind, kjo u kompensua nga rënia prej 31 përqind e shpenzimeve të jointerës. Kthimi në asete mesatare mbeti në nivelin e njëjtë si në vitin 2016, në 2.6 përqind (2016: 2.2 përqind). Kthimi në kapitalin mesatar ishte 21.3 përqind (2016: 18.5 përqind). Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit (kapitali rregullativ/asetet e peshuara ndaj rrezikut) ishte 18 përqind, ngjashëm me 17.9 përqind sa ishte më 31 dhjetor 2016. Në vitin 2017, është përmirësuar si raporti i kredive joperformuese ashtu dhe raporti i mbulimit të kredive joperformuese me provizione. Më 31 dhjetor 2017, raporti i kredive joperformuese ndaj totalit të kredive ka shënuar rënie në 3.1 përqind (2016, 4.9 përqind). Përveç kësaj, raporti i mbulimit të kredive joperformuese është përmirësuar nga 127 përqind më 31 dhjetor 2016 në 151 përqind më 31 dhjetor 2017.

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRRITJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRRITJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

4.3.4.2. Kërkesat e reja të Bazel III për likuiditetin

Kërkesat e reja të Bazel III për likuiditetin japin efekt në bankat e Kosovës me mëmë nga vendet e BE-së. Duke konsideruar që tregu banker i Kosovës zotërohet në masën mbi 70 nga 3BMT të zotëruara nga banka mëmë në vendet e BE-së, prej disa vitesh ato kanë përjasje me kërkesat e reja sipas BASEL III lidhur me rrezikun e likuiditetit sipas dokumentit “Parimet e Qëndrueshme për Menaxhimin e Riskut të Likuiditetit dhe Mbikëqyrjes” pasi zhvillimet e krizës financiare vunë në dukje që likuiditeti është po aq i rëndësishëm sa kapitali dhe menaxhimi i riskut në sektorin banker duke aplikuar dy standarde minimale mbi fondet e likuiditetit me qëllim që bankat të kenë asete likuide të cilësisë së lartë të mjaftueshme për të përballuar tronditjet e një krize.

Detyrimet e vendosura nga Bazel III mbi likuiditetin janë në formën e dy raporteve matëse:

1. Raporti i Mbulimit të Likuiditetit (LCR) dhe 2. Raporti i Fondeve të Qëndrueshme Neto (NSFR).

1. Raporti i Mbulimit të Likuiditetit (LCR). LCR është Raporti i Mbulimit të Likuiditetit dhe kërkon që bankat të kenë minimalisht një sasi “asete shumë likuide” të barabartë me nevojat totale neto për para (rrjedhjet neto negative të parasë) në muajin në vazhdim. Në rast se banka i disponon këtë sasi të aseteve likuide do të lejonte bankën të mbijetonte për një muaj në mungesë fondesh si rrjedhojë e një krize likuiditeti. Është e rëndësishme të kuptohet që egziston një mundësi statistikore që një aset i konsideruar si shumë likuid të kthehet në jolikuid gjatë një krize, dhe si rrjedhojë periudha e mbijetesës së bankës të jetë edhe më e vogël se ajo që parashikohet.

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RITJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RITJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

2. Raporti i Fondeve të Qëndrueshme Neto (NSFR). NSFR është Raporti i Fondeve të Qëndrueshme Neto. Ky detyrim ka si qëllim të krijojë stimuj që bankat të kenë më shumë forma të qëndrueshme fondesh për të financuar asetet më pak likuide. Raporti i Fondeve të Qëndrueshme kërkon që investimet dhe huatë e dhëna nga banka me afat më të gjatë se një vit të mbështeten nga burime fondesh të qëndrueshme. Që fondet të konsiderohen të qëndrueshme ato duhet të jenë a) me afat më të gjatë se një vitë ose b) me afat më të shkurtër se një vitë por nga burime të konsideruara të qëndrueshme.

Me implementimin e Bazel III bankat mëmë të bankave tregtare në Kosovë me origjinë të kapitalit nga vendet e BE-së kanë filluar analizimin e mundësive për të zgjeruar investimet të konsideruara likuide dhe po zvogëlojnë aktivitetet që kanë efekt negativ në matjen e likuiditetit sipas Bazel III si pasojë e kërkesave raportuese për bankën mëmë. Aktivitetet që nuk kanë ekspozim në pozicionin financiar dhe që gjenerojnë të ardhura në formë komisionesh do bëhen më tërheqëse për këtë sektor. Edhe sipas konstatimeve në working papers të BASEL, bankat duhet të bazohen gjithnjë e më shumë në depozitat nga klientët si formë më e qëndrueshme financimi, ndërsa do të duhet të rishikojnë çmimin e kredive që japin si rrjedhojë e rritjes së kostove.

Gjithashtu, në pasqyrat financiare të bankave tregtare në Kosovë evidentohen edhe rritje e konsiderueshme e të ardhurave nga komisionet dhe shërbimet për klientët e tyre. Edhe ky faktor vijon të mos motivojë kosovarët të përdorin bankat dhe терминаlet e tyre për depozitim të parave dhe kryerjen e pagesave dhe shlyerjen e detyrimeve përmes sistemit bankar, por i motivon ata të përdorin paranë “cash” si mënyrë pagese, duke sjellë kështu kosto për BQK, bankat tregtare dhe kufizim të rritjes ekonomike të Kosovës, përveçse rritje


ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RITJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RITJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

të kriminalitetit dhe çështjeve sociale. Qarkullimi i madhi i parasë “cash” në ekonominë e Kosovës evidentohet edhe në RV 2017 të BQK lidhur me Operacionet me para të gatshme /cash në tregun bankar në Kosovë, ku gjatë vitit 2017 BQK-ja siguroi një ofertë kualitative dhe kuantitative të kartëmonedhave dhe monedhave euro për sektorin bankar me qëllim të shlyerjes së transaksioneve me para të gatshme të ekonomisë dhe qytetarëve duke e furnizuar sektorin bankar në vlerë prej afër 426.1 milionë euro. Vlera e përgjithshme e furnizimit me para të gatshme në vitin 2017, shënoi një rritje prej 13.6 % krahasuar me vitin 2016.

Siç është paraqitur në figurën e mëposhtme, në vitin 2013 evidentohet se ka qenë niveli më i ulët i furnizimit me para të gatshme (cash). Nëse do ta krahasojmë me vitin 2017 ku kemi pathuajse një dyfishim të parave të gatshme në qarkullim. Sjellim në kujtes disa evidente të mëparshme të këtij punim, ku spikat viti 2013 për ritmin më të lartë të akumulimit të depozitave nga bankat tregtare, por edhe normave motivuese të interesit të depozitave si edhe mos nisjen e politikës së bankave për kufizimin e shtrirjes gjeografike të tyre me njësi/degë në të gjithë territorin e Kosovës, etj.

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRIJTJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRIJTJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

Fig 5. Furnizimi me para të gatshme (vlera) në miliona euro




Burimi: BQK (2018)-Raporti vjetor -2017

Pra, sa më sipër evidentohet dukshëm rritja e madhe e qarkullimit me para/cash në tregun bankar gjë e cila evidenton një prej çështjeve që evidentoj përmes këtij punimi se bankat tregtare në Kosovë nuk po hartojnë strategjitë e duhura për qarkullimin e vlerave monetare brenda kanaleve të sistemit bankar.

4.3.4.3. Remitancat.

Një faktor i rëndësishëm në ekonominë e një vendi krahas depozitave dhe nivelit të kreditimit mbeten padyshim edhe efekti i remitancave të cilat edhe pse janë faktor i jashtëm, shpesh i përkohshëm përbëjnë një element të rëndësishëm. Ashtu si edhe në ekonominë e vendeve të tjera në zhvillim edhe në ekonominë e Kosovës ndikimi i remitancave mbetet i padiskutueshëm pavarësisht luhatjeve të tyre në periudha të ndryshme. Kështu të dhënat e paragitura në grafikun më poshtë tregojnë se trendi i tyre është rritës nga 2010-2017 me një rritje thuajse konstante me prjashtim të vitit 2009 që ka një rënie me rreth 30 milion euro dhe vitit 2017 që ka pasë një rritje mbi dyfish më të madhe se rritja e vitit 2016.

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RITJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RITJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE



Grafik 27. Ecuria e Remitancave

Burimi: Përpunimi i të dhënave të BQK nga autori


Nëse marrim për krahasim, gjithë vendet e Evropës Jug Lindore (EJL) atëherë sipas raportit të Bankës Botërore¹⁶, performanca zhgënjyese e rritjes në Eurozonë vazhdon të kufizojë prurjet e remitancave. Kontributi i remitancave për financimin e deficitit tregtar është i dukshëm në të gjithë EJL6-en. Remitancat janë veçanërisht të rëndësishme për ekonomitë e Shqipërisë, Bosnje dhe Hercegovinës, dhe Kosovës, me burimin kryesor të remitancave nga ekonomitë e Greqisë, Italisë, Zvicrës, Austrisë dhe Gjermanisë. Gjithashtu sipas këtij raporti, prurjet neto të investimeve të huaja direkte në Serbi dhe në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë janë rritur për shkak të zgjerimit të kapaciteteve prodhuese të impianteve ekzistuese të financuara nga investimet e huaja direkte dhe të investimeve të reja në rastin e Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë. Ndërkohë, pjesa tjetër e shteteve prurjet e investimeve të huaja direkte u ulën. Ulja më e theksuar në rajon u vu re në Kosovë, për shkak të rritjes së pasigurive rreth krizës politike paszgjedhore dhe dështimit të privatizimit të Postës dhe Telekomunikacioneve të Kosovës (PTK) në vitin 2013.

¹⁶ <http://www.worldbank.org/content/dam/Worldbank/document/eca/seerer7-al.pdf>

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RITJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RITJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

4.3.4.4. Ushtrimi veprimtarisë nga 4 degë bankash të huaja në Kosovë

Një tjetër tregues për tu pasë në vëmendje është ecuria e degëve të bankave të huaja në Kosovë, të cilat përbëjnë 40% të numrit të bankave që ushtrojnë veprimatrine bankare në Kosovë. Nga këto tre prej tyre kanë originën e kapitalit nga Turqia dhe 1 prej tyre nga Serbia. Ecuria e tyre në akumulimin e depozitave bazuar në peshën që ato kanë në vite paraqitet në grafikun në vijim.



Grafik 28. Pesha e depozitave të degëve të bankave të huaja
Burimi: Përpunimi i të dhënave të BQK nga autori

Në vitin 2017 ato zotërojnë rreth 410 milion euro ose rreth 13.2% të totalit të depozitave të Kosovës. Ndërsa për tregun e kredive në vitin 2017 ky grupim zotëron rreth 302 milion euro ose rreth 12.64% të totalit të kredive. Ky tregues është i zotëruar kryesisht nga Banka 5 në masën rreth 8.6% ndaj totalit të kredive në Kosovë dhe pastaj e ndjekur nga Banka 9 me rreth 3.34%. Raporti kredi/depozita për këtë grupim është në nivelin rreth 73.65%, por efekti devijon për arsye se dega e Bankës 8 ka një ekspozim pothuajse minimal, ndërsa

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRIJTJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRIJTJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

dega e Bankës 9 dhe dega e Bankës 10 të cilat janë në fillim të veprimtarisë së tyre në Kosovë kanë ekspozim më të madh se depozitat e akumuluar.

Rritja e peshës së degëve të bankave të huaja është evidente nga viti në vit dhe për më tepër pas fillimit të veprimtarisë edhe të dy degëve të tjera të bankave turke. Degët e bankave të huaja që akumulojnë depozita në Kosovë kanë pasë një rritje me mbi 10% të totalit të depozitave krahasuar me 10 vjet më parë. Peshën kryesore në këtë grup vazhdon ta ketë dega e Bankës 5 me 9.75% e ndjekur nga dega e Bankës 8 me rreth 2% të totalit të depozitave të Kosovës.

Sipas raportit të Bankës Botërore¹⁷, nga rreziqet kryesore që kanosin sektorin financiar në Kosovë si pjesë e EJK-së është varësia e lartë e bankave tregtare në Kosovë nga bankat e tyre mëmë, gjithashtu veprimtaria e disa degëve të bankave të huaja në Kosovë varet nga mbështetja e bankave mëmë, gjë e cila e bën sistemin të cenueshëm ndaj zhvillimeve të jashtme. Kjo sepse kanë kufizime në aksesin e kufizuar tek financimi i jashtëm, vulnerabiliteti i disa bankave dhe ligështimi i zgjatur në zonën e euros përbëjnë rrezik për një rritje të qëndrueshme ekonomike të Kosovës.

4.3.4.5. Rrjeti bankar dhe akumulimi i depozitave

Qasja e kufizuar në institucionet financiare konsiderohet të jetë një nga arsyet për kursimin e ulët kombëtar të Kosovës. Zgjerimi i qasjes në institucionet financiare është një strategji ende e pastrukturuar nga qeveria e Kosovës për të mobilizuar fondet e pashfrytëzuara. Bankat tregtare që prej viti 2013 duket se kanë ulur numrin e agjensive/zyrave nga 245 në

¹⁷ <http://www.worldbank.org/content/dam/worldbank/document/eca/seerer7-al.pdf>

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RITJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RITJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE


183 në vitin 2017 në të gjithë vendin në bazë të objektivave të tyre për reduktimin e shpenzimeve, por kanë rritur investimet në bankingun online duke rritur numrin e llogarive E-banking me 200% gjatë kësaj periudhe kohore, me qëllim për të krijuar akses më të gjerë në online banking.

Por strategjia e online banking për vendet në zhvillim nuk ka ndihmuar qenësisht në rritjen e përfshirjes financiare dhe si rrjedhim edhe të akumulimit të depozitave. Kjo risjell në vëmendje që përmes zgjerimit të degëve bankat gjithashtu do të krijojnë qasje në shërbimet financiare për komunitetin në çdo zonë të vendit, prandaj, hapja e degëve/zyrave shitesë në zonat potenciale të vendit është një nga mjetet e akumulimit të depozitave, rritjes së përfshirjes financiare dhe si rrjedhim rritjes së qëndrueshme ekonomike të Kosovës. Gjithashtu, dega/zyra i mundëson bankës të ketë qasje më të mirë tek konsumatorët, si rrjedhim logjik dhe bazuar në praktikën e deritanishme, banka që ka një qasje më të mirë për klientët ka gjasat për të qenë banka udhëheqëse në industri, e cila lehtësisht mobilizon burimet financiare, rrit investimet e saj dhe fitimin.

Tabela 13. Bankat që veprojnë në industrinë bankare kosovare degët dhe zyrat e tyre.

Njesite e Bankave	2013	2014	2015	2016	2017
Banka	9	9	10	10	10
Dege	44	45	45	45	45
Zyra	245	223	210	207	183


ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRIJTJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRIJTJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE



Grafik 29. Ecuria e rrjetit bankar sipas numrit të degëve/zyrave

Burimi: Përpunimi i të dhënave të BQK nga autori

Trendi pesëvjeçar tregon një strategji konsistente të bankave për mbyllje të zyrave të tyre në Kosovë, pavarësisht se ngushtimi i rrjetit është bërë në mënyrë proporcionale në të gjitha regionet dhe jo nga të gjitha bankat me të njëjtin ritëm. Gjithësesi për shkak të peshës së madhe që kanë në treg dhe nëse vijon edhe për një pesëvjeçar tjetër e njëjta strategji për kufizimin e rrjetit bankar do të kemi një parashikim për të gjithë rrjetin bankar në Kosovë do të kemi paraqitjen si në vijim:




Grafik 30. Parashikimi i ecurisë së rrjetit të zyrave bankare deri në vitin 202

Burimi: Përpunimi i të dhënave të BQK nga autori

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRIJTJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRIJTJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

Në rastin më të mirë në vitin 2022 do të kemi 146 zyra bankare nga 207 që janë në fund të vitit 2017, që do të thotë mbylljen edhe të afersisht 60 zyrave bankare, pra largimin nda 60 distenacione gjeografike, largimin nga segmentet e klientëve, mos qënien pranë tyre, mos kuptimin e nevojave të tyre, mos afrimin e shërbimeve bankare tek segmentet e papërfshira financiarisht dhe gjithashtu mosakumulimin e kursimeve të këtyre segmenteve të klientëve.

Për shkak të mbylljes së degëve nga bankat kryesore, edhe ritmi i akumulimit të depozitave të brendshme (rrjedhese, kursimi, me afat) nga këto banka ka ardhë në rënie krahasuar me banka të tjera tregtare të cilat kanë ruajtur një stabilitet më të madh për prezencën e tyre me degë/zyra në Kosovë. Në vijim paraqitet me grafik parashikimi deri në vitin 2022 i ecursisë në akumulimin e depozitave të një banke që ka kufizuar rrjetin bankar në tregun bankar të Kosovës:




Grafik. 31. Parashikimi i ecursisë së akumulimit të depozitave nga banka që ka kufizuar rrjetin bankar

Burimi: Përpunimi i të dhënave të BQK nga autori

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRIJTJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRIJTJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

Siç mund të evidenohet nga grafiku, të gjitha parashikimet janë në rënie, përfshirë këtu edhe parashikimin optimist. Në parashikim normal evidentohet që kjo bankë nga 34.4% të tregut të depozitave që akumulonte në vitin 2010 do të ketë rënie në 12.8% në vitin 2022 nëse do të vijoj me të njëjtën strategji siç ka zbatuar këto 8 vitet e fundit. Ndërkohë që tregu bankar i Kosovës ka banka të cilat kanë ruajtur një vijimësi pothuajse të qëndrueshme në prezencën e tyre me degë/zyra në Kosovë, dhe në vijim paraqes me grafik parashikimin e ecursë së një bankë deri në vitin 2022 në akumulimin e depozitave:




Grafik 32. Parashikimi i ecursë së akumulimit të depozitave nga banka që ka ruajtur rrjetin bankar
Burimi: Përpunimi i të dhënave të BQK nga autori

Siç paraqitet edhe përmes parashikimit të prezantuar në grafikun e mësipërm, kjo bankë do të ruaj pjesën e saj të tregut edhe për vitet në vijim, por do të rritë akumulimin e depozitave nëse do të aplikoj strategjitë e duhura si ajo e zgjerimit me zyra apo njësi të tjera shërbimi, etj.

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRIJTJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRIJTJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

4.3.4.6. Tregu bankar në Kosovë dhe online banking.


Tregu bankar në Kosovë ka kryer dhe vijon të kryej një punë cilësore lidhur me online banking, duke prezantuar tregues mbresëlënës në ecurin e tyre në vite. Kjo tregon angazhimin e bankave tregtare në Kosovë për zhvillimin e online banking i cili është një trend i vendeve botërore falë edhe zhvillimeve teknologjike të cilat kanë mundësuar shumë prej shërbimeve bankare të cilat dikur mund të duhej disa javë deri në një muaj të kryheshin, ndërsa sot ato kryhen brenda një dite pune.



Grafik 33. Ecuria e POS dhe Online Banking Acc. deri në Qershor 2017 në Kosovë
Burimi: Përpunimi i të dhënave të BQK nga autori

Në grafikun në vijim duke u bazuar në trendin e të dhëna të publikuara nga BQK kam kryer një parashikim për një afat 5 vjeçar të ecurisë së numrit të llogarive online banking të cilat përdoren nga kosovarët për kryerjen e bankingut.

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRIJTJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRIJTJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE



Grafik 34. Parashikimi i ecursisë së aktivizimit të online banking accounts deri në vitin 2022
Burimi: Përpunimi i të dhënave të BQK nga autori

Kjo vjen si një tregues shumë pozitiv në zhvillimin e industrisë bankare në Kosovë, duke ju mundësuar kryesisht grupmoshave që janë më të familjarizuar me përdorimin e teknologjisë. Gjithësesi shërbimet e online banking shoqërohen edhe me disa lloje risqesh të cilat duhet tju bëhen me dije konsumatorëve të bankave në Kosovë si edhe të merren masa për reduktimin dhe manaxhimin e tyre me kosto sa më të ulët të mundshme.

Grafikët e mësipërme ilustrojnë trendin e rritjes të degëve të bankave në përgjithësi. Në vitin 2000 industria bankare nisi veprimtarinë e saj të zgjerimit të rrjetit të degëve/zyrave deri në vitin 2013 trendet tregojnë për një rritje, megjithatë, nga 2013 e tutje grafiku vjen me ulje të rrjetit të degëve por me rritje të dukshme të POS dhe llogarive online banking.

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRIJTJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRIJTJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

Rezultati analitik i studimit tregon se numri i degëve në industri u rrit me shpejtësi deri në vitin 2013. Në vitin 2017, numri i bankave tregtare që veprojnë në vend është 10. Dy banka me kapital vendas dhe 8 të tjera me kapital të huaj. Si rezultat i hyrjes së bankave me kapital të huaj në tregun bankar në Kosovë, solli që numri i degëve/zyrave të bankave të rritet. Por, trendi i zgjerimit të bankave të tjera ka qënë më i madh se i 3BMT duke vetëkuptuar intensifikimin e konkurrencës midis bankave.

Bazuar në literaturën dhe rezultatin e studimit tregohet se rrjeti bankar (rrjeti bankar përfshin: degët, zyrat, agjensitë, ATM, POS, online banking) u mundëson bankave të rrisin praninë e tyre gjeografike. Përmes një rrjeti bankar të zgjeruar bankat kanë akses në më shumë burime financiare vendase; gëzojnë përfitimet e operacioneve në shkallë më të gjerë; kapacitet më të madh për të përballuar rreziqet dhe ka një avantazh konkurrues mbi të tjerët.

4.3.4.7. Roli i shtetit në këtë aspekt të ekonomisë

Objektivat kryesorë të politikës makroekonomike të shtetit të Kosovës duhet të kenë një përqasje të qartë për një rritje ekonomike të shpejtë, të qëndrueshme dhe të gjerë përmes krijimit të një mjedisi makroekonomik dhe kuadri ligjor të favorshëm. Gjatë këtyre viteve të fundit, Kosova ka një norma reale të rritjes së PBB-së poshtë mesatares së kërkuar për një vend në zhvillim dhe pjesëmarrja e bujqësisë dhe industrisë përpunuese nuk janë në parametrat e duhur për të gjeneruar rritje të lartë dhe të qëndrueshme ekonomike. Kështu, procesi i rritjes ekonomike të Kosovës duhet të përshpejtohet për të sjellë një ndryshim të rëndësishëm në strukturën e ekonomisë në mënyrë të veçantë, për të vendosur ekonominë në një proces të shpejtë të industrializimit dhe transformimit strukturor. Kjo nënkupton që

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRIJTJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRIJTJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

shteti të bëj një mbështetje të gjerë të industrisë prodhuese dhe gjithashtu rritjen e produktivitetit të bujqësisë në mënyrë që të mbështetet procesi i industrializimit dhe zhvillimit të eksportit, kështu industria bankare do të mbështesë më shumë sektorin e prodhimit në Kosovë. Sipas raporteve vjetore të bankave tregtare, pak mbështetje ka prej tyre për bizneset në industrinë e bujqësisë dhe prodhimit, ndërkohë që tregtia e brendshme është kryesisht domen i bankave private.

Duke mbajtur parasysh sa më lart, sektori i prodhimit ka nevoja unike bankare që përfshijnë ndihmë financiare për nevojat e rrjedhës së parasë, financimin e rritjes ose blerjet dhe projektet e reja. Bilancet e bankave në Kosovë tregojnë se edhe pse financimi i tyre në hua për bizneset private dhe individuale është pjesa më e madhe e investimeve totale të tyre, ai përsëri është i alokuar kryesisht në bizneset e tregëtisë, blerje pasurish dhe nevoja konsumi për individët.

Si rrjedhim, mos financimi i bizneseve të vogla dhe të mesme, bujqësisë, industrisë së prodhimit, bizneseve të reja apo atyre me mungesë kolaterali siç kërkohet nga bankat tregtare, kufizon rritjen e qëndrueshme ekonomike të Kosovës. Kjo është arsyeja pse qasja në financa është raportuar si një nga pengesat kritike për zhvillimin e biznesit në Kosovë në raportet e BB.

Bazuar në literaturën, sektori bashkëkohor i prodhimit ka një karakter të standardeve të larta të cilësisë, inovacionit dhe makinerive të mbështetura nga hi-tech dhe rritjes së vazhdueshme që ka nevojë për mbështetjen e një banke e cila e kupton sektorin dhe investon në projekte afatgjata. Kjo nënkupton se kërkohet prej bankave të kenë më shumë alokim të fondeve të duhura për të mbështetur sipërmarrësit, të ofrojnë shërbime të

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RITJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RITJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

specializuara udhëzuese / këshilluese dhe komisione të reduktuara për shërbimet bankare.

Në disa vende në zhvillim ka banka me kapital shtetëror të angazhuara në rritjen e përfshirjes financiare si edhe financimin për bizneset e prodhimit, bujqësisë dhe ato zhvëllimore që përshpejtojnë avancimin e qëndrueshëm të ekonomisë së vendit.

Vetëm nëse kufizime të tilla financiare do të adresohen siç duhet, do të kemi rritje ekonomike nga potenciali i përfshirjes financiare. Në rast të kundërt, ky fenomen nuk kufizohet por zgjerohet dhe si rrjedhim Kosova nuk mund të jetë në gjendje të mbaj strategjinë e saj të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik.

4.3.5. Përfundime

Sistemi bankar siguron alokimin efikas të burimeve në një ekonomi përmes qarkullimit dhe financimit të sektorëve të ndryshëm të cilët janë biznese, individë apo shtet. Akumulimi i depozitave është vendimtar për rritjen e investimeve në Kosovë. Në këtë mënyrë, bankat tregtare duhet të jenë në dijeni të situatës së likuiditetit në Kosovë, mjedisit makroekonomik në të cilin ato veprojnë dhe ndikimin e bankës qendrore në mënyrë që të lehtësojnë synimet e këtyre produkteve dhe shërbimeve për të akumuluar kursimet e depozituesve në bankat e tyre tregtare. Ndërsa mos veprimet e qeverive nuk kanë ndikuar pozitivisht në rritje më të madhe të besimit për ekonominë e vendit dhe sektorin bankar.

Një nga funksionet më të rëndësishme të bankave tregtare në Kosovë është ndërmjetësimi financiar; duke mobilizuar depozita nga ata që kanë furnizim të tepërt dhe duke u dhënë atyre me kërkesa për fonde. Në kërkimin e tyre për të përmbushur këto objektiva bankat tregtare identifikojnë mjete të ndryshme për të lehtësuar operacionet e tyre. Bankat tregtare

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RITJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RITJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

në Kosovë përmes produkteve të tyre të ndryshme janë përpjekur për të rritur akumulimin e depozitave por ende jo mjaftueshëm. Mekanizmi gjithmonë ka qenë vetëm dizenjimi dhe reklamimi tradicional i produkteve. Por, këto produkte duhet të jenë të dizajnuara për t'u fokusuar tek konsumatorët. Në të vërtetë, ato duhet të jenë të dizajnuara për të synuar klientët e tyre potencial korporata, biznese të vogla dhe të mesme , dhe sidomos familjet kosovare kudo që jetojnë përmes depozitave të transferueshme, depozitave të kursimit dhe depozitave me afat. Mbi të gjitha, produktet duhet të tërheqin dhe të mbajnë klientë të vlefshëm për të qenë në gjendje të gjenerojnë fitimet e kërkuara.

Në këtë pjesë të punimit evidentohet rritje e konsiderueshme e të ardhurave nga komisionet dhe shërbimet për klientët e bankave në Kosovë. Kjo demotivon kosovarët të përdorin bankat dhe терминаlet e tyre për depozitim të parave dhe kryerjen e pagesave dhe shlyerjen e detyrimeve përmes sistemit bankar, por i motivon ata të përdorin paratë “cash” si mënyrë pagese, duke sjellë kështu kosto për BQK, bankat tregtare dhe kufizim të rritjes ekonomike të Kosovës, përveçse rritje të kriminalitetit dhe çështjeve sociale. Në vitin 2013 evidentohet se ka qenë nivelin më i ulët i furnizimit të tregut me para të gatshme (cash) nga BQK. Nëse do ta krahasojmë me vitin 2017 ku kemi pathuajse një dyfishim të parave të gatshme në qarkullim. Gjithashtu nga analizat e bëra në këtë pjesë të punimit, zbulohet se viti 2013 ka pasë ritmin më të lartë të akumulimit të depozitave nga bankat tregtare, por edhe normave motivuese të interesit të depozitave si edhe mos nisjen e politikës së bankave për kufizimin e shtrirjes gjeografike të tyre me njësi/degë në të gjithë territorin e Kosovës, etj.

Megjithëse akumulimi i depozitave të bankave tregtare në Kosovë ka tendencë rritëse, norma e rritjes së tyre ka trend rënës, kështu që niveli aktual i depozitave është i

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRIJTEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRIJTJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

pamjaftueshëm për të mbështetur një rritje ekonomike më të madhe se ajo aktuale. Gjithashtu, struktura e depozitave zbulon se në fund të vitit 2017 evidentohet që depozitat pa afat përbëjnë 60.3 përqind të totalit të depozitave, ndërkohë që raporti kredi/depozita është 77.23%. Kjo kërkon vëmendje për ndërtimin e strategjive të duhura dhe testimin e stress testeve bazuar në skenarë të mundshëm për ti paraprirë situatave të mundshme të tërheqjeve të shpejta të depozitave pa afat nga depozituesit dhe si rrjedhim humbje të normës së likuiditetit dhe frikë për faliment për shkak të panikut që shoqëron mungesën e likuiditetit.

Kjo pjesë e këtij punimi studimor gjithashtu zbulon disa fakte rreth bankave tregtare në Kosovë si përqendrimi i tyre në qytete dhe disa zona urbane si dhe kushtet makroekonomike kanë rezultuar në normë negative të interesit real ndaj depozitave duke ulur motivimin e depozituesve dhe atyre potencial për të rritur volumnin e kursimeve dhe depozituar në bankat tregtare të Kosovës dhe si rrjedhim kjo reflektohet në financim më të reduktuar të ekonomisë.

4.4. Analiza e Intervistave

Për të kuptuar rolin e bankave në akumulimin e burimeve financiare në vend, studiuesi ka përdorur intervista të pastrukturuara me punonjës kryesorë të bankave tregtare për të fituar një pasqyrë më të madhe në gjetjet që nxjerrin nga analiza e të dhënave. Zyrtarët e bankave u zgjodhën nga qendra (Drejtoria e Përgjithshme) e çdo banke për shkak se ata kanë informacion rreth çështjeve të përgjithshme të bankës dhe kanë njohuri për rolin e bankave të tyre në zhvillimin ekonomik të vendit si dhe strategjitë dhe planet e biznesit të drejtimit të lartë të bankës. Intervistat janë kryer përmes kontaktit personal me të intervistuarin e

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RITJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RITJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

secilës bankë në zyrën e tij / saj. Pyetjet e intervistës u hartuan duke u bazuar në objektivin për të gjetur rolin e bankave në akumulimin e burimeve të brendshme financiare, sfidat me të cilat përballen bankat dhe gjithashtu rekomandimet e tyre.

4.4.1. Rezultatet e intervistave

Sipas rezultateve të intervistave, gjetjet kryesore janë të përmbledhura në vijim:

1. Të gjitha bankat e intervistuar shprehin lidhjen e drejtëpërdrejtë që ekziston mes rritjes së akumulimit të kursimeve vendase në depozita si të vetmen mënyrë të shëndetshme për rritjen e investimeve prej tyre në ekonominë e Kosovës dhe efektin në gjenerimin e rritjes ekonomike të qëndrueshme në vend. Gjatë intervistave u mundësua të evidentohen edhe disa sfida nga bankat lidhur me rritjen depozitave dhe ato janë konkurrenca, normat e ulëta të interest të depozitave, ekspansioni i shërbimeve, dizenjimi i produkteve të reja sipas nevojave të depozituesve potencialë, zgjerimi i rrjetit bankar. Ndërsa për shtetin shprehin disa sfida si qëndrueshmërinë politike, konsolidim të treguesve makroekonomik dhe legjislacionit, politika dhe strategji për zhvillimin e sektorëve strategjik të vendit, të ndërmerren masa reformuese për ekonominë, shkollimi me teknologji informatike si nevojë ndaj aplikimit të shtuar të automatizmit kudo dhe në shërbimet bankare, mbështetja dhe mbulimi me internet dhe telekomunikacion cilësor dhe kosto të përballueshme të gjithë popullsisë dhe gjithë vendit me qëllim zhvillimin dhe përmirësimin e shërbimeve të lidhura me internet, të cilat besojnë nga të intervistuarit se ndihmojnë për të kënaqur klientët ekzistues të tyre, si dhe për të rritur tërheqjen e klientëve ndaj bankave, etj.

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRRITJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRRITJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

2. Të gjitha bankat e intervistuar shprehin se vëllimi i depozitave në Kosovë ka vijuar të rritet, e cila është rezultat i rritjes së besimit të depozituesve potencial në bankat e Kosovës dhe si e vetmja mundësi ku mund të investohen paratë në tregun financiar në Kosovë, por ritmi i rritjes nuk është ai që ka qenë para vitit 2013 si edhe evidentojnë një rritje më e madhe në depozitat e kursimit dhe jo depozitat me afat. Ndërkohë bankat shprehin se janë të interesuara për të përthithur depozita me afat mbi 1 vit.
3. Në 80% të intervistave të kryera, konstatohet se disa prej bankave kanë pasë normë rritje më të madhe të alokimit të depozitave se disa të tjera të cilat e kufizuan dukshëm rrjetin e bankar të tyre duke bërë që ti largohen depozituesve potencial por edhe klientëve dhe kjo u reflektua edhe në humbje të peshës që ato banka zinin në tregun e depozitave në Kosovë para vitit 2013. Kështu, mund të nënkuptojmë që të gjitha bankat tregtare që kujdesen për ruajtjen dhe zgjerimin e rrjetit bankar kanë ndikim pozitiv më të lartë në akumulimin e kërkuar të depozitave.
4. Të gjitha bankat e intervistuar janë shprehur për rëndësinë që ka nomra e interesit të depozitave për të rritur akumulimin e tyre, por të gjendur përballë objektivave të uljes së kostove me qëllim rritjen e fitimit, bankat për këto 5 vitet e fundit kanë aplikuar norma të ulëta interesi duke ndjekur edhe trendin e normave të interesit të depozitave të aplikuara nga bankat në vendet e BE-së, pavarësisht se zhvillimi ekonomik dhe oportunitetet e tregjeve financiare kanë ndryshime të mëdha.
5. Të gjitha bankat e intervistuar shprehin se Kosova ka qarkullim të lartë të parasë fizike (cash) dhe kjo sjell ulje të potencialit të rritjes ekonomike të vendit. Ndër arsytet e nivelit të lartë të qarkullimit të parasë fizike në Kosovë, bankat kryesisht u shprehën për

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RITJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RITJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

mungesë të vëmendjes së shtetit në trajtimin e këtij fenomeni. Ndërsa 20 % e tyre shprehën edhe mungesën e ofrimit të produkteve të përshtatshme bankare prej tyre në drejtim të klientëve që të përthithin dhe qarkullojnë parate cash brenda sistemit bankar. Bankat shprehën edhe sfida që duhet të përballen për reduktimin e këtij fenomeni dhe të tilla u cituan se bankat duhet të ofrojnë produkte alternative për segmente të caktuara që nga llojet e depozitave deri tek kutit e ruajtjes fizike të parave, norma më atraktive të interesit të depozitave, të zhvillojnë sistemin e IT-së, të ofrojnë senzibilizim /marketing më të madh dhe shtrirje më të gjerë të rrjetit bankar. Ndërsa shteti duhet të kujdeset të respektohet legjislacioni në fuqi, të luftoj ekonominë informale, të rritet shumat e siguruar, të krijojë infrastrukturën e nevojshme ligjore për qarkullimin e transaksioneve nëpërmjet sistemit bankar dhe të incentivojë teknologjinë informative, e sidomos e-bankingun, etj.

6. Të gjitha bankat e intervistuar shprehin se miratimi i Ligjit për Sigurimin e Depozitave ndikoi pozitivisht në rritjen e besimit të depozituesve potencial duke ju shtuar sigurinë kryesisht depozituesve me shumat të vogla të cilët njdejnë një siguri shtesë kur mendojnë se është edhe një organ tjetër që ndikon në ruajtjen e depozitave të tyre (aktualisht shumat e siguruar është deri në 5,000.00€).
7. 90% e të intervistuarve u shprehën se do të vijojë rritja e akumulimit të depozitave në Kosovë dhe kjo bazohet në stabilitetin të tregut bankar evidentuar kjo edhe nga treguesi i ulët i kredive me probleme dhe raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit të bankave, kuadri ligjor dhe rregullator i përmirësuar në mbrojtje të interesave të depozituesve. Por nga bankat evidentuan edhe sfida për të gjeneruar rritje të depozitave të tilla si vijimi i

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RITJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RITJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

aplikimit të normave aktuale të interesit në depozita të cilat janë të uëlta, aplikimi i një marzhi të lartë për normat e interesit të kredive (pavarsisht se është në tendencë rënie prej disa vitesh) sjell ulje të kërkesës për qarkullimin e kapitalit financiar. Mos ofrimi i skemave të garancisë së kolateraleve për biznese dhe individë në pamundësi të tyre por me potencial zhvillimi të ekonomisë së Kosovës. Rritja e ofertës monetare përmes kreditimit sjell edhe rritje të depozitave dhe vijimin e rritjes së investimeve.

8. Të gjitha bankat e intervistuar shprehen pozitivisht për rolin e remitançave në ekonominë e Kosovës duke e konsideruar se ato ndikojnë në rritjen e potencialit financiar, mundësive për investime, etj. Pavarsisht se vëllimi i remitançave ka vijuar në rritje përgjatë gjithë viteve historit të shtetit të Kosovës, vetëm 70% e të intervistuarve shprehën se do të vijoje rritja e remitançave me të njëjtin trend, duke e bazuar këtë në sigurinë që diaspora ka në stabilitetin e sistemit financiar të Kosovës, forcimin e infrastrukturës ligjore dhe promovimi i investimeve në vend. Bankat evidentuan edhe sfida për rritjen e remitançave të tilla si: mungesa e kushteve të nevojshme të stimulimit të investimeve nga diaspora e Kosovës, mungesë e sigurisë së nevojshme juridike, përcaktimi i fushave për investime strategjike, etj.
9. Të gjitha bankat e intervistuar kanë oreks në rritjen e vëllimit të kreditimit në Kosovë pasi ky është një aktivitet më kthim të lartë edhe për shkak të marzhit të konsiderueshëm që aplikohet mbi normën mesatare të interesit të depozitave, pavarsisht se përgjatë viteve të fundit evidentohet edhe një tendencë rënëse e këtij marzhi, por kjo kërkon rritjen e depozitave për të mundësuar pasjen e fondeve për financim. Duke

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRIJTEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRIJTJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

respektuar kështu edhe kërkesën për normën e likujditetit sipas kuadrit rregullator të BQK.

10. Asnjë prej bankave nuk shprehu nëse kishte kufizime të brendshme, nga banka mëm apo aksionerët për financimin e projekteve zhvillimore me norma të ulëta të kthimit të investimit në periudha afatgjata, por me impakt në rritjen ekonomike afatgjatë të Kosovës, por fakti është se ato janë më tepër të përqëndruara në financimin e bizneseve të sektorit të tregëtisë sesa ato të industrisë prodhuese dhe infrastrukturës.
11. Lidhur me diskutimin gjatë intervistave për segmentet e kosovarëve të papërfshirë apo përjashtuar financiarisht, të gjitha bankat u shprehën për ekzistencën e tyre në Kosovë duke i evidentuar ato si çdo individ ose biznes i cili nuk është në përputhje me rregullat e bankës dhe legjislacionin në fuqi është i përjashtuar, çdo individ ose biznes i cili ka thyer rregullat e bankës dhe legjislacionin në fuqi është i përjashtuar. Këtë çështje bankat e trajtuan vetëm duke u fokusuar në përgjegjësinë e individëve apo bizneseve për tu përfshirë financiarisht apo për të mos u përjashtuar dhe jo në aspektin çfarë ato duhet të bëjnë më tepër për rritjen e përfshirjes financiare, megjithatë gjatë intervistave pati edhe opinione mbështetëse për një strategji të udhëhequr nga shteti i Kosovës për rritjen e përfshirjes financiare si një domosdoshmëri për një ekonomi të qëndrueshme.
12. Interesante ishin përgjigjet gjatë intervistave lidhur me çështjen nëse në Kosovë do të ushtronte veprimtarinë një bankë me kapital shtetëror, dhe si do të ndikonte ajo në tregun bankar dhe rritjen e qëndrueshme të ekonomisë së Kosovës. Të gjithë të intervistuarit shprehën se e konsideronin pozitive ushtrimin e veprimtarisë nga një bankë tregtare me kapital shtetëror duke e bazuar në disa arsye: rritje të besimit akoma

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRIJTEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRIJTJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

më shumë në sistemin bankar si dhe ndikim në rritjen e akumulimit të kursimeve, për shkak të kapitalit dhe një lloj balancimi të pjesëmarrjes në kapital do të ketë mbështetje të investimeve strategjike në Kosovë, rritje të konkurrencës, kontribues në sistemin bankar.

13. Lidhur me diskutimin nëse Kosova do të kishte monedhën e saj, a do të kishte rritje më të madhe ekonomike. Përgjigjet prej të gjitha bankave ishin mohuese duke dhënë disa arsye që rreziqet që i duhet të përballët ekonomia e Kosovës e cila ka ende tregues të brishtë makroekonomik dhe ekonomi të pakonsoliduar për të pasë një monedhë të qëndrueshme dhe konkurruese në tregjet financiare si rrjedhim do të ekspozohet ndaj rrisqeve të cilat do të vendosnin nën presion stabilitetin financiar të vendit.
14. Të gjitha bankat e intervistuar shprehën se Kosova është vend tërheqës për bankat të bëjnë biznes duke dhënë disa arsye si sistemi bankar ka treguar qëndrueshmëri relativisht të mirë, fitimi i bankave ka shënuar ngritje të vazhdueshme dhe të gjitha bankat arrijnë të përmbyllin bilancin me fitim, dividendi është i patatueshëm, normat e interesit për kredi janë të larta, sistemi bankar i bazuar në rregulla dhe i konkurrueshëm, norma e borgjeve të këqija shumë e ulët.

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RITJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RITJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

4.4.2. Përfundime

Kjo pjesë e këtij punimi zbulon se të gjitha bankat e intervistuar shprehin lidhjen e drejtëpërdrejtë që ekziston mes rritjes së akumulimit të kursimeve vendase në depozita si të vetmen mënyrë të shëndetshme për rritjen e investimeve prej tyre në ekonominë e Kosovës dhe efektin në gjenerimin e rritjes ekonomike të qëndrueshme në vend. Gjithashtu zbulohen disa sfida rreth bankave tregtare në Kosovë si dizajni i produkteve dhe shërbimet e tyre janë pa u bazuar në analiza dhe strategji zhvillimi por thjesht ecuri formale për një treg të pazhvilluar si dhe aplikimi i normave shumë të ulëta të interesit për depozitat dhe normave të larta të interesit për kreditë. Nevojitet ekspansioni i shërbimeve dhe zgjerimi i rrjetit bankar. Pavarisht përgjegjësi të shtetit të Kosovës, tregues i një efektiviteti të ulët të sistemit bankar në Kosovë për akumulimin e kursimeve duket edhe përmes sasisë së madhe të parave fizike në qarkullim. Kjo pjesë e punës vlerëson ecurinë e bankave tregtare në Kosovë të cilat kanë tregues të mirë të shëndetit të tyre financiar si dhe reflektojnë një besim të shtuar të klientëve ndaj veprimtarisë së tyre, por evidentohen edhe sfidat që hasin dhe mënyrat e përmirësimit të performancës së ardhshme të tilla si nevoja për të ripërcaktuar objektivat e tyre të produktit, shtrirjen e fushëveprimit të tyre për të përfshirë financiarisht gjithë segmentet e popullsisë dhe bizneseve, si dhe të sigurohet përmirësim në operacionet e tyre, etj.

Ndërsa, për shtetin zbulohen disa sfida si qëndrueshmëria politike, konsolidim të treguesve makroekonomik dhe legjislacionit, politika dhe strategji për zhvillimin e sektorëve strategjik të vendit, të ndërmerren masa reformuese për ekonominë, mungesa e kushteve të nevojshme të stimulimit të investimeve nga diaspora e Kosovës, përcaktimi i fushave për

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RITJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RITJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

investime strategjike, të luftojë ekonominë informale, të rritet shuma e siguruar, të krijojë infrastrukturën e nevojshme ligjore për qarkullimin e transaksioneve financiare vetëm nëpërmjet sistemit bankar, të mbështesë dhe incentivojë edukimin me teknologji informatike si nevojë ndaj aplikimit të shtuar të automatizmit kudo por edhe në shërbimet bankare, mbështetja dhe mbulimi me internet dhe telekomunikacion cilësor dhe kosto të përballueshme të gjithë popullsisë dhe gjithë vendit me qëllim zhvillimin dhe përmirësimin e veprimtarive të lidhura me internet.

Gjithësesi është shumë pozitive që efekti i rritjes së akumulimit të kursimeve nga bankat tregtare në ekonominë e vendit duket i pranuar nga hartuesit e politikave të vendit. Kjo mundëson që Qeveria të planifikoj të ndërmarrë disa nisma për rritjen e normës së kursimit të brendshëm në mënyrë që Kosova të rrisë ritmin aktual të zhvillimit ekonomik të vendit.

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RITJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RITJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

4.5. Përfundime

Nga përmbledhja e analizës së këtij kapitulli në këtë studim është zbuluar se sektori bankar zë një pozitë vitale në ekonomi dhe kështu aktivitetet e saj duhet të mbeten nën shqyrtim të vazhdueshëm dhe në qendër të vëmendjes analitike. Sistemi bankar luan një rol të rëndësishëm në sektorin financiar dhe demonstroi një marrëdhënie pozitive me rritjen ekonomike të Kosovës. Studimi hulumton kontributet e sektorit bankar në rritjen ekonomike të Kosovës.

Të dhënat e përdorura në studim u mbledhën për depozitat nga periudha 2010 deri në 2017 të 10 bankave tregtare në Kosovë. U përdor testi rrënjësor i Dickey Fuller (ADF) dhe Philip Perron, testimi i zakonshëm i shkallës më të vogël dhe Granger. Testi i rrënjës së njësisë konfirmon qënien stacionare të të gjithë variablave në ndryshimin e parë. Rezultatet e regresionit tregojnë se depozitat kanë një ndikim të rëndësishëm pozitiv në rritjen ekonomike të Kosovës. Testi Granger-Causality konfirmon marrëdhënien shkakësore të depozitave dhe përfitimit me rritjen ekonomike. Pra, vërtetohet hipoteza H_0 e ngritur për këtë studim se rritja e akumulimit të kursimeve të kosovarëve nga bankat tregtare kanë efekt pozitiv në rritjen e qëndrueshme ekonomike të Kosovës. Rezultatet e regresionit tregojnë se depozitat, kanë një ndikim të rëndësishëm pozitiv në rritjen ekonomike të Kosovës. Në anën tjetër tregon marrëdhënien unidirektale të investimeve dhe fitimet e interesit me rritjen ekonomike të investimeve dhe të ardhurave nga interesi drejt rritjes ekonomike.

Është shumë pozitive që efekti i rritjes së akumulimit të kursimeve nga bankat tregtare në ekonominë e vendit duket i pranuar nga të gjithë drejtuesit e lartë të bankave tregtare dhe

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RITJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RITJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

hartuesit e politikave në Kosovë. Kjo mundëson që Qeveria dhe bankat tregtare të planifikojnë dhe të ndërmarrin strategji dhe nisma për rritjen e normës së kursimit të brendshëm në mënyrë që Kosova të rrisë ritmin aktual të zhvillimit ekonomik të vendit.

Arritjet e sektorit bankar të Kosovës të vërejtura në këtë disertacion mund t'i atribuohen bashkëpunimit dhe angazhimit të qëllimit midis palëve kyçe të interesit. Studimi vërejtë se objektivi themelor i çdo politikëbërësi në Kosovë duhet të jetë bërja e politikave për të zhvilluar dhe përmirësuar sektorin bankar në Kosovë me qëllim për të kryer akoma më mirë veprimtaritë e tyre kryesore në mënyrë që të ndikojnë pozitivisht në rritjen ekonomike të Kosovës për shkak se sektori bankar vërtetohet se ka kontribuar ndjeshëm dhe ka rol kyç në mundësimin e një rritje ekonomike më të lartë të Kosovës përmes aktivitetit të tyre të akumulimit të depozitave dhe investimit të tyre si kapital financiar në ekonominë e Kosovës për periudhën e analizuar nga viti 2010-2017.

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RITJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RITJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

KAPITULLI V: KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

5.1 Hyrje

Kapitulli i mësipërm u mor me analizën e të dhënave nga burimet sekondare dhe ato primare, diskutimin dhe zbulimin e tyre të trajtuar në disa pjesë të tij si:

- ❖ trajtimi empirik për vërtetimin e hipotezës së ngritur për lidhjen mes rritjes së akumulimit të kursimeve nga bankat tregtare dhe rritjes ekonomike të Kosovës;
- ❖ analizën dhe trajtimin e gjetjeve për evidentimin e konkluzioneve dhe rekomandimeve bazuar në të dhënat e grumbulluara nga pasqyrat dhe raportet financiare të bankave tregtare, raporteve të Bankës Qëndrore të Kosovës dhe burimeve të tjera sekondare me të dhëna rreth performancës së përgjithshme të bankave tregtare të Kosovës për akumulimin e kursimeve në depozita dhe mbështetjen me investime që ato kanë bërë për zhvillimin e ekonomisë së Kosovës;
- ❖ analizën dhe trajtimin e gjetjeve për evidentimin e konkluzioneve dhe rekomandimeve bazuar në të dhënat e grumbulluara nga përgjigjet e marra gjatë intervistave me drejtues të lartë të bankave tregtare në Kosovë.

Në këtë kapitull do të zbulojmë gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet kryesore të këtij studimi. Një sistem bankar i qëndrueshëm dhe efikas është truri i ekonomisë. Bankat tregtare ofrojnë një mekanizëm institucional nëpërmjet të cilit burimet mund të

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RITJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RITJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

mobilizohen dhe drejtohen nga përdorime më pak të domosdoshme për investime më produktive.

Kosova si çdo shtet tjetër në botë përpiqet për zhvillimin e ekonomisë së saj dhe zvogëlimin e varfërisë. Investimi financiar është forca lëvizëse për të sjellë rritje të shpejtë dhe të qëndrueshme ekonomike për një vend. Burimet financiare që duhet të përdoren në lehtësimin e aktiviteteve të investimit fitohen nëpërmjet akumulimit të pasurisë gjatë një periudhe të caktuar kohe në formën e kursimeve në depozita pranë bankave tregtare. Në këtë drejtim, bankat tregtare në Kosovë ku nuk egziston tregu i kapitalit, luajnë një rol shumë të rëndësishme dhe të pazëvendësueshëm për ndërmjetësimin financiar në akumulimin e burimeve financiare vendase nga ata që dëshirojnë të kursejnë përmes investimit të kursimeve të tyre në depozita pranë bankave tregtare për ata që dëshirojnë të investojnë në blerje pasurish apo bërje biznesi përmes marrjes së kredive nga bankat tregtare të Kosovës.

Duke pasur banka tregtare të zhvilluar, të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm financiarisht, me qeverisje të mirë korporative dhe me strategji biznesi të qarta dhe ambicioze për rritjen e tyre në treg përmes produkteve dhe shërbimeve të dedikuara për segmente të ndryshme të konsumatorëve potencial , vlerësohet se këto banka tregtare do të nxitin një rritje të qëndrueshme ekonomike dhe zvogëlim të varfërisë së vendit. Natyrisht , marrëdhënia është reciproke dhe tregon se një ekonomi me tregues makroekonomik të qëndrueshëm është e nevojshme për një zhvillim të qëndrueshëm edhe të vetë sistemit bankar.

Akumulimi i depozitave në bazë të një sistemi financiar konkurrues dhe mirëfunksionues është funksioni më i rëndësishëm i bankave tregtare pasi nga funksionimi i suksesshëm i

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RITJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RITJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

bankave tregtare varet shpërndarja e fondeve të akumuluarra për investimin e tyre në mënyrë produktive për ekonominë e Kosovës.

Kosova si çdo vend tjetër në zhvillim në botë ka nevojë për një sistem bankar që rrit akumulimin e kursimeve në depozita bankare dhe siguron investime në mënyrë efikase për industrializimin e Kosovës dhe financim të sektorëve të ekonomisë të cilat do të sjellin angazhimin e gjithë faktorëve të prodhimit të Kosovës dhe rritjen e kapaciteteve prodhuese të Kosovës.

5.2. Konkluzionet kryesore

1. Vërtetohet hipoteza H_0 e ngritur për këtë studim se rritja e akumulimit të kursimeve të kosovarëve nga bankat tregtare kanë efekt pozitiv në rritjen e qëndrueshme ekonomike të Kosovës.
2. Rezultatet e regresionit tregojnë se depozitat, kanë një ndikim të rëndësishëm pozitiv në rritjen ekonomike të Kosovës. Gjithashtu, së bashku me depozitat dhe remitancat si edhe kreditë janë faktorë që vënë në lëvizje ekonominë e Kosovës nëpërmjet ndikimit të tyre të drejtpërdrejtë në investime.
3. Testi Granger-Causality konfirmon marrëdhënien shkakësore të depozitave, përparimeve dhe përfitimit me rritjen ekonomike. Në anën tjetër tregon marrëdhënien unidirektale të investimeve dhe fitimet e interesit me rritjen ekonomike të investimeve dhe të ardhurave nga interesi drejt rritjes ekonomike. Ai rekomandon që politikëbërësit duhet të bëjnë politika për të përmirësuar sektorin bankar në Kosovë, për shkak se sektori bankar është duke kontribuar ndjeshëm në rritjen ekonomike të Kosovës.

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRIJTJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRIJTJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

4. Nga analizat e bëra në këtë pjesë të punimit, zbulohet se viti 2013 ka pasë ritmin më të lartë të akumulimit të depozitave nga bankat tregtare, por edhe normave motivuese të interesit të depozitave, ndërsa vitet që pasuan kanë rezultuar në normë negative të interesit real ndaj depozitave duke ulur motivimin e depozituesve por edhe atyre potencial për të rritur volumin e depozitave, gjithashtu deri në këtë vit nuk kish nisë ende politika e bankave për kufizimin e shtrirjes gjeografike të tyre me njësi/degë në të gjithë territorin e Kosovës, etj. Në vitin 2013 evidentohet se ka qenë nivelin më i ulët i furnizimit të tregut me para të gatshme (cash) nga BQK, ndërsa nëse do ta krahasojmë me vitin 2017 kemi pathuajse një dyfishim të parave të gatshme në qarkullim. Gjithashtu, struktura e depozitave zbulon se në fund të vitit 2017 evidentohet që depozitat pa afat përbëjnë 60.3 përqind të totalit të depozitave, ndërkohë që raporti kredi/depozita është 77.23%. Në vijim të kësaj analize evidentohet edhe rritja e konsiderueshme e të ardhurave të bankave nga komisionet dhe shërbimet për klientët. Të gjitha këto kanë demotivuar kosovarët të përdorin bankat dhe терминаlet e tyre për depozitim të parave dhe kryerjen e pagesave dhe shlyerjen e detyrimeve përmes sistemit bankar, por i kanë nxitur ata të përdorin parane “cash” si mënyrë pagese, duke sjellë kështu kosto për BQK, bankat tregtare dhe kufizim të rritjes ekonomike të Kosovës, përveçse rritjes së kriminalitetit dhe çështjeve sociale. Të gjitha këto janë tregues i një efektiviteti të ulët të sistemit bankar në Kosovë për akumulimin e kursimeve duket edhe përmes sasisë së madhe të parave fizike në qarkullim. Këto kërkojnë vëmendje për ndërtimin e strategjive të duhura dhe testimin e stress testeve bazuar në skenarë të mundshëm për ti paraprirë situatave të mundshme të tërheqjeve të

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RITJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RITJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

shpejta të depozitave pa afat nga depozituesit dhe si rrjedhim humbje të normës së likuiditetit dhe frikë për faliment për shkak të panikut që shoqëron mungesën e likuiditetit.

5. Kjo pjesë e këtij punimi studimor gjithashtu zbulon disa fakte rreth bankave tregtare në Kosovë si përqendrimi i tyre në qytete dhe disa zona urbane si dhe kushtet makroekonomike kanë rezultuar në normë negative të interesit real ndaj depozitave duke ulur motivimin e depozituesve dhe atyre potencial për të rritur volumin e kursimeve dhe depozituar në bankat tregtare të Kosovës dhe si rrjedhim kjo reflektohet në financim më të reduktuar të ekonomisë.
6. Nga ky studim zbulohet se të gjitha bankat e intervistuar shprehin lidhjen e drejtëpërdrejtë që ekziston mes rritjes së akumulimit të kursimeve vendase në depozita si të vetmen mënyrë të shëndetshme për rritjen e investimeve prej tyre në ekonominë e Kosovës dhe efektin në gjenerimin e rritjes ekonomike të qëndrueshme në vend; Një nga funksionet më të rëndësishme të bankave tregtare në Kosovë është ndërmjetësimi financiar; duke mobilizuar depozita nga ata që kanë furnizim të tepërt dhe duke u dhënë atyre me kërkesa për fonde. Në kërkimin e tyre për të përmbushur këto objektiva bankat tregtare identifikojnë mjete të ndryshme për të lehtësuar operacionet e tyre. Bankat tregtare në Kosovë përmes produkteve të tyre të ndryshme janë përpjekur për të rritur akumulimin e depozitave por ende jo mjaftueshëm. Mekanizmi gjithmonë ka qenë vetëm dizajnimi dhe reklamimi tradicional i produkteve. Por, këto produkte duhet të jenë të dizajnuara për t'u fokusuar tek konsumatorët. Në të vërtetë, ato duhet të jenë të dizajnuara për të synuar klientët e tyre potencial korporata, biznese të vogla dhe të

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRITJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRITJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

mesme, dhe sidomos familjet kosovare kudo që jetojnë në botë përmes depozitave të transferueshme, depozitave të kursimit dhe depozitave me afat;

7. Vlerësohet ecuria e bankave tregtare në Kosovë të cilat prej shumë vitesh vazhdojnë të kenë treguesin më të ulët në rajon për kreditë NPL;
8. Për shtetin e Kosovës evidentohen nevoja për qëndrueshmëri politike; konsolidim të treguesve makroekonomik dhe legjislacionit; mos pasja e politikave , strategjive dhe përcaktimi i fushave për investime dhe zhvillimin e sektorëve strategjik të Kosovës, mungesa e kushteve të nevojshme të stimulimit të investimeve nga diaspora e Kosovës; mungesë e efektivitetit të luftës së shtetit ndaj ekonomisë informale; mungesë të krijimit të infrastrukturës së nevojshme ligjore për qarkullimin e transaksioneve financiare vetëm nëpërmjet sistemit bankar; mungesë e mbështetjes dhe incentivave për edukimin me teknologji informatike si nevojë ndaj aplikimit të shtuar të automatizmit kudo por edhe në shërbimet bankare; si edhe mungesë të strategjisë dhe mbështetjes së edukimit dhe përfshirjes financiare për Kosovën;

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRIJTEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRIJTJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

5.3. Rekomandimet kryesore

Rekomandimet kryesor të studimit janë paraqitur si më poshtë:

- ✓ Qeveria e Kosovës, e ka të domosdoshme të mbështesin rritjen më të lartë ekonomike të vendit. Kjo kërkon hartimin e një plani afatgjatë veprimi i cili të shtrijë efektin përtej afatit 5 vjeçar. Planin për zhvillimin ekonomik të Kosovës duhet të konsiderojë mbështetje të lartë financiare nga burimet vendase të akumuluar dhe rishpërndara nga bankat tregtare të Kosovës, por qeveria duhet të marrë disa masa inkurajuese për mbështetjen dhe mbikëqyrjen e bankave tregtare, por edhe të ndërmjetësve të tjerë financiar të cilët duhet të marrin rol më aktiv në funksion të akumulimit të kursimeve në Kosovë.
- ✓ Rezultati i studimit tregon se, sa i përket akumulimit të depozitave të brendshme, industria bankare Kosovare është e dominuar nga 3BMT. Konkurrenca e moderuar është e rëndësishme për industrinë bankare dhe për ekonominë, kështu që bankat e tjera tregtare duhet të jenë më konkurruese sa i përket rolit të tyre aktiv në ekonomi nëpërmjet akumulimit të burimeve financiare të kërkuara duke i dhënë theks të veçantë; zgjerimit të rrjetit bankar, studimit të nevojave të tregut dhe zhvillimin e strategjive të përshtatura për çdo target grup dhe pastaj zhvillimin produkteve të reja në përputhje me nevojat dhe zhvillimet strategjike të vendit, investimeve në teknologji, rritje të kapaciteteteve të stafëve të bankave sepse kështu përcjellin më tëpër besim dhe këshillim profesional brenda kuadrit etik të bankierit.
- ✓ Kosova në mënyrë të pashmangshme duhet të ketë investime në sektorin e prodhimit, bujqësisë, në projektet kryesore zhvillimore drejt industrializimit të Kosovës pasi

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RITJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RITJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

kështu krijohet zhvillim i gjerë i vendit në mënyrë që të krijojnë një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. Këto investime zakonisht vijnë përmes investimit të bankave tregtare të cilat akumulojnë fonde përmes akumulimit të depozitave, kështu që qeveria duhet t'i kushtojë vëmendje rritjes së akumulimit të kursimeve dhe investimit në këta sektorë, qoftë edhe përmes licencimit të PTK-së si bankë për kryerjen e veprimtarisë së akumulimit të depozitave dhe investimit të tyre në sektorët prioritarë të Kosovës me qëllim që të transformojë ekonominë e Kosovës drejt industrializimit të saj. Pra, shteti i Kosovës përmes PTK – së apo krijimit nga fillimi mund të mbështesë idenë e një banke me kapital shtetëror , si një shtyllë për të krijuar një konkurrencë të shëndetshme për rritjen e akumulimit të kursimeve dhe investimeve në mënyrë që të përdoret si bazë për të financuar projekte zhëllimore në Kosovë për të siguruar një rritje më të madhe ekonomike si edhe duke investuar në ato sektorë dhe segmente të cilat sjellin industrializimin e Kosovës por që vazhdojnë ende të mos marrin vëmendjen e bankave tregtare private ekzistuese në Kosovë.

- ✓ Duhet bërë përpjekje për të ulur diferencën mes normave të interesit të depozitave dhe normave të interesit të kredive të cilat si rrjedhim bëjnë që kreditë për kapital investues të jenë më të shtrenjta dhe njëkohësisht nxitin inflacionin. Bankat duhet të angazhohen në mënyrë të ndërgjegjshme në huadhënien për sektorët që sjellin zhvillim, me qëllim të promovimit të rritjes ekonomike dhe jo vetëm fitimit. Kreditimi i sektorëve me prioritet mund të mos jetë aq fitimprurës sa kreditimi i subjekteve që merren me tregëti. Gjithashtu, kreditimi i këtyre të fundit me norma interesi shumë të larta do të ushqejë inflacionin dhe dobëson ndikimin pozitiv në rritjen ekonomike.

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRIJTJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRIJTJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

- Autoritetet duhet të ndryshojnë kuadrin ligjor dhe rregullator për mbrojtjen e konsumatorit dhe mirë qeverisjen korporative për bankat tregtare të Kosovës duke iu afruar direktivave të BE-së, parimeve të OECD-së dhe BASEL , si edhe praktikave më të mira nga vendet e zhvilluara për të mundësuar konkurrencën e pastër , reduktim të përqëndrimit , qasjen në financa për segmentet e pa mbuluara, shërbime financiare cilësore, transparencën mbi termat dhe kushtet e produkteve financiare, informimin e klientëve të tyre dhe atyre potencial në një kuptim dhe mënyrë të qëndrueshme të komunikimit;
- Zvogëlimi në zero i pagesave bankare përmes internetit apo digital banking , komisionet për pagesa me karta bankare në POS (Point of Sales) , komisionet për marrjen e informacionit dhe mbajtjen e një llogarie bankare, të cilat janë rritur ndjeshëm nga bankat tregtare në Kosovë gjatë këtyre viteve të fundit;
- Subvencionim të skemës së akumulimit të depozitave nga Diaspora e Kosovës të iniciuara me bankat tregtare që janë pjesë e grupeve bankare me shtrirje ndërkombëtare dhe kryesisht aty ku ka më shumë prezencë të kosovarëve. Subvencionimi nga Qeveria e Kosovës mund të konsistojë në marrëveshje të negociuar me bankat tregtare për të mbuluar koston e transferimit të shumave të depozitave përmes sistemit SWIFT;
- Emetim të Obligacioneve për Diasporën nga Qeveria e Kosovës - Në një përpjekje për të tërhequr kursimet dhe për të financuar projekte zhvëllimore të Kosovës , qeveria e Kosovës mund të lëshojë / emetojë Obligacione për Diasporën. Qëllimi i

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RITJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RITJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

Obligacioneve të Diasporës është rritja e kursimeve në vend dhe financimi i projekteve specifike me afat të gjatë por me impact për zhvillimin ekonomik të Kosovës ;

- Subvencionim të skemës së kursimeve për banesa¹⁸ dhe shkollimin në Universitete. Skema synon të inkurajojë individët me të ardhura të ulëta dhe të mesme për të depozituar para për një periudhë të caktuar kohore , për të përmbushur disa qëllime si Blerjen e një banese ose pagesën për shkollim në të ardhmen; Rritjen e kursimeve të akumuluar në bankat tregtare dhe për më tepër të llojit të depozitave me afat të gjatë; Kreditim të tyre nga bankat tregtare duke rritur kështu ofertën monetare dhe përfitim të palëve të përfshira në biznes; si edhe Rritjen e përfshirjes financiare për segmente të cilat ngelen të papërfshirë financiarisht nëse nuk kanë iniciativa nga shteti apo bankat tregtare;

5.4. Rekomandim për studime të mëtejshme

Për studime të mëtejshme, rekomandojmë një studim për krijimin e një banke me kapital shtetëror në Kosovë; si edhe studim rreth diferencës së interesit mes normës së interesit të kredive dhe normës së interesit të depozitave; dhe nëse duhet të ketë kufij të përcaktuar në kuadrin rregullator të BQK – së për këtë diferencë dhe çfarë kontributi ato mund të japin për ekonominë e shtetit të Kosovës.

¹⁸ Skema mund të sigurojë dy opsione subvencionimi për depozituesin individ. Ato mund të jenë "5 % " ose "10 % " ose opsione të tjera në varësi të buxhetit që qeveria do të kontribojë për këto segmente individësh, por Kujdes pa rrezikuar rritjen e borxhit publik. Shembull: Për çdo 1000 Euro të depozituar nga individ, shteti do të subvencionojë "5 % " ose "10 % " që do të thotë 50 ose 100 Euro. Duke qenë depozitë me afat të gjatë, bankat do të aplikojnë norma interesi më të larta. Kjo skemë motivon individët të kursejnë për blerjen e banesës së tyre. Në rast se individ do të kërkojë të tërheq shumën e depozituar pa e investuar në blerjen e banesës në Kosovë atëherë shuma e kontributit të dhënë nga shteti automatikisht nga banka i kthehet buxhetit të shtetit së bashku me interesat e përfituara për vitet e qëndrimit të kësaj shume në depozitën afatgjatë pranë bankës tregtare;

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRIJTJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRIJTJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

LISTA E REFERENCAVE / BIBLIOGRAFIA

1. Allen, Franklin, Asli Demirguc-Kunt, Leora Klapper and María Soledad Martínez Pería. 2012. "The Foundations of Financial Inclusion: Understanding Ownership and Use of Formal Accounts." Policy Research Working Paper 6290, World Bank, Washington, DC.
2. Anginer, Deniz, Asli Demirguc-Kunt, and Min Zhu. 2012. "How Does Bank Competition Affect Systemic Stability?" Policy Research Working Paper 5981, World Bank, Washington, DC. Bankable Frontier Associates. 2009.
3. Cargill Thomas and Naoyuki Yoshino, Postal Savings and Fiscal Investment in Japan, Oxford University Press, 2003.
4. Scher Mark and Naoyuki Yoshino, Small Savings Mobilization and Asian Economic Development, M.E.Sharpe. 2005
5. Financing Growth and Development in the Transition Economies: The Role of Domestic Savings. 2000. UN Economic Commission for Europe
6. Gilles Bérubé G., Côté D. "Long-Term Determinants of the Personal Savings Rate: Literature Review and Some Empirical Results for Canada." Working Paper 2000-3.
7. Banka Qëndrore e Kosovës, Raporti Vjetor 2017. (Qershori 2018)
8. IMF on Economic Growth of Kosovo. (2016)
9. Koskela E, Viren M., (1983) "A note on long-term determinants of the private savings ratio." Economic letter 11 91983) 107-113. North-Holland Publishing Company.
10. OECD Report to G20 Finance Ministers and Central Bank Governors. (September 2015)
11. Peter V., Raja Peter R., (2006) "Tax Finance and Savings: Conceptual Issues International Research." Journal of Finance and Economics ISSN 1450-2887 Issue 3 (2006) © EuroJournals Publishing, Inc. 2006. Pages 35-47
12. The Law on "Deposit Insurance" of the Kosovo Republic
13. Thirlwall A. (2002) "The Mobilization of Savings for Growth and Development in Developing Countries" Icfai University Journal of Applied Economics, 2002, vol. I, issue 1, pages 7-30.
14. Allesandra, D. C. (2010). "Finance Growth Nexus: Does Causality Withstand Liberalization? Evidence from Cointegrated VAR", Discussion Paper, No. 102,
15. Banca Prossima, Financial Budgeting and Risk Management Unit.
16. Arestis, P. and Demetriades, P. (1997). "Financial Development and Economic Growth: Assessing the Evidence", Economic Journal, 107.
17. Ayadi, R., Arbak, E., Ben-Naceur, S. and Pieter De Groen, P. (2013). Financial Development, Bank Efficiency and Economic Growth across the Mediterranean. MEDPRO Technical Report No. 30. March 2013

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRIJTJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRIJTJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

18. Balogun, E. D. (2007). "Economic Growth in a Cross Section of Countries," The Quarterly Journal of Economics, MIT Press, Vol. 106(2)
19. Christopoulos, D. K. and Tsionas, E. G. (2004). "Financial Development and Economic Growth: Evidence from Panel Unit Root and Cointegration Tests", Journal of Development Economics, 73, 51-65.
20. Deidda, L. and Fattouh, B. (2002). "Non-linearity Between Finance and Growth", Economic Letters, 74(3), 34-70.
21. Demetriades, P. O. and Hussein, K. A. (1996). Does Financial Development Causes Economic Growth? Time Series Evidence from 16 Countries, Journal of Development Economics, 51, 221-237.
22. Ekpeyong, D. B. and Acha, I. A. (2011). "Finance and Growth: Theory and New Evidence" Federal Reserve Board Discussion Paper No. 35.160 Middle Eastern Finance and Economics - Issue 8.
23. King, R. G. and Levine, R. (1993). "Finance and Growth: Schumpeter Might Be Right," The Quarterly Journal of Economics, 108(3), 717-737.
24. Levine, R. and Renelt, D. (1992). "A Sensitivity Analysis of Cross-Country Growth Regressions," American Economic Review, 82(4), 942-963.
25. Luintel, K. B. and Khan, M. (1999). "A Quantitative Reassessment of the Finance-Growth Nexus, Evidence from a multivariate VAR" Journal of Development Economics, 60, 453- 466.
26. Odeniran, S. O. and Udejaja, E. A. (2010). Economic and Financial Review, 48(3), 94-116.
27. Rousseau, P. L. and Sylla, R. (2001). "Financial Systems, Economic Growth and Globalization", NBER Working Paper, Vol. 8.
28. Rousseau, P. L. and Wachtel, P. (1998). "Financial Intermediation and Economic Performance: Historical Evidence from Five Industrialised Countries." Journal of Money, Credit and Banking, 30(4), 334-347.
29. Shan, Z. J., Morris, A.G., & Sun, F. (2001). "Financial Development and Economic Growth: An Egg-and-Chicken Problem?", Review of International Economics, 9(3) 2123-2141.
30. Tuuli, Koivu, (2002). "Do Efficient Banking industrys Accelerate Economic Growth in Transition Countries" (December 19, 2002). BOFIT Discussion Paper No. 14/2002.
31. Henderson, B.J. and N.D. Pearson (2009), The Dark side of financial Innovation, working paper, to be presented at EFA meetings in Bergen, Norway.
32. Ribaj, A, (2017). Tregjet financiare, risqet dhe etika.
33. Rajan, R.G. and L. Zingales (2001), Financial Systems, Industrial Structure, and Growth, Oxford Review of Economic Policy, Vol. 17, p. 467-482.
34. Boot, A.W.A., and Thakor, A.V. (1997a), Banking scope and financial innovation, Review of Financial Studies, Vol. 10, p. 1099-1131.

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRITJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRITJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

35. Allen, F. (1993), Stock Market and Resource Allocation, in C. Mayer and X. Vives, eds., Capital Markets and Financial Intermediation, Cambridge University Press, p. 81-108.
36. Carlin, W., and C. Mayer (2002), Finance, Investment and Growth, Journal of Financial Economics, Vol. 69, p. 191-226.
37. Agu, C. (1984). The role of Commercial Banks in mobilization and allocation of resources for development in Nigeria.
38. Abu, N. (2010). Saving-Economic growth nexus in Nigeria, 1970-2007: Granger Causality and Co-Integration Analysis. Review of Economic and Business studies, Vol.3, Issue 1, 93-104.
39. AbuAl-Foul, B. (2010). Causal Relation between Saving and Economic Growth: Some Evidence from MENA countries. MEEA Meeting.
40. Adebisi. (2005). Saving-Growth Relationship in Nigeria: An Empirical Evidence. African review of Money Finance and Banking, 159-178.
41. Aghion, P., Comin, D., Howitt, P., & Tecu, I. (2009). When does Economic Saving matter for Economic Growth? NBER working Paper.
42. Agrawal, P. (2001). The relation between Savings and Growth: Cointegration and Causality Evidence from Asia. Applied Economics, 33. 499-513.
43. Alguacil, M., Cuadros, A., & Orts, V. (2004). Does saving really matter for Growth?
44. Mexico (1970-2000). Journal of International Development, 281-290.
45. Andersson, B. (1999). On the Causality between saving and Growth: Long and Short Run Dynamics and Country Heterogeneity. Department of Economics, Uppsala University, Sweden.
46. Anoruo, E., & Ahmad, Y. (2001). Causal Relationship between Domestic Savings and Economic Growth: Evidence from Seven African Countries. Oxford: Blackwell Publisher.
47. Attanasio, O. L., & Scorcu, A. (2000). Saving, Growth and Investment: A Macroeconomic Analysis Using a Panel of Countries. Review of Economics and Statistics, 82(1).
48. Baafi, J. A. (2010). Ghana's Economic Growth Inperspective: A time series approach to convergence and determinants. Sodertorn University: Department of Economics.
49. Baharumshaha, A. Z., Thanooana, M. A., & Rashidb, S. (2002). Saving Dynamics in the Asian Countries. Department of Economics.
50. Bisat, A., El-Erian, M. A., & Helbling, T. (1997). Growth, Investment, and Saving in the Arab Economies. International Monetary Fund.
51. Budha, B. (2012). A multivariate analysis of savings, investment and growth in Nepal.
52. Munich Personal RePEc Archive.
53. Antwi, B. A.-G. (2015). Mobilizing deposits; the role of commercial banks.
54. Aurangzeb, D. (2012). Contribution of banking sector in Economic Growth of Kosovo.
55. Bairamli, N. (2010). The role of saving in the economic development of a country.

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRIJTJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRIJTJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

56. Bgistein and Soderbom. (2005). Credit Constraints in Manufacturing Enterprises in Africa. Oxford University.
57. Bhatia, R. (1978). Banking Structure and performance: A case study of the Indian System.
58. Bigstein and Soderbom. (2005). Credit Constraints in Manufacturing Enterprises in Africa. Oxford University.
59. Boyd and De Nicoló, (2005); the theory of Bank Risk Taking and Competition Revisited, the Journal of Finance.
60. C.Giedeman, D. (2005). Branch banking Restriction and Finance Constraints in Early Twentieth Century. The Journal of Economics History Vol.1, 129-151.
61. Coulpeper, R. (2008). Resource for Development: a critical review of commitments and achievements under the Monterrey consensus. UN-DESA G 77 Meeting, New York: The north south institute.
62. Carroll, C. D., & Weil, D. N. (1994). Saving and Growth: A reinterpretation. Rochester Conference Series on Public Policy, (pp. 40, 133-192)
63. Claus, I., Haugh, D., Scobie, G., & Tornquist, J. (2001). Saving and Growth in an Open Economy. Treasury Working Paper, 01/32.
64. Deaton, A. (1995). Growth and Saving: What do we know, what do we need to know and what might we learn? World Bank.
65. Demetriades, P., & Hussien, K. (1996). Does Financial Development cause Economic Growth: Time Series Evidence from 16 Countries. Journal of Development Economics, vol. 51, No.2, 387-411.
66. Geweke, J., Meese, R., & Dent, W. T. (1983). Comparing alternative tests of causality in temporal systems: Analytic results and experimental evidence. Journal of Econometrics, 21,161-94.
67. Granger, C. W. (1969). Investigating causal relations by econometric models and cross Spectral methods. Econometria, 37, 424-38.
68. Hundie, S. K. (2014). Savings, Investment and Economic Growth in Ethiopia: Evidence from ARDL approach to co-integration and TYDL Granger-Causality tests. Journal of Economics and International Finance.
69. Johansen, S. (1992). Testing Weak Exogeneity and Order of Cointegration in UK Money Demand Data. Journal of Policy Modeling, 14, 313-254.
70. Johansen, S., & Juselius, K. (1990). Maximum Likelihood Estimation and Inference on Co-Integration with Application to Demand for Money. Oxford Bulletin of Economics and Statistics, Vol. 52, 169-210.
71. Lasky, M. (2004). The Role of Saving in Economic Growth when the Cost of the New Human Capital Depends on the Cost of Labor. Congressional Budget Office. Washington DC.
72. Lean, H., & Song, Y. (2008). Domestic Saving and Economic Growth in China. Asian Business and Economics Research Unit.
73. Malthuse, R. (1951). Principles of Political Economies. New York.
74. Mankiw, G. D., Romer, D., & Weil, D. (1992). A contribution to the empirics of Economic Growth. The Quarterly Journal of Economics, 1992
75. Mankiw, G. N. (2012). Macroeconomics. Harvard University.
76. McKinnon, R. I. (1973). Money and Capital in Economic Development. Brookings Institution.

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRITJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRITJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

77. Mishkin, F. S. (1992). Is the Fisher Effect for Real? A reexamination of the relationship between inflation and interest rates. *Journal of Monetary Economics*.
78. Misztal, P. (2010). The Relationship between Savings and Economic Growth I Countries with Different Level of Economic Development. Vol. 7, Issue 2, 17-29.
79. Modigliani, F. (1970). The Life-Cycle Hypothesis of Saving and Inter-Country Differences in the Saving Ration. Oxford Press.
80. Mohan, R. (2006). Causal Relationship between Savings and Economic Growth in Countries with different Income Levels. *Economics Bulletin*, Vol. 5, No. 3: 1-12.
81. Odhimabo, N. M. (2009). Saving and Economic Growth in South Africa: A multivariate causality test. *Journal of Policy Modeling*, Vol.31, issue 5, 708-718.
82. Olapido, O. S. (2010). Does Saving Really Matter for Growth in Developing Countries? The Case of a Small Open Economy. *International Business and Economics Research Journal*, Vol. 9, No. 4.
83. Rasmidatta, P. (2011). The Relationship between Domestic Saving and Economic Growth and Convergence Hypothesis: Case Study of Thailand. Department of Economics.
84. Ricardo, D. (1937). The Principles of Political Economy and Taxation. London. Romm, A. T. (n.d.). The Relationship between Savings and Growth
85. Romm, A. T. (2003). The Relationship between Savings and Growth in Africa: An Empirical Study. TIPS/DPRU Forum.
86. Saltz, I. S. (1999). An examination of causal relationship between savings and growth in the Third World. *Journal of Economics and Finance*, Vol. 23, No.1, 90-98.
87. Shahbaz, M. (2008). Old Wine in New Bottles: Growth-Saving Nexus: An Innovation Accounting Technique in Pakistan. *Economics Bulletin*, Vol. 28, issue 1.
88. Shaw, E. S. (1973). Financial Deepening in Economic Development. Oxford University Press.
89. Sims, C. A. (1972). Money, income and causality. *American Economic Review*, 62, 540-52.
90. Sinha, D., & Sinha, T. (1998). Cart before the Horse? The Saving-Growth Nexus in Mexico. *Economics Letters*, Vol. 61, 43-47.
91. Smith, A. (1976). An inquiry into the Nature and Causes of the Wealth of Nations. vol.2.
92. Solow, R. M. (1956). A contribution to the Theory of Economic Growth. *Quarterly Journal of Economics*, 70 (1), 64-94.
93. Thirlwall, A. P. (2002). The Mobilization of Savings for Growth and Development in Developing Countries. *The IUO Journal of Applied Economics*, Vol. 1, issue 1, 7-30.
94. Thornton, D. L. (2009). Personal Saving and Economic Growth. *Economic SYNOPSES*, No. 46.
95. Verma, R. (2007). Savings, Investment and Growth in India: An application of the ARDL. World Bank. (1993). the East Asian Miracle: Economic Growth and Public Policy. New York: Oxford University Press.
96. Zhang, Z. (2003). Can the rest of the East Asia catch up with Japan? Some Empirical Evidence. *Japan and the World Economy*, 15 (1): 91-110.
97. De la Fuente, A. (1996). Innovation, bank monitoring, and endogenous financial development. *Journal of Monetary Economics* 38, 269-301.
98. Ernest, A. (2004). Financing Africa's future growth and development.
99. Getnet Aemu (2010). Challenges and prospects of Agriculture Development led Industrialization in transforming the economy and promoting private sector development. Addis Ababa: CIDA.
100. James R. Barth, Gerard Caprio, Jr., Ross Levine. (January 2013). Bank Regulation and Supervision in 180 Countries from 1999 to 2011. California at Berkeley: Milken Institute.
101. Khan, A. (2012). Role of Commercial Banks in Economic Development.

ROLI I BANKAVE TREGTARE NË RRITJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS, PËRMES RRITJES SË AKUMULIMIT TË DEPOZITAVE

- 102.** Khatkhate, D.R. and K. Riechel. (1980). multipurpose banking: its nature, scope and relevance for less developed countries. IMF.
- 103.** Knack, S. (2001). Aid Dependence and the quality of governnace: A cross-Coountry emperical Analysis. Wasington: world Bank.
- 104.** Koskela, E., Viren, M. (1983). A long-Term determinants of the private saving ratio. North Holland Publishing Company.
- 105.** Lewis, W. (1970). The Mark Theory of economic Growth. New York.
- 106.** Mark Carlson and Kris James Mitcheer. (2006). Branch Credit Banking, Bank banking, Competition, and Finnacial Stability. Journal of money Vol.38, No.5, 129-151.
- 107.** Meier, G. (1989). Leading isuues in Economic Developmnet. New York: Oxford.